

TAKVIM
1444-1445

KALENDAR
2023

Boton:

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182

Tel & fax: 038 / 224-001

www.bislame.net

e-mail: takvimi@hotmail.com

Për botuesin:

Myftiu, Naim ef. Tërnavë

Kryeredaktor:

Ahmet Sadriu

Redaksia:

Resul Rexhepi

Sabri Bajgora

Ramadan Shkodra

Lektor:

Bajram Zeqiri

Redaktor teknik &

Realizimi kompjuterik:

Nuhi Simnica

Shtypi:

"Iliri" - Prishtinë

© Copyright:

Të gjitha të drejtat e botimit, ribotimit, fotokopjimit a përkthimit i përkasin Kryesisë së BI-së të Kosovës.

Ndalohet me ligj riprodhimi i plotë apo i pjesshëm pa lejen e botuesit

**TAKVIM
1444-1445**

**KALENDAR
2023**

Prishtinë



Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

NË VEND TË PARATHËNIES

Të gjitha falënderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut xh.sh., Krijuesit të Gjithësisë. Vetëm Atë e adhurojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe mbrojtje kërkojmë.

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë më të dashurit të Allahut, Muhamed Mustafasë, vulës së pejgamberisë, familjes së tij të pastër, shokëve të tij besnikë dhe të gjithë atyre që ndjekin rrugën e tij deri në ditën e gjykimit.

Të nderuar lexues!

Kemi kënaqësinë e veçantë që revista “Takvimi” po vazhdon rrugëtimin e saj me sukses, për çka fillimisht e falënderojmë Krijuesin e Gjithësisë, e më pastaj institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, redaksinë, bashkëpunëtorët dhe në veçanti, një falënderim të veçantë ia dedikojmë lexuesit të nderuar, të cilët dhanë një kontribut të suksesshëm në këtë rrugëtim, i cili pa marrë parasysh rrethanave e situatave, si dhe krizave me të cilat sot po ballafaqohemi, megjithatë kjo revistë po vazhdon rrugëtimin e saj të suksesshëm. Në këtë kohë, kur gjithçka është digjitalizuar dhe kur interesimi për lexim në përgjithësi ka shënuar rënie, kërkesa për “Takvimin” ende vazhdon, gjë që kjo ne na shtyn dhe na jep kurajë që të vazhdojmë rrugëtimin dhe misionin e shenjtë që kemi. Falë angazhimit të palodhshëm të redaksisë dhe bash-

këpunëtorëve tanë, edhe këtë vit kemi arritur që t'ia ofrojmë lexuesit tanë revistën “Takvimi”, duke e ruajtur formën, brendinë dhe mesazhin, të cilin me dekada të tëra vazhdon ta përcjell te lexuesi.

Temat të cilat i kemi trajtuar në këtë numër, si zakonisht janë të natyrës fetare islame në përgjithësi, por krahas këtyre ka edhe tema nga kultura dhe civilizimi islam, gjithherë duke ia bashkëngjitur në fund edhe pjesën kalendarike, e cila është e veçantë nga pjesa tematike e saj.

Të nderuar lexues!

Numrin e këtij viti e kemi filluar me një temë nga akaidi, të shkruar nga Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili trajton pozitën e mendjes sipas Kuranit, duke sjell kështu mendimin e dijetarit të njohur, Eshariut në lidhje me këtë. Komentimi i Ajetul-Kursisë, apo siç njihet te na me emrin “*Tesbih Dova*”, është tema e radhës nga fusha e tefsirit. Duke qenë se besimtarët islam e lexojnë Ajetul-Kursinë vazhdimisht gjatë ritualit të namazit, këtu do ta kenë mundësinë që ta kuptojnë domethënien e këtij ajeti. Namazi dhe kushtet e tij, trajtohet në temën e radhës, ku autori shpjegon hollësisht rëndësinë, aspektin teorik dhe atë praktik të namazit. Këtu lexuesit i ofrohet mundësia që të mësojnë rëndësinë dhe kushtet e namazit, dhe jo vetëm kaq, por edhe zbatimin praktik të shtyllës kryesore të fesë islame - namazit. Më pas kemi vazhduar me trajtimin e figurës së një prej dijetarëve më eminent të jurisprudencës islame, Ebu Hanifes, themeluesit të shkollës juridike hanefite - medhhebit hanefi, të cilit i takojmë ne. Kjo temë theks të veçantë i kushton kontributit të

këtij dijetari në shkencën e fikhut, jurisprudencës islame. Se Pejgamberi a.s. ishte që nga lindja nën mbikëqyrjen e Allahut xh.sh. e tregon autori në trajtesën vijuese. Libri ynë, Kurani, ndër të tjera na tregon edhe për tiparet e antiislamistëve, temë të cilën e gjeni në këtë numër të “Takvimit”. Edhe ndikimi i salavateve për Pejgamberin a.s. dhe rëndësia e tyre janë trajtuar në këtë numër. Po ashtu, edhe rëndësia e pastërtisë fizike dhe shpirtërore në Islam, për të cilat na ka porositur Resullahu s.a.v.s. trajtohet në këtë numër. Në vazhdim trajtohen edhe disa tema të tjera me tematika islame nga lëmi të ndryshme.

Redaksia e “Takvimit” jo domosdoshmërisht pajtohet me opinionet e autorëve të shkrimeve që boton.

Lexuesit të nderuar ia rikujtojmë se revista “Takvimi” përmban ajete kuranore dhe hadithe të Pejgamberit a.s., prandaj gjatë përdorimit të saj, lutem që të kenë kujdes.

Krejt në fund, duke pasur parasysh se mund të kemi bërë lëshime dhe gabime të paqëllimta, lusim Fuqiplotin, Krijuesin e gjithësisë, që të na e pranojë këtë punë dhe angazhimin tonë, duke arritur kështu kënaqësinë e Tij.

و الحمد لله على نعمته العظيم

Vel hamdulil-lahi ala niametihi el adhijm.

*Prishtinë,
nëntor 2022*

Ahmet Sadriu

Naim ef. TËRNAVA - Myfti i Kosovës

POZITA E MENDJES SIPAS KURANIT DHE MENDIMI I ESHARIUT RRETH SAJ

S'ka pikë dyshimi se shpallja i drejtohet mendjes, ngase kusht për ta pranuar e kuptuar, po edhe për të vepruar sipas urdhrave dhe obligimeve që sjell shpallja, patjetër se është mendja e shëndoshë. Prandaj, edhe roli i mendjes në pranimin e kuptimit dhe në shpjegimin e shpalljes prej Zotit, xh.sh., është vendimtar. Po ashtu, pozita e mendjes zë një hapësirë të madhe në faqe të shumta të Kuranit, dhe nga kjo shihet se çfarë rëndësie i jep Kurani mendjes (logjikës) në marrjen dhe konceptimin e mësimave që sjell.

Përkundër asaj që trumbetojnë disa jomyslimanë, po edhe disa grupe nga radhët e myslimanëve, kinse Kurani apo Islami e stopon mendimin e lirë e logjik, hulumtimin shkencor, argumentimin e gjërave përmes përdorimit të mendjes (logjikës), mësimet kuranore prapë mbeten ashtu siç i ka zbritur Zoti, xh.sh. Ndërsa, akuzat në adresë të Islamit janë hipoteza pa vend që i adresohen librit të fundit, Kuranit, si dhe vetë Islamit.

Të menduarit është rruga që duhet ndjekur për ta njohur Allahun, xh.sh., dhe atë që urdhëron Ai në librin e fundit hyj-

nor. Ky është obligim për myslimanin. Nga këtu mund të themi se Kurani bën thirrje të vazhdueshme e të qartë për shikimin e këtij universi të krijuar prej Allahut, xh.sh., dhe të harmonisë e cila mbretëron në këtë univers.

Argumente për ta argumentuar këtë që thamë deri tash kemi shumë në Kuran, ndërsa në vazhdim po përmendim vetëm disa. Për shembull, Allahu, xh.sh., thotë:

قُلْ انظُرُوا مَاذَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ۚ وَمَا تُغْنِي الْآيَاتُ وَالنُّذُرُ
عَنْ قَوْمٍ لَا يُؤْمِنُونَ

“Thuaj: “Vështroni me vëmendje çka ka (nga argumentet) në qiej e në Tokë! Po argumentet dhe qortimet nuk bëjnë dobi ndaj një populli që nuk beson!” (Jonus: 101)

Ky ajët, po edhe shumë të tjerë si ky, që do t’i përmendim në vijim, janë argument e dëshmi që mendjes dhe përpjekjes së saj për të studiuar e për të hulumtuar në zbulimin e gjërave të fushave dhe të natyrave të ndryshme ia japin vendin që e meriton, po edhe vetë njeriut ia japin pozitën që e meriton si krijesë e Allahut, xh.sh., si krijesa më e ngritur dhe më e ditur.

Ajeti i sipërpërmendur fillon me urdhrin “Thuaj”. Pra, Allahu sikur e urdhëron Muhamedin, a.s., që t’i urdhërojë besimtarët të shikojnë dhe të studiojnë se çfarë ka në qiej dhe në Tokë, si dhe ta angazhojnë mendjen për të zbuluar dhe për të ditur, dhe jo vetëm thjesht të vështrojnë, por edhe të studiojnë dhe të zbulojnë. Allahu, xh.sh., thotë:

أَوَلَمْ يَتَفَكَّرُوا فِي أَنفُسِهِمْ ۚ مَا خَلَقَ اللَّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا
بَيْنَهُمَا إِلَّا بِالْحَقِّ وَأَجَلٍ مُّسَمًّى ۚ وَإِنَّ كَثِيرًا مِّنَ النَّاسِ بِلِقَاءِ رَبِّهِمْ
لَكَافِرُونَ

“Dhe a nuk menduan ata me veten e tyre se Allahu nuk i krijoi qiejt dhe Tokën, dhe çdo gjë që gjendet ndërmjet tyre, pa ndonjë qëllim të caktuar dhe për një kohë të kufizuar?! Mirëpo një pjesë e njerëzve janë mohues të takimit me Zotin e tyre (në momentin e ringjalljes pas vdekjes).” (Rum: 8)

Nisur nga ajo që u tha më lart, mësojmë se Zoti, xh.sh., tërheq vërejtjen dhe e thërret njeriun që ai të shikojë edhe përmes asaj që ka krijuar Zoti, xh.sh., në qiej dhe në Tokë, dhe të bindet në Madhërinë e Allahut, xh.sh. Çdo gjë në univers, po edhe në vetë qenien tonë, nëse e shohim me syrin e studimit, të analizës, të vështrimit dhe të kuptimit, dëshmon se vetëm Allahu, xh.sh., është Krijuesi, dhe se askush tjetër nuk e ka këtë mundësi. Asgjë në këtë gjithësi nuk është krijuar pa ndonjë qëllim të caktuar. Çdo krijesë e ka qëllimin e krijimit, kohën, synimin, afatin e caktuar, se sa do të ekzistojë, deri në Ditën e Kiametit. Përkundër këtyre fakteve, është shumë interesante se shumë njerëz nuk binden në Zotin Një dhe në atë që Ai ka urdhëruar! Thënë shkurt, janë mohues të takimit me Zotin, xh.sh., në botën tjetër.

Zoti, xh.sh., në këtë ajet jep shenjë edhe për ata që shikojnë me sytë e mendjes, duke pasur në konsideratë dhe duke vërtetuar atë që shohin (mendojnë), në bazë të mundësisë,

njohjes dhe aftësisë që posedojnë. Për ta vërtetuar këtë, në vazhdim, po përmendim hadithin e Muhamedit, a.s.:

وَيْلٌ لِّمَن قَرَأَهَا وَلَمْ يَتَفَكَّرْ فِيهَا

“Mjerë për atë që i lexon këto ajete dhe nuk mendon për to (për kuptimin e tyre)!”¹

Ai që nuk mendon dhe nuk e merr në konsideratë, apo që nuk e vlerëson rezultatin e angazhimit të mendjes, ai nuk i ka kuptuar dhe nuk është duke i shpjeguar drejt parimet kryesore të fesë islame.

Në Kuran gjejmë argumente të qarta që i drejtohen mendjes së njeriut dhe futjes në përdorim të mendjes dhe të angazhimit logjik, dhe kjo për ta zbuluar mënyrën e funksionimit të ekzistencës dhe të jetës së krijesave të shumta të krijuara në këtë gjithësi. Allahu, xh.sh., thotë:

وَسَخَّرَ لَكُمُ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ وَالشَّمْسَ وَالْقَمَرَ ۚ وَالتَّجُومَ مُسَحَّرَاتٍ
بِأَمْرِهِ ۚ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّقَوْمٍ يَعْقِلُونَ

“Dhe për ju nënshtroi natën e ditën, dhe Diellin e Hënën. Edhe yjet janë të nënshtuar me urdhrin e Tij. Në këto vërtet ka argumente për një popull që mendon.”

(Nahël: 12)

Çdo gjë që është në qiej, pa përjashtim, po edhe në Tokë, në brendësinë e saj apo në sipërfaqe, si dhe çdo gjë mes Tokës e qiejve, pastaj edhe nënshtimi i natës dhe i ditës, janë argumente që flasin se të gjitha i janë nënshtuar urdhrin dhe

¹ Ibën Hibani transmeton në Sahihun e tij, nr. 620. Shuajb Arnauti thotë se hadithi është sahih sipas kriterëve të Muslimit.

përkujdesjes së Allahut, xh.sh., ngase vetëm Ai e ka këtë mundësi. Allahu, xh.sh., thotë:

كَذَلِكَ نُفَصِّلُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ

“...Kështu Ne ua sqarojmë faktet njerëzve që mendojnë.” (Junus: 24)

Këto mirësi të Zotit, xh.sh., këto fakte e argumente të Zotit, xh.sh., njeriu, gjatë kësaj jete, është i urdhëruar që përmes angazhimit dhe hulumtimit (studimit) të mendjes t’i shohë e t’i njohë. Pra njeriu duhet ta njohë dhe ta besojë atë që krijoi Zoti, xh.sh., ashtu që të fitojë bindjen e drejtë në Zotin, xh.sh., se Ai është Një dhe i Vetmi që krijon. Allahu, xh.sh., thotë:

وَهُوَ الَّذِي أَنْشَأَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ فَمُسْتَقَرٌّ وَمُسْتَوْدَعٌ ۖ قَدْ فَصَّلْنَا الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَفْقَهُونَ

“Ai është që ju krijoi (filloi) prej një njeriu, aty (në Tokë) jetoni (qëndroni) dhe nën të do të pushoni. Ne ia sqaruam argumentet një populli që di të kuptojë.” (En-amë: 98)

Pastaj ajeti:

وَمَا ذَرَأَّا لَكُمْ فِي الْأَرْضِ مُخْتَلِفًا أَلْوَانُهُ ۖ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَةً لِقَوْمٍ يَذْكُرُونَ

“Edhe për atë që krijoi në Tokë lloje të ndryshme (bagëti, bimë, pemë, minerale etj.), ka fakte për një popull që di të marrë përvojë.” (Nahël: 13)

Pastaj ajeti:

فَاعْتَبِرُوا يَا أُولِيَ الْأَبْصَارِ

“...pra merrni përvojë, o ju të zotët e mendjes!” (Ha-shër: 2)

Pastaj ajeti:

وَاتَّقُوا يَا أُولِيَ الْأَلْبَابِ

“...e ju të zotët e mendjes, ma kini frikën Mua!” (Be-kare: 197)

Pastaj ajeti:

وَمَا يَذَّكَّرُ إِلَّا أُولُو الْأَلْبَابِ

“...mirëpo këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes.” (Ali Imran: 7)

Këto ajete, po edhe shumë të tilla, flasin se si besimtari e ka të domosdoshme dhe obligim që në çështjet të cilat kanë nevojë të shtjellohen dhe të qartësohen, vështrimin ta bëjë nga aspekti logjik, nëse është më se i nevojshëm ai vështrim, dhe kjo edhe në të gjitha çështjet apo problematikat që kanë të bëjnë me çështjen e besimit, siç janë temat mbi të ekzistuarit e Zotit, xh.sh., krijimin e universit, ringjalljen pas vdekjes, e të ngjashme. Këto çështje thërrasin në vazhdimësi të zotët e mendjes në angazhimin e mendjes dhe të logjikës së shëndoshë, në mënyrë që të kuptohet sa më mirë ajo që urdhërohet prej Allahut, xh.sh.

Nga këto ajete mësojmë se Allahu, xh.sh., mendjes së njeriut i drejtohet në forma të ndryshme, mirëpo me qëllimin e vetëm që njeriu ta përdorë mendjen për besimin, për kuptimin dhe për qartësimin e të gjitha çështjeve delikate, çështje

të cilat kanë të bëjnë me besimin dhe adhurimin. Kjo me qëllimin për të studiuar dhe për të arritur njohuri të reja në të gjitha fushat shkencore që e kërkojnë ndërhyrjen e mendjes apo të logjikës. Të gjithë besimtarët jemi të urdhëruar që ta besojmë atë që i Madhi Zot, xh.sh., ka zbritur tek i Dërguari i Tij, megjithëse jo të gjithë janë në gjendje ta kuptojnë atë që i Madhi Zot thotë në Kuran. Prandaj, me të drejtë Allahu, xh.sh., thërret në veçanti të zotët e mendjes, ata që janë në gjendje të kuptojnë më thellë dhe që merren me çështje e problematika për të cilat ka nevojë më të madhe për t'u angazhuar mendja. Kjo sepse janë disa çështje që kërkojnë konceptim, studim dhe shtjellim më të thellë. Dhe, mendja e zgjuar e di se cila çështje duhet shtjelluar, e cila duhet lënë ashtu siç e ka zbritur Zoti, xh.sh., ngase njohuritë për të mund të jenë fshehtësi të të Madhit Zot, xh.sh.

Esharinjtë janë të një mendimi, se mendja është e kufizuar në njohjen e gjërave dhe relativitetin e tyre në mënyrë absolute. Dhe, ky përkufizim mbështetet në relativitetin e vlerave që posedon mendja, në mohimin e shkakësisë dhe në mohimin e pranisë së njohjes universale të mendjes, e që janë baza të përdorura prej esharinjve, me qëllimin e largimit të mendjes nga e gjithë mundësia për një siguri absolute të gjykimit. Domethënë, kjo ndodh për ta bërë mendjen të kufizuar në zotërimin dhe arritjen e së vërtetës vetvetiu, pa u mbështetur fare në tekst - argument (e këtu është fjala për shpalljen).

Edhe më herët kemi përmendur se Eshariu është theme-lues i drejtimit - shkollës esharite, e më pas Gazaliu e shumë të tjerë janë pasues të mësimave të tij. Duhet pasur gjithherë parasysh se kundërshtimi i doktrinës së mutezilinje nuk

mund të arrihet nëse nuk përdoren argumente më të forta sesa të vetë mutezilinjve. Pra, është më se e vërtetë se mendimet racionale të mutezilinjve kishin lënë gjurmë të thella në shoqërinë islame. Ato mendime dhe ndikimi i tyre nuk mund të kalohej lehtë. Kështu, vërehet qartë se Ilmul Kelami esharij u shërbye apo i përdori konkluzionet duke u bazuar në argumente logjike, si dhe e refuzoi njohjen (kryerjen) e veprave të njeriut në mënyrë arbitrare (të detyrueshme).

Prandaj, shtrohet pyetja se: cilat janë boshllëqet në këtë mendim, dhe si u manipulua mendja?

Është më së e vërtetë që Eshariu nuk i braktisi metodat e arsyetimit logjik, por racionaliteti i esharinjve nuk bazohej vetëm në argumente formale nga njëra anë, por mbështetej edhe në pikat racionale nga të cilat lindnin hyrjet në arsyet që, sipas Eshariut, ishin të kufizuara në përmbajtjen e teksteve fetare, sipas vizionit të asaj epoke dhe potencialit që ishte mbledhur gjer atëherë nga komentimet e tekstit sakral. Pra Eshariu, krahas mendjes, e shfrytëzonte edhe tekstin fetar (sakral).

Ja pse një nga parimet e doktrinës së esharinjve është se mendja nuk është burim i vetëm i vërtetë për njohjen. Dijetarët esharinj shtojnë se dija apo njohuria për apo rreth diçkaje arrihet vetëm pas një shqyrtimi të rëndomtë, ndërsa shqyrtimi vetëm racional (logjik) nuk mund të ofrojë gjithherë njohuritë e kërkuara (të nevojshme). Dija fitohet pas shqyrtimit dhe studimit, ngase dija është e krijuar prej Zotit, xh.sh. Duhet ditur se njohuritë që sjell mendja apo që i fitojmë përmes angazhimit të mendjes nuk janë të mjaftueshme për të ngritur besimin e drejtë në Krijuesin e kësaj gjithësie. Njohuritë lo-

gjike (mendja) duhen kuptuar si një udhëzim dytësor (aset) që ndihmohet nga shpallja hyjnore, në mënyrë që njeriu ta gjejë sa më lehtë besimin e drejtë në Zotin Një.

Esharinjtë morën një rrugë të mesme mes mësimave të mutezilinjeve dhe atyre të xheberinjve, kur thanë se veprat e njeriut janë të krijuara prej Zotit, xh.sh., dhe se njeriu nuk ka kurrfarë kompetence në krijimin e tyre. Kjo sepse, sipas tyre, njeriu nuk është në gjendje t'i krijojë veprat e tij, por ai është në gjendje t'i fitojë (t'i realizojë) ato vepra.

Kur folën për shkakun, esharinjtë thanë se Zoti, xh.sh., është shkak i drejtpërdrejtë i çdo ndryshimi që ndodh në esencat dhe simptomat, dhe se nuk ka asnjë shkak tjetër në univers, përveç Zotit, xh.sh., dhe çdo paraqitje e re kërkon një krijim të ri prej Zotit, xh.sh., i cili ndodh drejtpërdrejt vetëm prej Tij.

Me Ilmul Kelamin janë marrë dijetarët më të mëdhenj të Islamit pas Muhamedit, a.s., si: Ebu Hanife, Shafiiu (edhe pse këta dy dijetarë nuk njihen si kelamistë, megjithatë kanë dhënë një kontribut të madh), pastaj Maturidiu, Eshariu, Bejhikiu, Bakilaniu, Imamul Haremejni, Gazaliu, Fahrudin Errrazi, Bejdaviu, Taftazaniu, Muhamed bin Jusuf Es Sunusi, si dhe shumë e shumë të tjerë.

Sabri ef. BAJGORA

KOMENTIMI I AJETUL-KURSISË

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ۚ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ ۚ لَهُ مَا فِي
السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۗ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ ۚ
يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ ۗ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا
بِمَا شَاءَ ۚ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ ۖ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا ۚ
وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

“Allahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij. I Gjalli, i Përjetshmi. Atë nuk e kap dremitja e as gjumi! Vetëm Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, përveçse me lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhë përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas tyre. Të tjerët nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse sa Ai dëshiron. Push-teti (Kursija) i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Atë nuk e lodh përkujdesja për të dyja, Ai është më i Larti, më Madhështori!” - (El Bekare, 255)

Vlera e Ajetul-Kursisë

Ajeti i 255-të i sures *El Bekare*, i njohur si *Ajetul-Kursij* apo në mesin e popullatës sonë si *Tesbih Dova*, është ajeti më madhështor i Kuranit famëlartë, bazuar në thënien e bekuar të Resulullahut s.a.v.s., i cili ka thënë: “Çdo gjë ka aureolën - kurorën e vet, e kurora e Kuranit, është surja *El Bekare*. Në të është një ajet, i cili është zotëria i tërë ajeteve kuranore, e ai është Ajeti Kursij. Nuk ka shtëpi që kur të lexohet në të kjo sure, të mos ikë shejtani prej saj.”¹

Përveç këtij hadithi që flet për vlerën e sures *El Bekare* dhe të *Ajetul-Kursisë*, kemi edhe shumë hadithe të tjera nga i Dërguari i Allahut, shumica e të cilëve arrijnë gradën e besueshmërisë dhe të saktësisë “*sahih*” dhe “*hasen*”, e shumë pak transmetime të dobëta, por që në asistencë me hadithe të tjera të ngjashme, arrijnë pragun e besueshmërisë në transmetim. Ne këtu do të sjellim disa prej këtyre haditheve, për të parë vlerën e jashtëzakonshme të këtij ajeti madhështor të Kuranit famëlartë, sepse është ajet që përfshin afro 18 emra të bukur të Allahut, disa të përmendur drejtpërdrejt e disa në mënyrë të tërthortë, në formë të përemrave.²

- Transmeton Ubej bin Ka’bi se Pejgamberi a.s. ka thënë:
“O Eba Mundhir, a e di se cili ajet i Librit të Allahut është më madhështori për ty? - Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë!, - i thashë. Më pyeti sërish: “O Eba

¹ Transmetojnë nga Ebu Hurejra, Abdurrezak es-San’ani në *El-Musannef* (3/376/6019); Hakimi në *El-Mustedrek* (2/259). Hadithi është i kategorisë “*sahih*”.

² Dr. Vehbe ez-Zuhajli, “*Et-Tefsirul Munir*”, Damask, 2009, vëll. III, f. 14.

Mundhir, a e di se cili ajet i Librit të Allahut është më madhështori për ty? Atëherë iu përgjigja: “Allahu la ilahe il-la huve, El-Hajjul Kajjum (Ajeti Kursij)”. Pas kësaj, më preku me dorën e tij në gjoks dhe më tha: “O Eba Mundhir, të uroj për dijen tënde!”³

- Transmetohet nga Esma bin Jezid të ketë thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: “Emri më madhështor i Allahut gjendet në këto dy ajete: **“Allahu la ilahe il-la huve El Hajju-l Kajjum”** - (El Bekare 255) dhe **“Ve ilahukum ilahun vahid”** - (El Bekare , 163).⁴

Ndërkohë, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu e ngritin këtë hadith nga grada “*daif*” në gradën “*hasen*”, me këtë version: “Emri më madhështor i Allahut gjendet në këto dy ajete: **“Ve ilahukum ilahun vahid, la ilahe il-la huve er-Rrahmanu-r-Rrahim”** - (El Bekare, 163), **“Allahu la ilahe il-la huve El Hajju-l Kajjum”** - (El Bekare, 255)” dhe në ajetet **“Elif Lam Mim, Allahu la ilahe il-la huve El Hajju-l Kajjum”** - (Ali Imran, 1-2);⁵

- Transmeton Ebu Uname el Bahilij nga Pejgamberi s.a.v.s. të ketë thënë: “Emri më i madh i Allahut, me të cilin kur lutet, i përgjigjet lutjes, gjendet në këto tri sure: “El Bekare”, “Ali Imran” dhe “Ta Ha”.⁶ Në lidhje

³ Transmeton Muslimi, (810). Hadithi është i kategorisë “*sahih*”.

⁴ Transmeton Darimiu (3389) Shih: *El-Kitabul Xhami’ë li fedailil Kuran*, f. 9.

⁵ Ebu Davudi (1496); dhe Tirmidhiu (3478); Ibn Maxhe (3855); Ibn Ebu Shejbeh (7/233). (Imam Ahmedi (6/461).

⁶ Ibn Maxhe (795); Hadithi, ndonëse është i kategorisë “*daif*”, është shumë afër të konsiderohet ‘*hasen*’. Shih më gjerësisht: “*El-Kitabul Xhami’ë li fedailil Kuran*”, Aman, 2007, f. 39.

me këtë, hatibi i Damaskut, Hisham ibn Ammari ka thënë: “Në suren *El Bekare*, ajeti 255: **“Allahu la ilahe il-la huve El Hajju-l Kajjum”**, në suren *Ali Imran*, ajeti 2: **“Allahu la ilahe il-la huve El Hajju-l Kajjum”** dhe në suren *Ta Ha*, ajeti 111: **“Ve anetil vuxhuhu lil Hajjil Kajjum”**”⁷ Që të tri këto sure si fjalë të përbashkët i kanë emrat e bukur të Allahut: **“El-Hajjul-Kajjum”**.⁸

- Transmetohet nga Eba Dherri r.a. të ketë thënë: E pyeta të Dërguarin e Allahut: Ç’është më madhështorja që të ka zbritur nga Kurani famëlartë. E ai më tha: *“Ajetul-Kursij - “Allahu la ilahe il-la huve El Hajju-l Kajjum”*”⁹
- Transmetohet nga Ebi Umameh el Bahili se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Kush e lexon ajetin Kursij pas çdo namazi, vetëm vdekja e ndanë prej hyrjes në Xhenet.”¹⁰
- Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. e kishte ngarkuar atë me ruajtjen e zekatit të Ramazanit dhe një natë i kishte ardhur një njeri dhe i kishte marrë (vjedhur) pak ushqim. Pasi e zura, i thashë: “Do të dërgoj tek i Dërguari i Allahut...”; Pasi e zura edhe natën e tretë, ai më tha: “Më lësho, e unë do t’i mësoj disa fjalë, prej të cilave do të kesh dobi. Kur të biesh në shtrat që të flesh, lexoje Ajetul-Kursinë dhe vazhdimisht do ta

⁷ “*Et-Tefsirul Munir*”, vëll. III, f. 16.

⁸ Sqarim yni (S.B.).

⁹ Abdulhamid Kishk, “*Fi Rihabi-t-Tefsir*”, Kajro, 1988, vëll. III, f. 495.

¹⁰ Hadith ‘hasen’. E transmetojnë Nesaiu në “*Es-Sunen el Kubra*”, (6/30); Taberaniu në “*El-Mu’xhemul Kebir*”, (8/114); Bejhekiu në “*Shuabil Iman*” (2/458); Hejthemiu në “*Mexhmeu-z-Zevaid*” (10/103) etj.

kesh pranë një mbrojtës nga Allahu, si dhe nuk do të të afrohet asnjë shejtan derisa të zgjohesh....”¹¹

Hadithet dhe fjalët e sahabëve dhe të dijetarëve rreth vlerës së Ajetul-Kursisë janë të shumta, por ne u mjaftuam vetëm me këto, sa për të dëshmuar për madhësinë e këtij ajeti që me plot të drejtë është cilësuar nga i Dërguari i Allahut si “zotëria i tërë ajeteve kuranore”.

Përmbajtje e shkurtër e Ajetul-Kursisë

Ajeti më madhështor i Kuranit famëlartë, *Ajetul-Kursij*, i ka zbritur të Dërguarit të Allahut, natën, dhe Pejgamberi a.s. menjëherë e kishte thirrur Zejdin që ta shkruante atë.¹²

Ky ajet ka gjithsej 50 fjalë, të përmbledhura në 10 fjali me kuptime madhështore, fjali të cilat pohojnë dhe vërtetojnë Njeshmërinë e Allahut dhe përshkrimin e emrave dhe cilësive të Tij.¹³

Në këtë ajet, janë përfshirë shumë prej emrave të bukur të Allahut dhe cilësive të Tij, siç janë Njeshmëria, Gjallëria, Dituria, Sundimi, Fuqia, Dëshira, Vullneti, Përjetësia etj.

Ajetul-Kursij, përçon mesazhin e Njeshmërisë absolute dhe mbase këtu qëndron urtësia pse i Dërguari i Allahut e ka cilësuar atë si zotërinë e tërë ajeteve ose ajetin më madhështor të Kuranit fisnik.

¹¹ Transmeton Buhariu në Sahihun e tij (5010)

¹² Tesfiri i Kurtubiut, Bejrut, 2006, (4/263).

¹³ Tefsiri i Ibn Kethirit, Bejrut, 1998, (1/517).

Koment:

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ

“Allahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij.”

Ajetul-Kursij fillon me përmendjen e emrit më të madh të Krijuesit - **Allah**, i cili në terminologjinë fetare njihet si “*Lafdhul Xhelaleh*”, për të na rikujtuar se nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe as që meriton të adhurohet dikush përveç Tij.

Në Kuran, emri Allah është përdorur 2699 herë. Ky emër është përmendur në 85 sure kuranore, ndërkohë që 35 ajete kuranore nisin me këtë emër të bukur të Krijuesit të gjithëpushtetshëm. Ky emër sipas shumë dijetarëve është emri më i madh i Zotit Fuqiptotë, sepse dëfton për Qenien Absolute, dhe përfshin të gjitha cilësitë dhe atributet e tjera hyjnore të Tij. Emri Allah është emër i përveçëm dhe nuk është i prejarthur, që do të thotë nuk rrjedh prej ndonjë fjale tjetër. Si shprehje e tillë përdoret vetëm për të dëshmuar *Ekzistencën e Domosdoshme dhe Absolute*. Çdo emër tjetër i bukur i Allahut vjen si shtesë me të, kur janë së bashku. p.sh. **“Hu-vallahu ledhi la ilahe il-la huve”** - **“Ai është Allahu që nuk ka zot tjetër përveç Tij...”** (*El Hashr*, 23) ose **“Allahu la ilahe il-la huve rabbul Arshil adhim”** - **“Allahu është një, nuk ka Zot tjetër përveç Tij, Zot i Arshit të madh”** (*En Neml*, 26) etj.

Vetëm me emrin **Allah** plotësohet Dëshmia Islame, e cila është **“La ilahe il-la Allah, Muhammedun resulullah”**.

Sipas dijetarëve, kjo pjesë e ajetit përmban në vete mohim dhe vërtetim. Sipas Taberit, mohimi këtu nënkupton pamundësinë të ketë ndonjë zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Allahut, ndërsa vërtetimi nënkupton atribuimin e

njëshmërisë hyjnore vetëm për Allahun, që është i Vetëm, i Gjallë dhe i Përvetshëm.¹⁴

Ibn Kethiri ka thënë: “Kjo nënkupton informimin se Ai (Allahu) është i veçuar në Hyjnoren e Tij, të qenët Zot i të gjitha krijesave”,¹⁵ kurse Imam Bejdaviu ka thënë: “Allahu është i vetmi që meriton dhe është i denjë të adhurohet, dhe askush tjetër pos Tij.”¹⁶

Fillimi i *Ajetul-Kursisë*, është baza e dëshmisë islame dhe bazamenti i thirrjes së të gjithë pejgamberëve të Allahut nëpër kohë, që të mos adhurohet askush tjetër pos Allahut. Fjala **“La ilahe il-la Allah”** është **“Kelimetun tajjibeh - Fjala e mirë”**; **“El-Methelu-l-A’la - Shembulli më i lartë”**; **“El-Kavlu-th-thabit - Fjala e qëndrueshme”**; **“El-Kelimetu-l bakijeh - Fjala e përhershme”**; **“Kelimetu-l-Ahdi - Premtimi nga Allahu”**; **“El-Kelimetullahi-l ‘Ulja-Fjala më e lartë e Allahut”**¹⁷ etj.

Në lidhje me këtë fjalë të dëshmisë, Imam Buhariu përcjell nga Ebu Hurejra të ketë thënë: “I thashë: O i Dërguar i Allahut, cili është njeriu më i lumtur me shefatin (ndërmjetësimin) tënd në Ditën e Gjykimit? Më tha: *“O Ebu Hurejre! Ma ka marrë mendja se askush para teje nuk do të ma bëjë këtë pyetje, duke parë kujdesin tënd ndaj hadithit. Dije pra, se njeriu më i lumtur me shefatin tim në Ditën e Gjykimit do*

¹⁴ Tefsiri i Taberiut 5/386.

¹⁵ Tefsiri i Ibn Kethirit 1/330.

¹⁶ Tefsiri i Bejdaviut 1/134.

¹⁷ Dr. Abdullah bin Ali Basfar, *“Te’emmulat fi Ajetil Kursij”*, Xhide, 2005, f.14-15.

të jetë ai që thotë nga zemra (apo nga shpirti) “La ilahe il-la Allah”.¹⁸

Fjala “La ilahe il-la Allah” është edhe më e larta degë e imanit, bazuar në hadithin e Resulullahut s.a.v.s.: “*Imani është gjashtëdhjetë e sa (ose shtatëdhjetë e sa) degë. Më e ulëta (e fundmja) është largimi i një pengese nga rruga kurse më e larta është “La ilahe il-la Allah”*”¹⁹

الْحَيُّ الْقَيُّومُ

“I Gjalli, i Përjetshmi.”

Në këtë pjesë të Ajetul-Kursisë, përmenden dy emra të bukur të Allahut: *El-Hajj* - i Gjalli dhe *El-Kajjum* - i Përjetshmi (*Mbikëqyrësi*).

Këta dy emra, ashtu siç kemi theksuar te vlera e *Ajetul-Kursisë*, janë përmendur tri herë në Kuran, në ajetin e 255-të të sures *El Bekare*, ajetin e 2-të të sures *Ali Imran* dhe në ajetin e 111-të të sures *Ta Ha*. Një pjesë e madhe e dijetarëve, bazuar edhe në thënien profetike, janë të mendimit se emri më i madh i Allahut gjendet në këto tri ajete, përkatësisht në emrat *El-Hajj* dhe *El-Kajjum*.

Emri i Bukur i Allahut *El-Hajj* - i Gjalli përfshin të gjitha cilësitë e përsosmërisë dhe nënkupton, se Allahu është i Gjallë dhe i Përjetshëm, pa fillim dhe pa mbarim. Jeta dhe gjallëria e Tij nuk mund të krahasohen me jetën dhe gjallërinë e krijesave, sepse Ai vetë është krijuesi i jetës dhe i vdekjes.

¹⁸ Transmeton Buhariu (99).

¹⁹ Buhariu (9); Muslimi (35).

Jeta e Tij në asnjë mënyrë nuk lidhet e as përkufizohet me nocionin kohë, të cilin ne e njohim, sepse ky nocion që ne e kuptojmë, ka të bëjë vetëm me krijesat, ndërkohë që Allahu si Krijues, është jashtë kësaj sfere të perceptimit tonë të kufizuar. Cilësitë e Tij nuk ndërlidhen me kohë e as hapësirë, por janë cilësi *ezelije* - të përhershme në Qenien absolute të Zotit.

Mufesiri, Reshid Ridaja, në lidhje me kuptimin e jetës dhe gjallërisë së Allahut dhe jetën e krijesave thotë: “Jeta e Allahut është *ezelije* - e përhershme, kurse ajo e njerëzve është e krijuar dhe është dhuratë nga Allahu Fuqiplotë.”²⁰

Ndërsa emri tjetër i bukur i Allahut, *El-Kajjum* - i *Përjetshmi* (*Mbikëqyrësi i përjetshëm*), të Cilit nuk i ka paraprirë mosekzistenca, përfshin të gjitha cilësitë vepruese të Allahut dhe nënkupton se Ai është Mbikëqyrës i çdo gjëje, sepse është i Përjetshëm, dhe në asnjë mënyrë nuk mund t'i atribuohet zhdukja, Ai është Krijuesi, Shpikësi i jetës dhe vetëm sipas caktimeve të Tij, rrjedh çdo proces në këtë ekzistencë.

I Madhërishmi në Kuranin famëlartë thotë: **“Dhe një prej argumenteve të Tij është që qiejt dhe Toka qëndrojnë sipas urdhrit të Tij”** - (*Er Rrum*, 25).

I Dërguari ynë, Muhamedi a.s., në shumë prej lutjeve të tij, i është lutur Allahut xh.sh. pikërisht me këta dy emra të bukur *El-Hajj* dhe *El-Kajjum*. Njëra prej këtyre lutjeve është edhe kjo: **“Ai që thotë: Kërkoj falje prej Allahut, i Cili është Një dhe nuk ka zot tjetër përveç Tij, i Gjallë dhe i Përjetshëm, dhe**

²⁰ Muhamed Reshid Rida, “*Et-Tefsirul Menar*”, Kajro, 1376 h., vëll. 3, f. 28.

pendohet singerisht tek Ai, atij personi do t'i falen gjynahet, edhe nëse ka qenë prej atyre që kanë ikur nga fronti i luftës."²¹

لَا تَأْخُذْهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ

“Atë nuk e kap dremitja e as gjumi!”

Ashtu siç kemi përmendur në fillim të komentimit, çdo pjesë e Ajetul-Kursisë, ka një ndërlidhje të mahnitshme në mes vete, dhe meqë në pjesën paraprake të ajetit, Allahu e ka cilësuar Vetën si të Gjallë, dhe Mbikëqyrës të Përjetshëm, tash në këtë pjesë të ajetit, i Madhërishmi për Vetën thotë se nuk e kap as dremitja e as gjumi.

Transmetohet nga Ebu Musa r.a. të ketë thënë: “Një ditë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. u ngrit mes nesh dhe i tha pesë fjali. Ai tha: “*Vërtet, Allahu i Lartësuar nuk fle dhe nuk i takon Atij të flejë. Ai e ulë peshoren e drejtësisë (Mizanin) dhe e ngrit atë. Tek Ai ngrihen veprat e natës para veprave të ditës dhe ngrihen veprat e ditës para veprave të natës. Mbulesa e Tij është Dritë, dhe sikur ta largonte atë, atëherë Drita do ta digjte çdo gjë deri aty ku përfundon shikimi i Tij.*”²²

Siç dihet, dremitja, është një periudhë para gjumit, kur qepallat e syve fillojnë të rëndohen, si një parapërgatitje për hyrje në etapën e gjumit. Këtij procesi i nënshtrohen pothuajse të gjitha krijesat, por e njëjta gjë nuk vlen edhe për Atë që krijoi çdo gjë. Nëpërmjet këtij pasazhi, i Madhërishmi dëshiron të na tregojë, se Ai nuk ka ndonjë mangësi, as nuk lodhet

²¹ Transmeton Ebu Davudi (1517); Tirmidhiu (3577). Në lidhje me këtë hadith, Mundhiriu në “*Et-Tergib*” (2414) ka thënë se isnadi i tij është i mirë.

²² Muslimi (179).

dhe as nuk ndien nevojë për gjumë, sepse lodhja dhe gjumi, janë veçori të krijesave. Përkundrazi, Ai mbikëqyr çdo lëvizje dhe veprim që ndodh në gjithësi, dhe asgjë nuk ndodh pa lejen dhe dëshirën e Tij. Ai e mban ekuilibrin e qiejve dhe Tokës, sepse po të mos ishte ky kujdes i Tij, atëherë qiejt dhe Toka do të ndesheshin mes vete dhe do të shkatërrohej gjithësia, ashtu siç thotë i Madhërishmi: ***“Me të vërtetë, Allahu mban ekuilibrin e qiejve dhe të Tokës, që të mos shkatërrohen. Kur ato nisin të shkatërrohen, askush nuk mund t’i mbrojë, pos Tij.”*** - (Fatir, 41).

Gjumi është një lloj vdekjeje e vogël, sepse i fjeturi nuk është i vetëdijshëm për atë që është duke ndodhur rreth tij. Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh. në disa ajete kuranore na ka treguar se gjatë gjumit i nënshtrohemi një lloj vdekjeje të pjesërishme, siç ka ardhur në këtë ajet: ***“Allahu ua merr shpirtat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes po edhe atyre që janë në gjumë e nuk kanë vdekur. Shpirtat e atyre që u është caktuar vdekja, i mban, ndërsa shpirtat e të tjerëve i lë (të kthehen në jetë) deri në një kohë të caktuar. Vërtet, në këtë ka shenja për ata që mendojnë.”*** - (Ez Zumer, 42)

لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ

“Vetëm Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë.”

Nuk ka dyshim se çdo gjë në këtë ekzistencë, përfshirë qiejt dhe Tokën dhe çka në mes tyre janë të Allahut, si Krijues dhe Mbikëqyrës i tyre. Atij i nënshtrohet çdo gjë dhe pushteti i Tij përfshin çdo gjë. Ai, Allahu, ishte para se të kri-

johej ekzistenca, i Pari, pa fillim dhe do të mbetet i Fundit, pa mbarim, pas shkatërrimit të kësaj ekzistence.

Përmendja e qiejve dhe Tokës, ka ardhur në shumë ajete kuranore, sepse krijimi i tyre është prej krijimtarisë më madhështore të Allahut Fuqiplotë, andaj edhe fillimi i kësaj pjese të ajetit me fjalët: *“Lehu-vetëm Atij”* dëfton për veçim, që nënkupton se vetëm Allahut i takon pushteti dhe sundimi në qiej e në Tokë, dhe askujt tjetër. Ky pushtet, është absolut vetëm i Tij, prandaj askush nuk meriton të adhurohet përveç Tij. Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh. thotë: **“A nuk e di ti se vetëm Allahut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës?”** - (*El Bekare, 107*)

Kjo gjithësi me tërë madhësinë e saj, përfshirë qiejt dhe Tokën, yjet dhe galaktikat e shumta, janë krijim i Allahut, andaj edhe pushteti mbi to, i takon Atij që i krijoi dhe i mbiqëqyr. I Lartësuar qoftë Allahu në Madhërinë e Tij.

Kur të Dërguarin a.s. e rëndonte ndonjë brengë a shqetësim, i lutej Allahut me fjalët *“Zot i qiejve dhe i Tokës”*, ashtu siç ka ardhur edhe në këtë transmetim nga Ibn Abasi, i cili citohet të ketë thënë: I Dërguari i Allahut kur kishte ndonjë shqetësim thoshte: **“La ilahe il-la Allah, El-Adhimul Halim, La ilahe il-la Allahu Rabbu-s-semavati ve Rabbul erdi ve Rabbul Arshil Adhim”** – *Nuk ka zot tjetër po Allahut, Të Madhërishtit dhe të Dhembshurit. Nuk ka zot tjetër pos Allahut, Zot i qiejve, Zot i Tokës dhe Zot i Arshit madhështor!*”²³

²³ Buhariu, (6346); Muslimi (2730).

مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ

“Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, përveçse me lejen e Tij?”

Meqë Allahut i përket sundimi dhe pushteti në qiej e në Tokë, atëherë është e natyrshme që çdo gjë në këtë ekzistencë të rrjedh sipas vullneti dhe dëshirës së Tij, dhe asgjë nuk ndodh pa lejen dhe dijen e Tij. Tash, në këtë pjesë të ajetit, kur para nesh hapen pamjet e Ditës së Gjykimit, edhe vetë mënyra pyetëse, na vë në dijeni se askush as që mund të pretendojë shefat-ndërmjetësim tek i Gjithëpushtetshmi, pa lejen e Tij. Thjesht, këtu shfaqet me tërë madhështi, pushteti dhe sundimi i Tij absolut. Në këtë ditë të vështirë, Allahu i Madhërishëm ia ka mundësuar të dërguarve të Tij, engjëjve fisnik, dëshmorëve, disa dijetarëve dhe evliave të Tij që të ndërmjetësojnë për dikë që ta shpëtojnë nga dënimi me zjarr. ***“Atë ditë nuk do të bëjë dobi ndërmjetësimi i askujt, përveç ndërmjetësimit të atij, që i jep leje i Gjithëmëshirshmi dhe që i është pranuar fjala.”*** – (Ta Ha, 109)

Në lidhje me këtë çështje, përveç ajeteve të shumta kuratore që dëshmojnë se pushteti absolut i takon vetëm Allahut dhe askush nuk mund ta flasë e madje as të pëshpëritë pa lejen e Tij, po ashtu kemi edhe shumë hadithe autentike të cilat flasin për shefatin - ndërmjetësimin në Ditën e Gjykimit. Shefati i parë do të jetë pikërisht nga krijesa më fisnike që hapëroi ndonjëherë mbi sipërfaqen e Tokës, Muhamedi a.s., dedikuar ymetit të vet, të cilët e bartën në zemra flamurin e Njëshmërisë. Pas këtij shefati, do të pasojë ndërmjetësimi i të dërguarve të tjerë të Allahut, e pas tyre vjen edhe shefati i

melekëve, siç janë Xhibrili, Israfil, Mikaili dhe Azraili, pastaj i engjëjve që na shoqëruan në jetën e kësaj bote, engjëjve që ishin dëshmitarë të namazeve dhe lutjeve tona, natën dhe ditën, në mirëqenie e në vështirësi. Pastaj vjen shefati - ndërmjetësimi i shehidëve - dëshmorëve, pastaj i dijetarëve e pastaj i evliave, njerëzve të dashur të Allahut.

Kur të kenë përfunduar të gjitha këto ndërmjetësime, atëherë do t'i vijë radha ndërmjetësimit më madhështor, atij nga ana e Allahut, i Cili më mëshirën e Vet të pakufishme, do t'i falë ata besimtarë që kanë pasur mëkate të mëdha, sepse çdo besimtarë mëkatar, i cili nuk e ka mohuar Allahun, të Dërguarit e Tij, ringjalljen dhe Ditën e Gjykimit, pas një kohe, Allahu do ta falë dhe do ta nxjerr nga zjarri i Xhehenemit.

يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ

“Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas tyre”

Dija e Allahut është e pakufishme, sepse Ai ishte i Gjithëdijshtëm që në ezal, e do të jetë i gjithëditur pafundësisht. Dija e Tij përfshin çdo gjë në këtë ekzistencë. Asgjë nuk ndodh pa dijen e Tij absolute. Ai e di të kaluarën, ta tashmen dhe të ardhmen tonë. Çdo veprim yni, hyn në sferën e gjithëditurisë së Allahut të Madhërishëm. Perceptimi ynë njerëzor rreth dijes së Allahut është i mangët dhe tejet i kufizuar. Ne, përkundër zhvillimit të hovshëm teknologjik, nuk mund të shpërthejmë barrierat e të kuptuarit të kësaj diturie hyjnore. Allahu nga mëshira e Tij e pakufishme, duke qenë i dhimbshëm dhe i butë ndaj nesh, na mësoi dituritë e ndryshme, në

mënyrë që ta ndërtojmë e rregullojmë Tokën dhe ta bëjmë sa më të lehtë jetën në të. Allahu na bërë mëkëmbës të Tokës dhe na e la atë në amanet, deri në Ditën e Gjykimit, kur çdo gjë do të shkatërrohet për të filluar një etapë e re e jetës, jeta e përjetshme e Ahiretit, në të cilën më nuk do të ketë as vdekje e as shkatërrim.

Dijetarët janë munduar të na përafrojnë mendimet se çfarë në fakt është synuar në këtë ajet, por që të gjitha mendimet sillen rreth asaj se dija e Allahut është gjithëpërfshirëse, dhe se Atij nuk mund t'i fshihet asgjë nga ajo që ndodh në këtë ekzistencë,²⁴ madje Ai di edhe për rënien e gjethit të thatë nga një pemë, kudo qoftë ajo.

وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِّنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ

“Të tjerët nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse sa Ai dëshiron.”

Allahu i Madhërishëm është i Gjithëdijshëm me Dijen e Tij të përhershme, të pa fillim e të pambarim. As dija jonë njerëzore, por as ajo e krijesave të tjera, përfshirë këtu edhe engjëjt e xhindet, as që mund të krahasohen me Dijen absolute të Tij. Thjesht, i ngjan një pike të vetme uji në një oqean të madh e të pafund. Në lidhje me këtë Dije të paperceptueshme për ne, i Madhërishmi në Kuranin fisnik thotë: ***“Thuaj: “Si-kur deti të ishte bojë për të shkruar fjalët e Zotit tim, sigurisht që ai do të shterej, para se të soseshin fjalët e Zotit tim, edhe sikur Ne të sillnim si ndihmë edhe një det tjetër si ai.” – (El***

²⁴ Dr. Fadl Ilahi, “Fadlu Ajetul Kursij”, Bejrut, 2000, f. 66-67.

Kehf, 109). Edhe në ajetin e 27-të të sures *Llukman*, po ashtu kemi një krahasim të ngjashëm, kur bëhet fjalë për Dijen dhe Fjalët e Zotit të Gjithëdijshëm: **“Sikur të gjithë drurët, që gjenden në Tokë, të ishin pena e deti bojë shkrimi e t’i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të shtereshin fjalët e Allahu. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”**

Nga kuptimi gjeneral i kësaj pjese të Ajetul-Kursisë: **“Të tjerët nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse sa Ai dëshiron”**, vetvetiu nënkuptohet se njerëzit apo krijesat, mund të dinë e mësojnë vetëm aq sa ua mundëson Allahu, që të kenë qasje në Dijen e Tij të pakufishme. Dhe, nga kjo pak dije, që Allahu na e ka dhuruar, ne kemi arritur një përparim kaq të madh në shumë sfera të jetës, por në të shumtën e rasteve, egoja dhe mendjemadhësia njerëzore, na shtyn të harrojmë se tërë kjo mirësi dhe dituri, nuk është rezultat i të arriturave tona, por është dhuratë nga Allahu, i Cili ia mësoi të gjitha dituritë babait të njerëzimit, Ademit a.s., dituri e cila u përcoll pastaj brez pas brezi te çdo gjeneratë njerëzore.

وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ

“Pushteti (Kursija) i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën”

Kjo pjesë e Ajetul-Kursisë, është prej atyre që quhen *“muteshabihat”*-“jo bollshëm të qarta”, prandaj dhe kuptimi i fjalës *“Kursij”* ka shkaktuar polemika e diskutime të shumta në mesin e dijetarëve myslimanë. Dijetarët e Ehli Sunetit: Maturidiu, Eshariu dhe Tahaviu, janë unik në faktin se fjala *Kursij*, këtu nënkupton Pushtetin, Sundimin apo Dijen abso-

lute të Allahut, dhe assesi nuk nënkupton karrige apo ulëse, në të cilën mund të mbështeten këmbët, siç mundohen ta shpjegojnë disa dijetarë, që kuptimeve kuranore u qasen vetëm sipërfaqësisht.

Sipas shkollës akaidologjike të Ehli Sunetit dhe Xhematit, kur flasim për cilësitë e Allahut, në asnjë mënyrë nuk guxojmë t'i përshkruajmë Atij vend, hapësirë e as ta kufizojmë Atë për anë, sepse atëherë Ai do të zinte vend, e një gjë e tillë konsiderohet mangësi dhe nuk përkon me Qenien Absolute si Krijues i Pa fillim dhe i Pambarim. Të tilla janë edhe çështja e Arshit, po edhe e Kursisë. Ky sqarim i shkollarëve të doktrinës akaidologjike të Ehli Sunetit, të fle në zemër dhe ta qetëson shpirtin, aq më parë, kur vetë Zoti i Plotfuqishëm thotë për vete: *“Lejse ke mithlihi shej’un - Askush nuk është i krahasueshëm me Të”*. Pra, Allahun as nuk e përkufizon vendi e as koha, nuk e arrijnë shikimet tona dhe Ai ka dituri për çdo gjë që ndodh në këtë ekzistencë.²⁵

Kur jemi te kjo pjesë e *Ajetul-Kursisë*, ku përmendet Kursija, imami i nderuar bashkëkohor, Ebu Zehre, ka thënë: *“Unë mendoj, se në këtë rast, Kursija, përputhet me mbretërimin e Tij absolut si dhe me dijen e Tij të pakufizuar, sepse këto sqarime përputhen edhe me vetë kontekstin e ajetit në fjalë. Madje, një interpretim të këtillë e ka pëlqyer edhe vetë komentuesi i Kuranit, Abdullah ibn Abasi.”*²⁶

²⁵ Për më gjerësisht shih: Ebu Mensur el Maturidiu, *“Kitabu’t-Tevhid”*, Shkup, 2018, ff. 125-136.

²⁶ Muhamed Ebu Zehre, *“Zehretu-t-Tefasir”*, Kajro, 1987. vëll. II, ff. 939-941.

Pra, ky term në mënyrë gjenerale nënkupton madhështinë e Allahut, fuqinë autoritative dhe shtrirjen absolute të vullnetit dhe pushtetit të Tij ndaj çdo gjëje në këtë gjithësi.

Nëse themi se “*Kursija*” nënkupton Dijen e Tij absolute, atëherë ky kuptim përputhet plotësisht me pjesën paraprake të ajetit: **“Të tjerët nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse sa Ai dëshiron.”**, e nëse themi se “*Kursija*” nënkupton madhështinë e pushtetit të Tij, atëherë shohim se kjo përputhet plotësisht me pjesën vijuese të ajetit: **“dhe Atë nuk e lodh përkujdesja për të dyja”**.

وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا

“dhe Atë nuk e lodh përkujdesja për të dyja”

Allahu xh.sh. është i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithëpushtetshëm. Ai i mban qiejt dhe Tokën të mos bien apo ndeshen mes vete. Ai nuk ndjen lodhje e as nuk i vjen rëndë kujdesi ndaj tyre. Lodhja është cilësi e krijesave, ashtu siç është gjumi dhe vdekja, ndërkohë që këto cilësime apo përsoshkrime, nuk kanë të bëjnë me Krijuesin absolut, i Cili as nuk ndien lodhje, as nuk e kap dremitja e as nuk e zë gjumi, por është i Gjallë dhe i Përvetshëm që nuk vdes kurrë.

Hebrenjtë, i kishin përshkruar mangësi Allahut Fuqiplotë, duke thënë se pasi që Allahu krijoi qiejt dhe Tokën, u lodh, dhe pastaj pushoi në ditën e shtatë. Për t’i demantuar këto shpifje të tyre, Allahu xh.sh. thotë: **“Ne i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çdo gjë që gjendet midis tyre për gjashtë ditë, pa ndierë lodhje aspak.”** - (Kaf, 38).

وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

“Ai është i Larti, Madhështori!”

Ajetul-Kursij, ashtu siç filloi me përmendjen e emrit të bukur **“Allah”**, po ashtu përfundoi me përmendjen e dy emrave të tjerë të bukur të Tij: **“El-Alijj” - i Larti dhe “El-Adhim” - Madhështori**. Dhe nuk ka përfundim më të mirë se sa ajeti më madhështor i Kuranit të përfundojë me përmendjen e dy emrave të bukur, të cilët e plotësojnë kuptimin madhështor të këtij ajeti në të gjitha segmentet e tij kuptimore. Emri i bukur i Allahut **“El-Alij - i Larti”**, nënkupton lartësinë e paarritshme nga askush tjetër, sepse Ai është i Gjithëpush-tetshëm, i Gjithëdijshëm, i Gjallë, i Përvetshëm dhe i Lartë në madhërinë e Tij. Ai është i përsosur në madhështinë e Tij. I lartësuar me cilësitë e përhershme të lartësisë hyjnore që tregojnë mbizotërimin dhe madhështinë ndaj krijesave.

Ajetul-Kursij, përfundon me përmendjen e emrit të bukur të Allahut **“El-Adhim” - Madhështori**, emër i cili nënkupton madhështi, autoritet të pakontestueshëm, sundim, pushtet absolut etj.. Nisur nga kuptimi i këtyre dy emrave të bukur me të cilët përmbillet kjo sure, mund të konkludojmë se Krijuesi Fuqiplotë, Allahu xh.sh., i cilësuar me të gjitha këto cilësi madhështore, vërtetë meriton të quhet Zot i vërtetë dhe të adhurohet me plot të drejtë.

Porositë e Ajetul-Kursisë

- *Ajetul-Kursija, vërteton dhe konfirmon fuqishëm Njeshmërinë e Allahut.*
- *Sipas shumicës së dijetarëve, emri i bukur **Allah** është njëri ndër emrat më të mëdhenj të Zotit Fuqiplotë, dhe të gjithë emrat e tjerë i referohen këtij emri.*
- *Askush pos Allahut nuk meriton të adhurohet, sepse Ai është i vetmi Krijues.*
- *Allahu e ka cilësuar Vetën me emrat: El-Hajj - i Gjalli, që nuk vdes kurrë - gjallëria e Tij është e përhershme dhe e përjetshme, dhe El-Kajjum - i Përjetshmi, Mbikëqyrësi, Mbizotëruesi dhe Rregulluesi i çdo procesi në këtë ekzistencë.*
- *Allahun e Lartmadhërishëm nuk e kap as dremitja e as nuk e zë gjumi, sepse gjumi është cilësi e krijesave, kurse Ai është i Gjallë dhe nuk ka nevojë për gjumë e as pushim.*
- *Sundimi dhe pushteti absolut në qiej e në Tokë, i takon vetëm Allahut.*
- *Allahu pranon ndërmjetësimin dhe kjo ndodh vetëm me lejen e Tij. Ai e pranon ndërmjetësimin - shefatin vetëm prej atyre, ndaj të cilëve është i kënaqur.*
- *Dija e Allahut është gjithëpërfshirëse. Ne mund të dimë vetëm aq sa na mundëson i Gjithëdijshmi.*
- *Kursija e Allahut nënkupton madhështinë e sundimit, pushtetit dhe dijes së Tij gjithëpërfshirëse.*
- *Allahu i Gjithëfuqishëm nuk ndien lodhje dhe as nuk i vjen rëndë kujdesi ndaj kësaj ekzistence, sepse Ai është më i Larti dhe më Madhështori.*

Hajrullah ef. HOXHA

NAMAZI DHE KUSHTET E TIJ* **- Në teori dhe praktikë -**

Namazi është një ndër shtyllat kryesore të fesë islame. Çdo mysliman ose myslimane që është moshëritur dhe i shëndoshë mentalisht, është i obliguar nga Zoti i madhërishëm për të falur namazin pesë herë në ditë.

Ne, duke zbatuar këtë detyrë të shenjtë, në mënyrën më të përsosur, shpirtërisht dhe fizikisht, i shprehim bindjen, falënderimin dhe përvullueshmërinë ndaj Zotit të madhëruar. Namazi është një mjet kryesor, përmes të cilit mbahet lidhshmëria e vazhdueshme e njeriut me Krijuesin e tij.

Dobitë e namazit, si në pikëpamje shpirtërore, ashtu edhe fizike, janë të shumta. Me anë të tij, njeriu edukohet dhe fisnikërohet shpirtërisht, zhvillohet fizikisht, përfordhet moralisht, për t'i përballuar vështirësitë, të cilat i paraqiten në

* Ky punim, megjithëse është botuar në “Takvimin” e vitit 1979, ndërsa me një version të shkurtër edhe në atë të vitit 1986, por për shkak të interesimit të madh sidomos të të rinjëve rreth mënyrës praktike të faljes së namazit, u ribotua me disa përmirësime.

jetë. Namazi, e nxit njeriun në vepra të mira, e prapëson nga veprat e këqija dhe e pastron nga mëkatet (gjynahet).

Përkitazi me këtë, Zoti xh.sh., në një ajet të Kuranit ka thënë: **“...Dhe fale namazin, se vërtet namazi ndalon nga punët e ndyta dhe të shëmtuara”**. Ndërsa, Muhamedit a.s., me një rast iu është drejtuar shokëve të tij, duke i pyetur: *“Çka ua merr mendja juve, sikur ta kishte ndonjëri prej jush një lum pran derës së shtëpisë së tij, në të cilin lahet pesë herë në ditë, a do t'i kishte mbetur papastërti atij?”* Shokët iu përgjigjen se nuk do t'i mbestë kurrfarë papastërtie. Me këtë rast, ai u tha: *“Kështu është shembulli i namazit, Zoti xh.sh. me anë të tij ia fshin mëkatet (gjynahet e vogla atij që falet).”*

Njerëzit, të cilët falen, e që namazi nuk ndikon fare në nxitjen e tyre për punë të mira ose për t'i prapësuar nga punët e këqija, me siguri namazin e falin vetëm formalisht ose sa për sy e faqe para të tjerëve.

Vlera dhe rëndësia e namazit më së miri mund të kuptohet kur merret parasysh se Zoti xh.sh. për faljen e tij, ka urdhëruar në më se shtatëdhjetë vende në Kuran dhe se Muhamedi a.s. në shumë hadithe ka porositur për kryerjen e tij. Andaj, moszbatimi i kësaj detyre të shenjtë, numërohet ndër mëkatet e mëdha, që shkakton ndëshkimin e Zotit, nëse Zoti nuk ia falë këtë mëkat nga mëshira e Tij.

Për faljen e namazit, jemi të obliguar t'i udhëzojmë dhe t'i këshillojmë edhe anëtarët e familjes sonë. Përkitazi me këtë, Zoti xh.sh. ka thënë: **“...Urdhëroje familjen tënde për namaz dhe vetë bëhu i qëndrueshëm në të.”** Ndërsa Muhamedi a.s. ka thënë: *“Urdhëroni fëmijët tuaj për namaz, kur ata i*

bëjnë shtatë vjet, ndërsa rrihni për shkak të (mosfaljes) namazit, kur ata i bëjnë dhjetë vjet.”

Namazi, kryesisht është tri llojesh: 1. *Farz* (detyrë e domosdoshme e urdhëruar nga Zoti xh.sh.) 2. *Vaxhib* (detyrë e obligueshme e urdhëruar nga Zoti xh.sh.) 3. *Synet* (detyrë e porositur nga Pejgamberi - Muhamedi a.s.).

Farz janë pesë kohët e namazit, namazi i xhumasë dhe i xhenazes.

Vaxhib janë vitri i Jacisë dhe namazi i dy Bajramave.

Synnet janë falja e syneteve të pesë kohëve të namazit, të syneteve të xhumasë dhe namazi i teravive.

Çdo njëri prej këtyre namazeve përbëhet prej: dy, tri ose katër reqateve, ndërsa çdo rekat, zakonisht, përbëhet nga qëndrimi në këmbë, këndimi i Kuranit, rënia në ruqu (përkulja) dhe rënia në sexhde (përlulja me fytyrë në tokë).

KUSHTET E NAMAZIT

Kushtet e namazit janë dymbëdhjetë: gjashtë janë përgatitëse për namaz, ndërsa gjashtë të tjera janë pjesë përbërëse të namazit.

Kushtet përgatitëse për namaz janë:

1. Marrja e abdesit (ose guslit-pastrimi i tërë trupit, nëse nuk jemi të pastër);
2. Trupi, rrobat dhe vendi ku falemi të jenë të pastra;
3. Mbulimi i trupit sipas rregullave fetare;
4. Njohja e kohës së namazit;
5. Kthimi në drejtim të Kiblës;
6. Nijeti-vendosja (me zemër) për namaz.

1. Abdesi

Abdes quhet pastrimi i disa pjesëve të trupit për namaz, të cilat më tepër janë në kontakt me punë dhe përrlyhen më shpesh.

Kushtet e abdesit janë katër:

1. *Larja e fytyrës;*
2. *Larja e duarve me gjithë bërryla;*
3. *Lëmimi me dorë të lagur i një të katërtës së kokës;*
4. *Larja e këmbëve me gjithë nyje.*

Këto janë farzet e abdesit, pa plotësimin e të cilave nuk mund të falet namazi. Mirëpo, nëse kemi mundësi t'i plotësojmë edhe synetet dhe mustehabet e abdesit, atëherë duhet të veprojmë sipas rregullave që vijnë.

Eûdhu bil-lâhi minesh-shejtânirr-rraxhîm. Bismil-lâhîrr-rrahmânirr-rrahîm.

“Nevejtu en eteveddae li exhlis-salâti tekarruben ilallâhi teâlâ”

Kjo do të thotë:

“Mbështetem (për mbrojtje) tek Allahu, nga djalli i mallkuar. Në emër të Zotit, Bamirësit të përgjithshëm e Mëshiruesit!”

“Vendosa të marrë abdes për namaz, me qëllim të afërimit te Zoti i madhërishëm”.

Mandej, me marrjen e abdesit vazhdojmë sipas figurave vijuese dhe tekstit udhëzues që është shënuar nën to:



1. Pastrojmë duart tri herë duke i fërkuar mes gishtërinjve.



2. Tri herë shpërlajmë gojën me ujë duke i pastruar dhëmbët me misvak - brushë ose me gishtrinë.



3. Pastrojmë mirë hundën tri herë me ujë, deri në brendësi të saj.



4. Tri herë pastrojmë fytyrën prej ku dalin flokët deri nën mjekër dhe prej veshit në vesh.



5. Nga tri herë lajmë dorën e djathtë, pastaj të majtën me gjithë bërryla.



6. Me shuplakën e dorës së lagur, lëmojmë një të kartëriten e kokës.



7. Më gishtat tregues, pastr-ojmë brendësinë e veshëve, me gishtat e mëdhenj pjesën e jashtme të tyre, ndërsa me shpinën e duarve përshkojmë qafën.



8. Nga tri herë i lajmë këmbën e djathtë dhe të majtë me gjithë nyje.

Ai që nuk i di duatë e abdesit, me rastin e larjes së çdo pjesë të trupit, mund t'i lutet Zotit për t'ia falur mëkatet që i ka bërë me atë pjesë.

Abdestin e prishin këto gjëra

- 1. Kryerja e nevojës së madhe ose të vogël fiziologjike dhe dalja e frymës së ndytë-amonjakut,*
- 2. Rrjedhja e gjakut ose qelbit nga varra, rrjedhja e gjakut nga hunda ose të pështyrit gjak, nëse ia tejkalon sasisë së pështymës,*
- 3. Të vjellurit me plot gojën,*
- 4. Të fjeturit dhe të humburit e vetëdijes,*
- 5. Të dehurit dhe të çmendurit,*
- 6. Të qeshurit me zë në namaz,*

Gjatë marrjes abdes është mekruh e përbuzur (është veprim i keq): të shpenzuarit e ujit shumë ose të kursyerit e tij tepër, të përplasurit e ujit në fytyrë, stërpikja e rrobave me të dhe të biseduarit e pa nevojshëm.

Gusli (larja)

Çdo mysliman dhe myslimane pas marrëdhënieve seksuale ose daljes së spermës-farës me epsh, qoftë edhe në ëndërr, është i detyruar ta pastrojë tërë trupin. Femrat e kanë për detyrë të pastrohen edhe pas ndërprerjes së zakoneve të tyre mujore (menstruacioneve) dhe atyre pas lindjes së fëmijës.

Gusli përbëhet prej këtyre tri kushteve:

- 1. Të lamurit e gojës;*
- 2. Të pastruarit e hundëve;*

3. Të lamurit e tërë trupit duke mos lërë asnjë vend të palagur.

Ky pastrim e zëvendëson edhe abdesin.

Tejemmumi

Nëse brenda një kohe të namazit nuk gjendet ujë, ose gjendet por nuk jemi në gjendje ta shfrytëzojmë, apo kemi pak ujë, i cili na nevojitet për të pirë, atëherë abdesin ose guslin mund ta zëvendësojmë duke marrë tejemmum me dhé ose pluhur të pastër.

Tejemmumi përbëhet nga këto tri kushte:

- 1. Vendosja (nijeti) e marrjes së tejemmumit duke theksuar në emër të abdesit apo guslit.*
- 2. Vënia e shuplakave të duarve mbi dhe ose pluhur dhe përshkimi fytyrës me to.*
- 3. Prapë vënia e shuplakave të duarve mbi dhe ose pluhur dhe përshkimi i dorës së djathtë me të majtën dhe i të majtës me të djathtën deri në bërryla.*

Tejemmumin e prishin ato gjëra të cilat e prishin abdestin dhe të gjeturit e ujit ose mundësia e përdorimit të tij.

2. Pastërtia

Mirëmbajtja e pastërtisë së trupit, rrobave dhe vendit ku falemi, është detyrë e domosdoshme. Trupin dhe rrobat mund t'i mbajmë të pastra nëse me rastin e kryerjes së nevojës së madhe fiziologjike marrim tahret (pastrohemi me ujë), ndërsa të asaj të voglës, ruhemi nga të stërpikurit e urinës (ujit të ndytë), si dhe nëse e pastrojmë trupin, përkatësisht i

ndërrojmë rrobat e brendshme së paku një herë në javë. Si përfaqja e vendit, e cila përfshihet gjatë faljes së namazit, duhet të jetë e pastër. Mirëpo, edhe në qoftë se vendi nuk është i pastër mund të falemi nëse mbi të shtrojmë ndonjë sexhade ose diçka tjetër të pastër.

3. Mbulimi i trupit

Kushti i tretë i përgatitjes për namaz është të mbuluarit e trupit sipas rregullave fetare. Meshkujt, gjatë faljes së namazit duhet ta kenë të mbuluar trupin së paku prej shoke deri nën gjunjë, ndërsa femrat tërë trupin me përjashtim të fytyrës, duarve deri në bylyzyk dhe këmbëve deri në nyje.

4. Koha e namazit

Kushti i katërt i përgatitjes për namaz është njohja e kohës së tij. Çdo namaz e ka kohën e caktuar, në të cilën është paraparë të falurit e tij. Andaj, kohët e namazit janë: koha e sabahut, drekës, ikindisë, akshamit, jacisë, e xhumasë, bajramit dhe e teravisë. Kohët e namazit për tërë vitin, janë të shënuara në Takvim (kalendar), ndërsa lajmërimi i hyrjes së tyre bëhet me anë të ezanit.

Falja e namazit nuk lejohet në momentin kur lind dielli, kur ai është në zenit - pak para se të hyjë koha e drekës dhe në momentin kur dielli perëndon, me përjashtim të farzit të ikindisë së asaj dite, i cili është filluar më parë.

5. Kibla

Me rastin e faljes së namazit, është kusht, kthimi me fytyrë dhe gjoks në drejtim të Kibles, përkatësisht të Qabesë, e cila gjendet në Mekë. Kibla në vendin tonë është në drejtim të juglindjes.

Në qoftë se nuk e kemi të njohur drejtimin e Kibles dhe nuk ka kush të na tregojë, atëherë duhet të drejtohem i kah ajo anë që na e merr mendja më tepër. Në rast se dikush gjatë faljes së namazit na orienton, atëherë kthehem i në atë drejtim, duke mos prishur namazin fare.

6. Nijeti-vendosja

Para se të fillojmë namazin, është kusht që të vendosim me zemër se cilën kohë të namazit dhe çfarë namazi do të fa-
lim. Nijeti është mirë të shqiptohet edhe me gjuhë.

Nijeti i përgjithshëm për çdo kohë të namazit, është si vijon: “Nevejtü en usal-rije lil-lâhi teâlâ salâte fardil-vakti, edâe mustakbilel-kibleti, Allâhu ekber”.

Që do të thotë: *“Vendosa me falë farzin e kësaj kohe, për hir të Zotit të madhërishtëm, u ktheva kah Kibla”, Allâhu ekber.*

Ndërsa, për synet, në vend të fjalës **...Fardil-vakti - farzin e kësaj kohe...**, themi: **synnetil-vakti - synetin e kësaj kohe.**

FARZET E NAMAZIT

Kushtet përbërëse të namazit janë gjashtë:

1. Tekbiri fillestar

Namazi duhet të fillohet me fjalën e shenjtë: **“Allâhu ekber** (Zoti është më i madhi). Këtë fjalë e shqiptojmë duke qëndruar në këmbë dhe duke i ngritur duart me shuplaka të kthyera kah Kibla, barazi me vesh. Në momentin e shqiptimit të këtij tekbitit është mirë që mendimet tona t'i koncentrojmë në namaz dhe të llogarisim se gjendemi në prezencë të Zotit të madhërueshëm.

2. Qëndrimi në këmbë

Qëndrimi në këmbë, drejt, në çdo reqate të namazit, aq sa është e obligueshme të këndohet nga Kurani, është detyrë e domosdoshme. Ai që nuk mund të qëndrojë në këmbë, për shkak të ndonjë pengese, mund të falet ulur. Hapësira mes këmbëve është mirë të jetë një shuplakë, ndërsa gjatë qëndrimit në këmbë është mirë të shikohet vendi i sexhdes.

3. Këndimi i Kuranit

Këndimi i një pjese nga Kurani në namaz, është farz. Zbatimi i tij bëhet nëse këndohen tre ajete të shkurtra ose një ajet i gjatë apo një sure e shkurtër e Kuranit. Është mirë që të këndojmë atë që e dimë më së miri nga Kurani dhe sipas radhës që gjendet në Kuran. Në vazhdim po japim, suren e Fa-

tahas dhe disa sure të shkurtra nga Kurani a.sh. të cilat janë të nevojshme për t'i mësuar¹:

Sûretul-Fâtihah (El-hamdu lil-lâhi)

“Bismil-lâhirr-rrahmânirr-rrahîm”.

“El-hamdu lil-lâhi rab-bil-âlemîn. Err-rrahmânirr-rrahîm mâliki jevmid-dîn. Ij-jâke na'budu ve ij-jâke nesteîn. Ihdines-sirâtal-mustekîm, sirâtal-ledhîne en amte alejhim. Gajril-magdûbi alejhim veled-dâl-lîn”.
(Amin!)

Sûretul-asri (Vel-asri)

“Bismil-lâhirr-rrahmânirr-rrahîm”

“Vel-asri in-nel-insâne lefî husër. Il-lel-ledhîne âmenû ve amilus-sâlihâti ve tevâsav bil-hak-ki ve tevâsav bis-sabër”

Sûretul-kevther (Innâ aëtajnâke)

“Bismil-lâhirr-rrahmânirr-rrahîm”

“In-nâ aëtajnâkel-kevther fesal-li lirab-bike venhar in-ne shânieke huvel-ebter”.

Sûretul-ihlâs (Kul huvallâhu ehad)

“Bismil-lâhirr-rrahmânirr-rrahîm”

“Kul huvallâhu ehad. Allâhus-samed. Lem jelid ve lem jûled ve lem jekun lehu kufuven ehad”

¹ Germat e njëjta që ndahen me vizë, lexohen dyfish-bashkangjitur. Në rastet tjera, viza është shenjë për lexim të ndarë.

Sûretul'felek (Kul eûdhu birabbil-felek)

“Bismil-lâhîrr-rrahmânîrr-rrahîm”

“Kul eûdhu birab-bil-feleki min sherri ma haleka ve min sherri gâsikin idhâ vekab. Ve min sherrin-nef-fâthâti fil-ukadi ve min sherri hâsîdin idhâ hased”

Sûretu-nas (Kul eûdhu birab-bin nâsi)

“Bismil-lâhîrr-rrahmânîrr-rrahîm”

“Kul eûdhu birab-bin-nâsi melikin-nâs, ilâhin-nâs. Min sherril-vesvâsil-han-nâs. El-ledhî juvesvisu fî sudûrin-nâsi minel-xhin-neti ven-nâs

4. Rënia në ruqu-përkulja

Përkulja e trupit, duke i vënë duart mbi gjunj dhe duke drejtuar shpinën horizontalisht, sa mund të thuhet njëherë **“Subhâne rabbijel-adhîm”** në çdo reقات të namazit, është farz. Gjatë qëndrimit në ruqu, këmbët nuk duhet të lakohen në gjunjë, ndërsa shiqimi duhet të përqëndrohet mbi shputat e këmbëve.

5. Rënia në sexhde-përulja

Përulja me fytyrë në tokë, dy herë njërën pas tjetrës, në çdo reقات të namazit, duke qëndruar sa mund të thuhet njëherë **“Subhâne rabbijel-aëlâ”** është e obligueshme. Sexhdja zakonisht bëhet me lëshimin e gjunjëve, shuplakave të duarve dhe ballit me hundë mbi tokë. Bërrylat femrat i lëshojnë në tokë, ndërsa meshkujt jo. Vendi ku bëhet sexhde, nuk bënë të jetë aq i butë, sa që balli të mos e ndien fortësinë e tokës. Me

rastin e rënies në sexhde, duhet kujdesur të mos ndahen këmbët nga toka.

6. Ndeja ulur në fund të namazit

Qëndrimi ulur në fund të çdo namazi, sa mund të këndohet “*Tehijjâti me Shehâdet*” është farz. Kjo bëhet duke u ulur mbi këmbën e majtë të shtruar, ndërsa e djathta duhet të qëndrojë drejt me gishta të lakuar në drejtim të gjunit. Femrat i lakojnë të dyja nga ana e djathtë dhe ulen.

Nëse një nga këto gjashtë farze të namazit nuk zbatohet, namazi duhet të përsëritet, ndërsa nëse kryhet me vonesë, atëherë përmirsohet me sehvi-sexhde (shih faqe 83).

VAXHIBET E NAMAZIT

Në namaz është vaxhib:

1. *Këndimi i Fâtîhasë (El-hamdu lil-lahit) në çdo reqat të namazit.*
2. *Këndimi i një sures ose ajetit nga Kurani, pos Fâtîhas, në dy reqatet e para të namazit farz dhe në të gjitha reqatet të atij synnet dhe vaxhib.*
3. *Këndimi në heshtje (pa zë) në namaz të drekës dhe iqi-ndisë.*
4. *Këndimi i Tehijjâtit me Shehâdet me rastin e ndejës ulur në krye të dy reqateve dhe në fund të çdo namazit.*
5. *Qëndrimi ulur në krye të dy reqateve të namazit që përbëhet prej tre ose katër reqateve.*
6. *Në reqatin e tretë të salati-vitrit të mirret tekbir dhe të këndohet duaqa e Kunutit.*

7. *Në dy reقاتet e namazit të bajrameve, të mirren edhe nga tre tekbire.*
8. *Me rastin e rënies në sexhde të prek në tokë, pos ballit edhe hunda.*
9. *Të falet namazi me “ta’dili-erkân”, d.m.th. të gjitha pjesët e namazit të kryhen me rregull.*
10. *Në fund të çdo namazit të jipet selam.*

Nëse një ose më tepër prej këtyre vaxhibeve i kemi lëshuar gjatë faljes së namazit, ose e kemi kryer me vonesë, atëherë këtë mund të plotësojmë pas selamit, me Sehvi-sexhde. (shif faqe 83).

SYNETET E NAMAZIT

Në namaz është synet:

1. *Ngritja e duarve, për meshkuj barazi me veshë, ndërsa për femra me supe të krahëve, në tekbirin fillestar të çdo namazi, në tekbirin e kunutit të salati-vitri dhe në tekbiret e bajrameve.*
2. *Lidhja e dorës së djathtë mbi të majtën dhe vënia e tyre për meshkuj nën shokë, ndërsa për femra në gjoks.*
3. *Këndimi i Subhânekës pas tekbirit fillestar të çdo namazit dhe në fillim të reقاتës së tretë të synetit të iqindisë, jacisë dhe të çdo katër reqateve të teravive.*
4. *Të kënduarit e Eûdhu bil-lâhit dhe Bismil-lâhit pas Subhânekës, ndërsa këtë të fundit duhet kënduar në fillim edhe të reqateve tjera.*
5. *Pas këndimit të Fâtîhas (El-hamdulil-lâhit), përkatësi-sht në fund të saj, thuhet “Amin” - pranoje, o Zot!*

6. *Shprehja e fjalës “Allâhu ekber” me rastin e shkuarjes në ruqu e sexhde dhe fjalëve “Semiâllâhu limen hamî-deh, - rabbenâ lekel-hamd” duke u ngritur nga ruquja.*
7. *Në ruqu, të thuhet tri herë “Subhâne rabbijel-adhîm”, ndërsa në sexhde tri herë “Subhâne rabbijel-aëlâ”.*
8. *Të qëndrohet në këmbë, drejt dhe të ndahen këmbët, për afërsisht katër gishta.*
9. *Drejtimi horizontal i shpinës bashkë me kokë gjatë qëndrimit në ruqu.*
10. *Ndarja e dy sexhdeve mes veti, duke u drejtuar ulur.*
11. *Këndimi i salavâteve në fund të çdo namazit dhe në ndejën e parë të synetit të iqindisë, jacisë dhe teravive.*

Nëse lëshohet diçka nga synnetet e namazit, edhe pse nuk është mirë, namazi nuk prishet, as nuk ka nevojë për Sehvi-sexhde.

Të gjitha veprimet tjera të cilat i kryejmë gjatë faljes së namazit, dhe pas selamit, janë *mustahab* - të lavdërueshme, sevab.

FALJA E NAMAZIT TË PESË KOHËVE

1. Namazi i sabahut

Koha e namazit të sabahut fillon prej agimit dhe vazhdon deri afër lindjes së Diellit.

Namazi i sabahut, përbëhet prej katër reqateve, dy janë synet dhe dy farz. Së pari ngritemi në këmbë dhe pasi të themi: **Eûdhu bil-lâhi mineshejtânirr-rraxhîm - Bismil-**

lâhîrr-rrahmânîrr-rrahîm, e bëjmë nijetin për faljen e synetit si vijon:

“Vendosa me falë, synetin e sabahut, për Zotin e madhërueshëm, u ktheva kah Kibla, Allahu ekber”²

Mënyrën e të falurit, në teori dhe praktikë, e vazhdojmë siç shënon në tekstin dhe figurat që vijojnë:



1. Duke qëndruar drejt në këmbë, pas nijetit të namazit përkatës, ngrejmë duart me shuplaka të kthyer kah Kibla, në lartësi të veshëve (femrat: të supeve) dhe duke thënë: **“All-llâhu ekber”**, ia fillojmë namazit.

2. Pas tekbirit fillestar, pa i lëshuar duart poshtë, i lidhim të djathtën mbi të majtën, duke i përthekuar në nyje, me gisht të madh dhe të vogël dhe i vëmë nën shokë (femrat në gjoks)

² Përmbajtja e nijetit është e njëjtë edhe për namazet e tjera, përveçse në vend të sabahut, ceket koha e namazit përkatës, ndërsa në vend të synetit thuhet farzin.

Pastaj këndojmë:

Subhâneke Allâhumme ve bihamdike ve tebârekes-muke ve teâlâ xhed-duke ve lâ ilâhe gajruke”

“Eûdhu bil-lâhi mineshejtânirr-rraxhîm. “Bismil-lâhirr-rrahmânirr-rrahîm”.

“El-hamdu lil-lâhi rab-bil-âlemîn. Err-rrahmânirr-rrahîm mâliki jevmid-dîn. Ij-jâke na'budu ve ij-jâke nesteîn. Ihdines-sirâtal-mustekîm, sirâtal-ledhîne en amte alejhim. Gajril-magdûbi alejhim veled-dâl-lîn”.
(Amin!)

Mandej këndojmë një sure, si p.sh.:

“In-nâ aëtajnâkel-kevther fesal-li lirab-bike venhar in-ne shânieke huvel-ebter”.



3. Pas këndimit të sures, duke thënë **“Allâhu ekber”**, përkulemi në ruqu, duart i vëmë mbi gjunjë, kurse shpinën e rrafshojmë dhe themi tri herë: **“Subhâne rab-bijel-adhîm”**.



4. Duke thënë: **“Semîallâhu li-men hamîdeh”**, drejto-hemi në këmbë dhe themi: **“Rab-benâ lekel-hamd”**, pastaj mbështetemi me duar në gjunjë dhe shkojmë në sexhde.



5. Së pari i vëmë gjunjtë në tokë, pastaj shuplakat e duar e dhe duke thënë **“Allâhu ekber”**, e vëmë ballin dhe hundën në tokë. Në sexhde tri herë themi: **“Subhâne rab-bijel-aëlâ”**.

Duke thënë: “Allâhu ekber”, nga sexhdja drejtohem për një moment të shkurtër dhe përsëri bëjmë edhe një sexhde, njësoj sikurse herën e parë.



6. Nga sexhdja duke thënë **Allâhu ekber**, ngritemi në këmbë, për të falur reqatin e dytë.

Me këtë rast këndojmë: **“Bismil-lâhirr-rrahmânirr-rrahîm”**.

“El-hamdu lil-lâhi rab-bil-âlemîn. Err-rrahmânirr-rrahîm mâliki jevmid-dîn. Ij-jâke na’budu ve ij-jâke nesteîn. Ihdines-sirâtal-mustekîm, sirâtal-ledhîne en amte alejhim. Gajril-magdûbi alejhim veled-dâl-lîn”.
(Amin!)

Pataj këndojmë një sure, p.sh.:
“Kul huvallâhu ehad. Allâhus-samed. Lem jelid ve lem jûled ve lem jekun lehu kufuven ehad”



7. Pas këndimit të sures, duke thënë **“Allâhu ekber”**, përkulemi në ruqu dhe veprojmë si në reqatin e parë



9. Me fjalën **“Allâhu ekber”**, biem në sexhde, ku themi tri herë: **“Subhâne rab-bijel aëlä”**. Duke thënë: **“Allâhu ekber”**, nga sexhdja drejtohem për një moment të shkurtër dhe përsëri bëjmë edhe një sexhde, njësoj si kurse herën e parë.



8. Duke thënë: **“Semîallâhu li-men hamîdeh”**, drejtohem në këmbë, për një moment të shkurtër, e pastaj themi: **“Rab-benâ lekel-hamd”**.



10. Duke thënë: **“Allâhu ekber”** drejtohem nga sexhdja e dytë dhe ulemi në gjunjë. Shputën e këmbës së majtë e shtrojmë dhe ulemi mbi të, ndërsa të djathtë e mbajmë drejtë me gishtërinjë të lakuar, (femrat i lakojnë që të dyat kah ana e djathtë dhe ulen). Shuplakat e duarve i vëmë mbi gjunjë.

Duke ndejtur ulur këndojmë: **Tehijjâtin, Shehâdetin, Salavâtet dhe duatë:**

“Et-tehijjâtu lil-lâhi ves-salavâtu vet-tajjibâtu es-selâmu alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullâhi ve berekâtuhû, Es-selâmu alejnâ ve alâ ibâdil-lâhis-sâlihîn”.

“Esh-hedu en lâ ilâhe il-lallâh. Ve esh-hedu enne Muhammeden abduhû ve resûluhû”.

“Allâhumme sal-li alâ Muhammedin ve alâ âli Muhammed. Kemâ sal-lejte alâ Ibrâhîme ve alâ âli Ibrâhîme inneke hamîdun mexhîd”

“Allâhumme bârik alâ Muhammedin ve alâ âli Muhammed. Kemâ bârekte alâ Ibrâhîme ve alâ âli Ibrâhîme inneke hamîdun mexhîd”.

“Rabbenâ âtinâ fiddunjâ haseneten ve fil-âhireti haseneten ve kinâ adhâbennâr”.

“Rabbenâgfir lî ve livâlidejje ve lil-muëminîne jevme jekûmul-hisâb”.



11. Duke shikur supin e krahut të djathtë themi: “Es-selamu alejkum ve rahmetullah”. Pastaj, duke shikuar supin e majtë, përsërisin: “Es-selamu alejkum ve rahmetullah”.

Pas selamit, çdo herë, këndohet kjo lutje:

“Allâhumme entes-selâmu ve minkes-selâm. Tebâ-
rekte jâ dhel-xhelâli vel-ikrâm.”

Pas faljes së synnetit, ngritemi në këmbë për ta falur farzin e sabahut. Së pari bëhet ikameti, i cili është obligim vetëm për meshkuj, me përmbajtjen që vijon:

“Allâhu ekber, Allâhu ekber, Allâhu ekber, Allâhu ekber.

Esh-hedu en lâ ilâhe il-lallâhu, esh-hedu en lâ ilâhe il-lallaâh,

Esh-hedu enne Mulmmmederr-rresûlullâhi

esh-hedu enne Muhammederr-rresûlullâh.

Hajje ales-salâti, hajje ales-salâh.

Hajje alel-felâhi, haje alel-felâh.

Kad kâmetis-salâtu, kad kametis-salâh.

Allâhu ekber, Allâhu ekber, lâ ilâhe il-lallâh

Me përfundimin e ikametit, e bëjmë nijet faljen e farzit:

“Vendosa me falë, farzin e sabahut, për Zotin e madhërishëm, u ktheva kah Kibla, Allahu ekber”.

Farzi i sabahut falet njësoj si syneti, përkatësisht në reqatin e parë pas tekbirit fillestar, këndojmë: **Subhâne-ken, Eûdhu bil-lâhin, Bismil-lâhin dhe një sure;** e bëjmë ruqun dhe sexhden, ndërsa në reqatin e dytë këndojmë: **Bismil-lâhi, El-hamdu lil-lâhin dhe një sure.** Në fund të reqatit të dytë ulemi dhe këndojmë: **Tehijjâtin, Shehâdetin, duatë dhe japim Selam.**

Pas selamit e këndojmë **Allâhumme entes-selâm...** e mandej themi:

“Alâ resûlinâ selavât” dhe e këndojmë **Selavatin.**

Mandej e këndojmë këtë lutje:

“Subhânallâhi vel-hamdu lil-lâhi ve lâ ilâhe il-lallâhu
vallâhu ekber ve lâ havle ve lâ kuvvete il-lâ bil-lâhil-
alijjil-adhîm”.

Mbas kësaj këndojmë **Tesbih-dovën** (Ajeti-kursinë):
**Eûdhu bil-lâhi minesh-shejtânirr-rraxhîm, bismil-lâhirr-
rrahmânirr-rrahîm.**

“Allâhu lâ ilâhe il-lâ huvel-hajjul-kajjûm. Lâ teêhu
dhuhû sinetun ve lâ nevmun lehû mâ fis-semavâti ve
mâ fil-erd. Men dhel-ledhi jeshfeu indehû il-lâ bi
idhnihi, jaëlemu mâ bejne ejdîhim ve mâ halfehum ve
lâ juhîtune bishej-in min ilmihî il-lâ bimâ shâe, vesia
kursijuhus-semâvâti vel-erda ve lâ jeûduhû
hifdhuhumâ ve huvel-alijjul-adhîm”.

Mbas këndimit të Tesbih-dovës, themi: **Jâ rabbi dhel-
xhelâli subhânallâh**” dhe tërheqim në tesbih duke thënë 33
herë **Subhânallâh**. Mandej themi: **“Subhânel-bâki dâimenil-
hamdu lil-lâh”** dhe e përsërisim 33 herë fjalën **“El-hamdulil-
lâh”**. Vazhdojmë duke thënë: **“Rabbil-âlemîne teâlâ shânuhû
Allâhu ekber”** dhe e përsërisim 33 herë fjalën **Allâhu ekber**.

Në fund e këndojmë këtë lutje:

“Lâ ilâhe il -lallâhu vahdehû lâ sherîke leh. Le hul-
mulku ve lehul-hamdu ve huve alâ kul-li shej-in
kadîr”.

Me këtë rast i ngrejmë duart dhe e bëjmë duanë (lutjen) e
namazit:

Shuplakat e duarve i drejtojmë kah qielli dhe bëjmë dua-
në e namazit, kurse pas duasë përshkojmë fytyrën me to.

Duaja e namazit:

“El-hamdu lil-lâhi rabbil-âlemin. Ves-salâtu ves-se-lâmu alâ resûlinâ Muhammedin ve alâ âlihî ve as-habihî exhmeîn.

Allâhumme rabbenâ tekabbel-minnâ salâtena ve sijâmenâ ve kijâmenâ ve kirâetenâ, ve rukuânâ ve suxhûdenâ, ve kuşdenâ, ve tesbîhanâ, ve tahmîdenâ ve tehlîlenâ, ve tedarruanâ ve temmim taksîrenâ, ve lâ tadrib bihâ vuxhûhenâ jâ mevlânâ birahmetike jâ erhamerr-rrâhimîn. Rabbenâ âtinâ fid-dunjâ haseneten ve fil-âhireti haseten ve kinâ adhâben-nâr. Rabbenagfir lenâ ve li vâlidinâ ve li ihvâninâ, ve li ehâvâtinâ ve li akrabâinâ, ve li xhemîl-muëminîne velmuëminâti-l-ahjâi minhum vel emvâti, birahmetike jâ erhamerr-rrahimîn. Ve selâmun alel-murselîne vel-ham-du lil-lâhi rabbil-âlemîn. **(El-fâtiha)**

(Pas përshkimit të fytyrës me duar, e këndojmë **El-hamdu lil-lâhin** dhe **Salavâtin**).

Kjo dua është e përgjithshme, andaj vlenë për të gjitha namazet.

Kjo mund të bëhet edhe në gjuhën amtare si vijon:

Falënderimi qoftë për Zotin, Krijuesin e gjithësisë. Bekimi dhe shpëtimi qofshin mbi profetin tonë, Muhamedin, mbi familjen dhe mbarë shokët e tij.

O Zoti ynë, pranoje namazin tonë, agjërimin tonë, qëndrimin tonë në këmbë, këndimin tonë të Kuranit, ruqutë, sexhdet dhe ndejtjet tona ulur, lavdërimet, falënderimet, njësimet dhe lutjet tona me përulje, na i

plotëso të metat tona e mos na i përplas ato fytyrës sonë, me mëshirën tënde o më i mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve.

O Zoti ynë, na i fal gjynahet (mëkatet) tona, të prindërve tanë, vëllezërve dhe motrave tona, të farefisit tonë, të gjithë myslimanëve dhe myslimaneve, që janë të gjallë dhe të vdekur, me mëshirën Tënde o më i mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve.

Shpëtimi qoftë mbi të gjithë profetët dhe lavdi e falënderimi qoftë për Zotin, krijuesin e gjithësisë. (El-fātiha).³

2. Namazi i drekës

Koha e namazit të Drekes fillon pasi të kalojë Dielli zenitin-kupën qiellore dhe vazhdon deri sa të zgjatet hija e objekteve sa vetë objektet, duke përjashtuar hijen e mesditës.

Namazi i drekës përbëhet prej dhjetë reqateve: katër janë synet, katër farz dhe dy synete të fundit.

Pas nijetit për faljen e synetit dhe marrjes së tekbitit fillestar në reqatën e parë këndojmë: **Subhâneke, Eûdhu bil-lâhin, Bismil-lâhin, El-hamdulil-lâhin** dhe **një sure**.

Pas rënies në ruquë dhe sexhde, në reqatën e dytë këndojmë **Bismil-lâhin, El-hamdu lil-lâhin** dhe **një sure**. Në fund të dy reqateve me rastin e qëndrimit ulur, këndojmë: **Tehijjâtin** dhe **Shehâdetin**.

³ Pjesa prej fjalës: *Alâ resûlinâ salavât...* e deri në përfundim të duasë së namazit, pa kurrfarë ndryshimi, përdoret në fund të gjitha namazeve

Në rekatën e tretë dhe të katërt këndojmë: **Bismil-lâhi, El-hamdu lil-lâhi dhe nga një sure.** Në fund të rekatës së katërt, gjatë qëndrimit ulur këndohet: **Tehijjâti, Shehâdet, Salavâtet, duat dhe jepet Selam.**

Pas ikametit, nijjetit për farz të drekës dhe tekbirin filleshtar, në rekatën e parë këndojmë: **Subhâneken, Eûdhu bil-lâhin dhe një sure.** Pas ruqusë dhe sexhdes, në rekatën e dytë këndojmë: **Bismil-lâhi me El-hamdu lil-lâhin dhe një sure.** Gjatë qëndrimit ulur në krye të dy reqateve këndohet: **Tehijjâti dhe Shehâdeti.**

Në rekatën e tretë dhe të katërt të farzit, këndohet vetëm: **Bismil-lâhi me El-hamdu lil-lâhin.** Në fund të katër reqateve, gjatë qëndrimit ulur, këndohet: **Tehijjâti, Shehâdeti, Salavâtet, duat dhe jepet Selam.**

Pas nijjetit për synet të mbramë të drekës dhe tekbirin filleshtar, në rekatën e parë këndojmë: **Subhâneke, Eûdhu bil-lâhin, Bismil-lâhin, El-hamdu lil-lâhin dhe një sure.**

Pas ruqusë dhe sexhdes, në rekatën e dytë këndojmë: **Bismil-lâhin El-hamdu lil-lâhin dhe një sure.** Në fund të reqates së dytë, duke qëndruar ulur këndohet: **Tehijjâti, Shehâdeti, Salavâtet, duat dhe jepet Selam.**

Mandej veprohet siç është shënuar në fund të namazit të sabahut.

3. Namazi i iqindisë

Koha e namazit të iqindisë fillon prej momentit kur hija e objekteve zgjatet sa vetë objekti, duke përjashtuar hijen e mesditës, dhe vazhdon deri në perëndim të Diellit.

Namazi i iqindisë përbëhet prej tetë reqateve, katër janë synet ndërsa katër janë farz.

Pas nijetit për faljen e synetit dhe tekbirit fillestar, dy reqatet e para falen si ato të synetit të drekës, ndërsa gjatë qëndrimit ulur në fund të tyre, përveç **Tehijjâtit** me **Shehâdet** duhet kënduar edhe **Salavâtët**.

Në reqatën e tretë, duhet të këndojmë: **Subhânekën, Eûdhu bil-lâhin, Bismil-lâhin, El-hamdu lil-lâhin** dhe një **sure**, ndërsa në reqatin e katërt: **Bismil-lâhin, El-hamdu lil-lâhin** dhe një **sure**. Në mbarim të reqatit të katërt, si zakonisht këndojmë: **Tehijjâtin, Shehâdetin, Salavâtet, duat** dhe japim **selam**.

Pas faljes së synetit ngritemi në këmbë, e bëjmë ikametin dhe nijetin për faljen e farzit të iqindisë.

Këto katër reqate, falen plotësisht si katër reqatet e farzit të Drekës.

Në fund të namazit, tërheqim në tesbih dhe e bëjmë dua-në e tij.

4. Namazi i Akshamit

Koha e namazit të akshamit fillon prej perëndimit të Die-llit dhe vazhdon deri të errësohet plotësisht.

Namazi i Akshamit përbëhet prej pesë reqateve: tri janë farz e dy synnet.

Pas ikamelit, nijetit për farz dhe tekbirit fillestar, në reqa-
tin e parë këndojmë: **Subhâneken, Eûdhu bil-lâhin. Bismil-
lâhin, El-hamdu lil-lâhin dhe një sure.** Në reqatin e dytë:
Bismil-lâhin, El-hamdu lil-lâhin dhe një sure. Gjatë qëndri-
mit ulur këndojmë: **Tehijjâtin** me **Shehâdet** ndërsa në reqa-
tën e tretë e këndojmë: **Bismil-lâhin dhe El-hamdu lil-lâhin.**
Në fund të reqatit të tretë ulemi dhe këndojmë: **Tehijjâtin,
Shehâdetin, Salavâtet, duatë dhe japim Selam.**

Pas faljes së farzit ngritemi në këmbë dhe e bëjmë nijet
faljen e synetit. Këto dy reqate, falen njësoj si syneti i saba-
hut ose syneti i drekës.

Pas faljes së synetit, tërheqim në tesbih dhe e bëjmë du-
anë e namazit.

5. Namazi i jacisë

Koha e namazit të jacisë fillon prej errësimit të plotë dhe
vazhdon deri në kohën e imsaqit. Namazi i jacisë përbëhet
prej trembëdhjetë reqateve, katër janë Synnet, katër Farz, dy
synet të fundit dhe tri Salati-vitër.

Pas nijetit për faljen e synetit, vazhdojmë faljen e këtyre
katër reqateve, duke vepruar njësoj si me rastin e faljes së
synetit të iqindisë.

Pas faljes së synetit, e bëjmë ikametin dhe nijetin për faljen e farzit. Këto katër reqate falen si ato të farzit të iqindisë ose të drekës.

Mbas faljes së farzit, i falim dy reqate synet të fundit të iqindisë, ku veprojmë si me rastin e faljes së Synnetit të fundit të drekës.

Mandej, ngritemi në këmbë dhe i bëjmë nijetin e faljes së Salati-vitrit. Dy reqatet e para falen si ato dy të farzit të akshamit. Duke qëndruar ulur këndojmë: **Tehijjâtin** me **Shehâdet**, ndërsa në reqatën e tretë, pas këndimit të **El-Hamdu lil-lâhit** me **një sure**, i ngrisim duart barazi me veshë, duke thënë: **“Allâhu ekber”** si në tekbinin fillestar. Pas lidhjes së duarve, duhet kënduar **duanë e Kunutit** si vijon:

“Allâhumme innâ nestefnuke ve nestagfiruke, ve nestehdîke ve nuëminu bike, ve netûbu ilejke ve netevakkelu alejke ve nuthni alejkel-hajre kul-lehu, neshkuruve ve lâ nekfuruke ve nahleu ve netruku men jufxhuruve.”

“Allâhumme ijâke naëbudu ve leke nusal-li ve nexhudu ve ilejke nes-a ve nahfidu, nerxhû reahmeteke ve nahsha adhâbeke inne adhâbeke bil-kuffâri mul hikun”.

Pas kësaj, e bëjmë rumunë, sexhden dhe duke ndejtur ulur, si zakonisht, këndojmë: **Tehijjâtin, Shehâdetin, Salavâtet, duat** dhe japim **selam**.

Namazin e përfundojmë me tërheqjen në tesbih dhe bërjen e duasë, si në namazet e kohëve tjera.

NAMAZET E TJERA

Namazi i xhumasë

Namazi i xhumasë falet ditën e premte, në kohën e namazit të drekës. Ky namaz falet me xhematë dhe është i obligueshëm vetëm për meshkuj.

Namazi i xhumasë bashkë me drekën e mbramë i ka gjashtëmbëdhjetë reqate. Katër synete, dy farz, katër synet të fundit të xhumasë, katër namaz të drekës së fundit dhe dy synnet të vaktit.

Nijeti për synnet bëhet kështu:

“Vendosa me e falë synetin e xhumasë, për Zotin e madhërishëm, u ktheva kah Kibla, Allahu ekber”.

Në reqatin e parë i këndojmë: **Eûdhu bil-lâhin, Bismil-lâhin, El-hamdulil-lâhin dhe një sure.** Në të dytën: **Bismil-lâhin El-hamdu lil-lâhin dhe një sure.** Në të ndejturit e parë ulur i këndojmë: **Tehijjâtin dhe Shehâdetin**, ndërsa në dy reqatet e fundit i këndojmë: **Bismil-lâhin, El-hamdu lil-lâhin dhe nga një sure.** Në të ndejturit e fundit i këndojmë: **Tehijjâtin, Shehâdetin, Salavâtet dhe japim Selam.**

Pas faljes së synetit, muezini e këndon ezanin në xhami, ndërsa kur mbaron ezani, imami e këndon hydben (ligjëratën), të cilën duhet dëgjuar me vëmendje. Ai që arrin me vonesë në xhuma, përkatësisht pasi që imami ka filluar këndimin e hydbës, ai duhet të dëgjojë hydbën, ndërsa synetin që i ka mbetur mund ta plotësojë pas faljes së farzit të xhumasë.

Kur përfundon hydbja, muezini e bën ikametin, me që rast ngritemi në këmbë dhe e bëjmë nijetin e farzit si vijon:

“Vendosa me e falë farzin e xhumasë, për Zotin e madhërishëm, u ktheva kah Kibla, iu ujdisa këtij imami...” dhe kur thotë imami *“Allâhu ekber”*, themi edhe ne pas tij.

Pasi që këto reqate falen me imam, atëherë në fillim të reqatës së parë e këndojmë vetëm **Subhâneken, tekbirët e lutjet e ruqve** dhe **sexhdeve** dhe me rastin e të ndejturit ulur: **Tehijjâtin, Shehâdetin, Salavâtet** dhe në fund japim **Selam** pas imamit.

Mbas farzit, falen prap katër reqate synet të xhumasë duke bërë nijetin si vijon:

“Vendosa me falë synetin e fundit të xhumasë, për Zotin e madhërishëm, u ktheva kah Kibla, Allâhu ekber”. Këto katër reqate falen njësoj se ato të synetit të parë.

Mandej, vazhdojmë me faljen e namazit të drekës së fundit duke bërë nijetin si vijon:

“Vendosa me e falë namazin e drekës së fundit... për Zotin e madhërishëm, u ktheva kah Kibla, Allâhu ekber.”

Këto katër reqate falen sikur katër reqatet e farzit të drekës, përkatësisht në reqaten e parë këndohet: **Subhânekja, Eûdhu bil-lâhi, Bismil-lâhi, El-hamdu lil-lâhi** dhe **një sure**, ndërsa në të dytën këndohet: **Bismil-lâhi, El-hamdu lil-lâhi** dhe **një sure**. Në ndejën ulur në krye të dy reqateve këndohet: **Tehijjâti** dhe **Shehâdeti**, ndërsa në dy reqatet e fundit këndohet vetëm **Bismil-lâhi** me **El-hamdu lil-lâhin**. Në ndejën e

fundit si zakonisht këndohet: **Tehijjâti, Salavâtet, duatë dhe japim selam.**

Mbas këtyre katër reqateve, faien dy reqate synet duke bërë nijetin kështu:

“Vendosa me falë synetin e kësaj kohe, për Zotin e madhërishëm, u ktheva kah Kibla, Allâhu ekber”.

Këto dy reqate falen njësoj si dy reqatet c fundit të drekës.

Në fund veprohet si në namazet tjera, përkatësisht këndohet: **Subhâne, Eûdhu, Bismil-lâhi, Tesbih-dova**, nga 33 herë **Sub-hânallâh, El-hamdu lil-lâh Allâhu ekber**, mandej **lâ ilâhe il-lallâhu** dhe bëhet duaja me imam.

Xhumanë nuk e kanë borxh: gratë, udhëtarët, të sëmurit e të burgosurit.

Mosfalja e xhumasë, pa ndonjë arsye të madhe, numrohet ndër mëkatet e mëdha. Përkitazi me këtë, pos tjerash, Muhamedi a.s. ka thënë: *“Ai që i le tri xhuma rresht pa i falur, ai e ka hedhur pas shpinë fenë islame”.*

Namazi i Bajramit

Në vit, janë dy Bajrama, njëri në fund të Ramazanit, i cili quhet Bajrami i Fitrit (ngase në prag të tij jepen Fitrat) ose siç e quajmë Bajrami i Madh. Ndërsa tjetri është dy muaj e dhjetë ditë pas tij, në kohën e Haxhit dhe quhet Bajrami i Kurbanit (ngase në të prehen kurbanet) ose siç e quajmë ne Bajrami i Vogël.

Koha e namazit të Bajramit fillon 45 minuta pas lindjes së Diellit. Namazi i Bajramit është vaxhib (detyrë e nevojshme), përbëhet prej dy reqateve dhe falet me imam.

Nijeti i namazit të Fitër-Bajramit bëhet kështu:

“Vendosa me falë namazin e Fitër-Bajramit, për Zotin e madhërishëm, u kthieva kah Kibla, iu ujdise këtij imami dhe pasi të thotë imami “Allâhu ekber”, themi edhe ne.

Pas tekbirit fillestar, e këndojmë në heshtje **Subhânekën**, e mandej imami i merr tri tekbire rresht, ndërsa ne i përsërisim pas tij. Duart duhet ngritur lart si në tekbirin fillestar, e vetëm pas tekbirit të tretë ato i lidhim në shokë. Me këtë rast imami e këndon **El-hamdu lil-lâhin** dhe **një sure**, ndërsa ne dëgjojmë në heshtje. Pastaj, e bëjmë ruquën dhe sexhdet si në namazet tjera dhe ngritemi në reqatën e dytë. Në fillim të reqates së dytë, imami e këndon **El-hamdu lil-lâhin** dhe **një sure**, e pastaj bashkë me të i marrim tri tekbire rresht si në reqatin e parë, ndërsa duke marrë tekbirin e katërt shkojmë në ruqu.

Mbas ruqus dhe sexhdeve të rehatit të dytë ulemi në gjunj dhe këndojmë si në namazet tjera: **Tehijjâtin**, **Shehâdetin**, **Salavâtet** dhe pas imamit japim **selam**.

Mbas faljes së namazit, imami e këndon hydben, ndërsa ne dëgjojmë me vëmendje dhe në fund bashkërisht bëhet duaja.

Nijeti i namazit të Kurban-Bajramit bëhet si vijon:

“Vendosa me falë namazin e Kurban-Bajramit, për Zotin e madhërishëm, u ktheva kah Kibla, iu ujdise

*këtij imami, dhe kur të thotë imami “Allâhu ekber”,
themi edhe ne.*

Ky namaz falet njësoj sikur namazi i Fitër-Bajramit.

Namazi i taravive

Gjatë muajit Ramazan, përveç pesë kohë namazit të zakonshëm, duhet falur edhe namazin e taravive. Ky namaz është synet dhe falet në kohën e jacisë, përkatësisht pas synetit të fundit të saj dhe Salati-vitrit. Teravitë përbëhen prej 20 reqateve, të cilët zakonisht ndahen në pesë pjesë me nga katër reqate. Ky namaz është i obligueshëm si për meshkuj ashtu edhe për femra dhe falet me xhemat ose vetmas.

Nijeti për namaz të taravive bëhet si viojn:

*“Vendosa me falë njëzet reqate namaz të taravive,
për Zotin e madhërishëm, u ktheva kah Kibla,
“Allahu ekber”. Nëse falemi me imam, themi: *iu ujdisea këtij imami, “Allahu ekber”.**

Në reqatën e parë duhet të këndohet: **Subhâneke, Eûdhu bil-lâhi, Bismil-lâhi, El-hamdu lil-lâhi dhe një sure.** Pas ruqës dhe sexhdës, në reqatin e dytë, këndohet: **Bismil-lâhi, El-hamdu lil-lâhi dhe një sure.** Pas sexhdes së rehatit të dytë duhet të ulemi në gjunj dhe t'i këndojmë: **Tehijjâtin, Shehâdetin dhe Salavâtet.**

Në reqatin e tretë duhet të këndohet: **Subhâneke, Eûdhu bii-lâhi, Bismil-lâhi, El-hamdu lil-lâhi dhe një sure.** Ndërsa, në reqatin e katërt duhet kënduar: **Bismil-lâhi, El-hamdu lil-lâhin dhe një sure.**

Pas sexhdes së rekatit të katërt ulemi dhe i këndojmë: **Tehijjâtin, Shehâdetin dhe Salavâtet, duat dhe japim selam.**

Përveç nijetit, i cili nuk përsëritet, kështu falen ose përsëriten edhe katër herë nga katër reqate. Andaj plotësohen njëzet reqate. Në fund bëhet dua ja e taravive.

Mandej, falen tri reqate Salati-vitër dhe përfundohet me tesbih dhe dua të jacisë.

Nëse falemi me imam, atëherë pas tekbirit fillestar këndojmë: **Subhâneken, tekbiret** dhe duatë e ruquve dhe sexhdeve, ndërsa në fund të dy reqateve **Tehijjâtin, Shehâdetin dhe Salavâtet.** Në fillim të rekatit të tretë: **Subhâneken,** mandej tekbiret, duat e ruquve dhe të sexhdeve, ndërsa në fund të katër reqateve: **Tehijjâtin, Shehâdetin, Salavâtet,** duatë dhe japim **selam** pas imamit. Me këtë rast edhe namazi i Vitrit duhet të falet me imam. Përveç asaj që këndohet me imam në namazet e tjera, në rekatën e tretë pas tekbirit, duhet t'i këndojmë edhe duanë e Kunutit.

Namazi i xhenazës

Namazi i xhenazës është farzi-kifaje, obligim i përgjithshëm. Ky namaz falet duke qëndruar në këmbë dhe përbëhet prej katër **tekbireve** dhe **selamit.** Duart ngriten barazi me veshë vetëm në tekbirin e parë, ndërsa me rastin e tekbireve tjera mbahen lidhur.

Nijeti për namaz të xhenazës bëhet si vijon:

“Vendosa me falë namazin e xhenazës, lavdinë për Zotin e madhërishëm, salavatën për Pejgamberin, lutjen për këtë të vdekur, u ktheva kah Kibla iu ujdisa

këtij imami, dhe kur thotë imami “*Allâhu ekber*”, the-mi edhe ne.

Pas tekbirit fillestar e këndojmë **Subhâneken** në këtë më-nyrë:

Subhâkneke Allâhumme ve bihamdike ve
tebârekesmuke ve teâlâ xhedduke ve xhel-le
thenâuke ve lâ ilâhe gajruke.

Mandej, pas imamit e marrim tekbirin e dytë dhe i kë-ndojmë **Salavâtet**, ndërsa mbas tekbirit të tretë e këndojmë duan-lutjen për të vdekurin si vijon;

“Allâhummagfir lihajjinâ ve mejjitinâ ve shâhidinâ ve
gâibinâ ve kebîrinâ ve sagîrinâ, ve dhekerinâ ve
unthânâ. Allâhumme men ahjejtehû minnâ feahjihî
alel-islâmi ve men teveffejtehû minnâ feteveffehû
alel-îmâni. Ve hussa hâdhe-lmejite birrevhi verrâhati
vel-magfireti vel-gufrân. Allâhumme in kâne muh-
sinen fezid fî ihsânihi ve in kâne mûsien fetexhâvez
anhu ve lekkihil-emne vel-bushrâ vel-kerâmete ve-
zzulfâ birahmetike jâ errhâmerr-rrâhimîn.

Kush nuk e di këtë dua, në vend të saj mund të këndojë:
Allâhumme rabbenâ âtinâ fiddunjâ haseneten vefil-
âhireti haseneten ve kinâ adhâben-nâr. Rabbenagfir
lî ve livâlidejje ve lil-muëminûne jevme jekûmul-
hisâb”.

Nëse as këtë nuk e di, atëherë, e këndon **El-hamdu lil-lâhin**.

Mbas tekbirit të katërt jepet selami, lëshohen duart posht,
e mandej ngriten me shuplaka kah qielli dhe i këndohet për
shpirt të vdekurit nga një **El-hamdu lil-lâh** dhe **Salâvat**.

Duaja pranë varrit

Pas mbulimit të xhenazës me dhe, pranë varrit të vdekurit, imami e bënë këtë dua-lutje, ose të ngjashme me te, ndërta ne (xhemati) pas çdo fjalie e përcjellim me fjalën “Amin”:

“Falënderimi i qoftë Zotit i cili në librin e tij të ndershëm ka thënë: Çdo person do ta shijojë vdekjen, e pastaj te Ne keni për t'u kthyer”. Bekimi dhe shpëtimi qofshin mbi zotërinë tonë, profetin Muhamed, në lidhje me të cilin është shpallur: “Vërtet ti do të vdesish, por edhe ata do të vdesin.” Edhe mbi familjen dhe shokët e tij, të cilët kur u ndodhte ndonjë fatkeqësi thonin: “Ne jemi të Zotit dhe me siguri te Ai do të kthehem”.

O Zoti ynë! Mëshirona me Kuran të madhërishëm dhe na e bënë atë prijës, dritë, udhërrëfyes dhe mëshirë, o më i mëshirshmi mëshirues. O Zotin, sevabin (fitimin) e kësaj që e kemi kënduar nga Kurani i ndershëm, dërgoja dhuratë shpirtit të zotërisë dhe profetit tonë Muhamedit, bekimi e shpëtimi qoftë mbi te, dhe shpirtërave të familjes dhe të mbarë shokëve të tij, edhe shpirtërave të besimtarëve dhe besimtareve, të gjallëve e të vdekurve dhe posaçrisht shpirtit të zotit të këtij varri në këtë vend.

O Zoti ynë, bëje varrin e tij një kopsht prej kopshteve të Xhenetit, e mos ia bëj atë gropë prej gropave të Xhehenemit. O Zot, përforcoje këtë në jetën e gjithmonshme me fjalën e vërtetë, sikur që e ke përforcuar me të në këtë jetë dhe bërë prej atyre që nuk do të ketë frikë për ta as nuk do të dëshpërohen.

O Zoti ynë, bëje shpirtin e tij të gëzuar, mëkatet e tij të falura, veprat e tij të pranuar, jepja librin (e vep-rave) të tij në dorë të djathtë, llogarite me llogari të lehtë dhe furnizojë me begati të Xhenetit nga mëshira e jote, o më i mëshirshmi mëshirues.

O Zoti ynë, ndihmona të ngadhënjejmë kundër armi-qëve Tuaj dhe armiqëve tonë, shëroj të sëmurët tonë, mëshiroj të vdekurit tonë dhe na e përfundo me besim jetën tonë, me mëshirën tënde, o krijues i gjithësisë.

O Zoti ynë, vërtet ne e kemi dëgjuar thirrësin duke thënë: besojeni Zotin tuaj, dhe ne besuam. O Zot, na i fal mëkatet tona, na i shlyej të këqijat tona, dhe na e merr shpirtin me njerëz të mirë.

Qoftë lavdëruar dhe i pastër Zoti i ytë i plotëfuqishëm nga ato që ia përshkruajnë, pagja e shpëtimit qoftë mbi profetët dhe lavdi i qoftë Zotit, krijuesit të gjithësisë". (El-fâtîha) - këndohet nga një El-hamdul lil-lâh për shpirt të tij.

Talkini mbi varr

Pas duasë, imami ngritet në këmbë dhe ia thërret talkinin, të vdekurit, ndërsa xhemati e dëgjojnë me vëmendje. Përmbytja e tij duhet të ketë karakter përkujtues dhe këshillues, e jo të ndonjë referatit ose vajtimit, ngase këto janë të përbuzura sipas parimeve islame. Talkini mund të jetë me përmbytje të këtyllë ose të ngjashme me të⁴:

⁴ Teksti i këtij talkini është përkthyer nga "Talkini i madh" me pak ndryshime. Emri në kllapa është marrë si shembull, andaj duhet të zëvendësohet me emrin e të vdekurit përkatës.

“O (Muhamed i biri i Havës), kujtoje besën me të cilën ke dalë prej kësaj bote, dëshminë se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është profet i Tij, se Xheneti është i vërtetë, Xhehenemi është i vërtetë, ringjallja është e vërtetë, Kiameti do të vjen, nuk ka dyshim në të dhe se Zoti do t'i ringjallë ata që janë në varre. Siç ka thënë Zoti, qoftë bekuar dhe madhëruar, në librin e Tij të ndershëm: “Prej toke u kemi krijuar, në tokë do t'ju kthejmë dhe prej toke do t'ju ringjallim për herë të fundit. Zoti i forcon ata që besojnë me fjalën e vërtetë në jetën e kësaj bote dhe në jetën tjetërs, ndërsa zullumqarët i çon në humbje. Zoti punon çka të dojë.

Kujtoje gjithashtu se ti ishe i kënaqur me Allahun për Zot, me Muhamedin, bekimi e paqja qoftë mbi të, për profet, me Kuranin për prijës, me Qabenë për Kible, dhe me besimtarët për vëllezër. Prandaj, kur të vijnë dy melaqë myzhdedhënës dhe qortues, nga Zoti i mëshirshëm e të pyesin: kush është Zoti yt, kush është profeti yt, cila është feja jote, kush është prijësi yt, cila është Kibla jote dhe kush janë vëllezërit e tu, mos u frikëso dhe as mos u dëshpro, por me gjuhë të kthjelltë, atyre përgjigju: Zoti im është Allahu, profeti im është Muhamedi, feja ime është feja islame, prijësi im është Kurani, Kibla ime është Qabja dhe vëllezërit e mij janë besimtarët.

O (Muhamed i biri i Havës), thuaj nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është profet i Tij.

O (Muhamed i biri i Havës), ti shkove para nesh, ndërsa ne do të vijmë pas teje, Zoti na i faltë mëkatet ty dhe neve dhe në dashtë Zoti, ne do të bashkohemi me ty.

O Zot, mos e le këtë të vetëm, por shoqëroje me mëshirën Tënde dhe bashkoje me shpirtërat e të mirëve.

O Zoti i madhërishëm, bëje shpirtin e tij prej atyre që i fton duke thënë: “O ti shpirt i bindur e i qetë, kthehu te Zoti yt duke qenë i kënaqur dhe i pranuar me kënaqësi. Hyr në mesin e robërve të mi dhe hyrë në Xhennetin Tim.”

Qoftë i pastër Zoti i yt i plotëfuqishëm nga ato që ia përshkruajnë, paqja qoftë mbi profetët dhe lavdi i qoftë Zotit krijuesit të gjithësisë. “El-Fâtihah”

Falja e namazit me xhematë

Namazi me xhematë është më i lavdueshëm se vetmas, për njëzet e shtatë gradë. Namazi me xhematë është kur pas imamit falen një a më tepër persona. Falja me xhematë e namazit të xhumasë dhe Bajramave është kusht (farz), ndërsa e pesë kohëve të namazit, xhenazës dhe taravive është syneti muekkede (i fortë). Me imam-xhematë falen vetëm farzet e pesë kohëve të namazit, farzi i xhumasë, namazi i Bajramit, i xhenazës i taravive dhe i Vitrit në Ramazan.

Namazi me imam-xhematë falet si vijon:

Muezini, ose kushdo që di, e bën ikametin me zë dhe kur të thotë fjalën: **Hajje ales-sâlati, hajje ales-salâh**, ngritemi në këmbë për ta bërë nijetin e farzit përkatës.

Nijeti për çdo Farz të namazit bëhet si kur falemi vetmas, përveç se pas fjalës: u ktheva kah Kibla, i shtohet edhe kjo fjalë: *iu ujdisa këtij imami*. Tekbirin fillestar-**Allâhu ekber**, duhet ta marrim në të njëjtën kohë ose pas imamit, e jo para tij, ngase atëherë ai namaz nuk vlenë. Pas tekbitit fillestar e këndojmë vetëm **Subhâneken**, e pastaj heshtim. Kur thotë imami **Allâhu ekber** për në ruqu, themi edhe ne, ndërsa në ruqu themi tri herë **Subhâne rabbijel-adhîm**. Duke u ngritur nga ruquja, imami thotë: **Semî-Allâhu limen hamîdeh**, ndërsa ne themi pas tij: **Rabbenâ lekel hamd**, e pastaj duke përsëritur fjalën **Allâhu ekber**, pas imamit, përulemi në sexhde, ku tri herë themi: **Subhâne rabbijel-aëlâ**. Duke thënë **Allâhu ekber** pas imamit drejtohem nga sexhdeja dhe prap përulemi në sexhden e dytë ku veprojmë si në të parën.

Pas mbarimit të sexhdes së dytë, duke thënë **Allâhu ekber** pas imamit, ngritemi në këmbë për ta falur reqatin e dytë, në të cilën veprojmë si në reqatin e parë, me përjashtim të **Subhânekës**, e cila nuk këndohet.

Nëse namazi përbëhet prej dy reqateve atëherë, duke qëndruar ulur e këndojmë: **Tehijjâtin, Shehâdetin, Salavâtet, duat**, dhe kur jep imami **Selam**, japim edhe ne, pastaj bashkë me muezinin e këndojmë: **Allâhumme entes-selâm...**

Në qoftë se namazi përkatës përbëhet prej tri ose katër reqateve, atëherë e këndojmë vetëm **Tehijjâtin** me **Shehâdet** dhe ngritemi për t'i falur edhe ato. Gjate qëndrimit në këmbë, në reqatin e tretë dhe të katërt, heshtim ndërsa tekbitet e ruqusë dhe sexhdeve dhe lutjeve të tyre i këndojmë si në dy reqatet e para. Në fund qëndrojmë ulur dhe i këndojmë: **Tehi-**

jjâtin, Shehâdetin, Selavâtet, duat dhe japim **selam**, pas imamit.

Mandej, kur thotë muezini: **Alâ resûlinâ Salavât**, ne e këndojmë **Salâvatin**, kur e këndon: **Subhânellâhin...** ne e këndojmë **Tesbih-dovën**, kur thotë: **ve huvel-alijjul-adhîmu jâ rabbi dhel-xhelâli subhânallâh**, themi 33 herë **Subhânallâh**, kur thotë **Subhânel-bâki dâimenil-hamdu lil-lâh**, themi 33 herë **El-hamdu lil-lah**, ndërsa kur thotë **Rabbil-âl-emîne teâlâ shânuhu Allâhu ekber**, ne themi 33 herë **Allâhu ekber**. Mbas këndimit të **Lâ ilâhe il-lâliahu...** i ngritim duart dhe e bëjmë duanë e namazit bashkë me imamin, të cilën nëse e dimë, mund të këndojmë edhe vetë në heshtje, ndërsa nëse nuk e dimë, atëherë e përsërisim shpeshherë fjalën: Amin (pranoje o Zot!).

Nëse kemi arritur në xhematë me vonesë, atëherë duhet të veprojmë si vijon:

Në qoftë se e takojmë imamin në ruqu, atëherë duke qenë drejtë në këmbë e marrim tekbinin fillestar dhe menjëherë bashkangjitemi. Reqati numrohet i zënë nëse përkulemi në ruqu, ende pa filluar imami për t'u drejtuar nga ruqja.

Nëse na ka kaluar një reqat, e marrim tekbinin fillestar dhe vazhdojmë faljen e reqateve tjera me imam. Në fund të namazit duke ndejtur ulur e këndojmë vetëm **Tehijjâtin** me **Shehâdet** e pastaj kur të jap imami **selam**, ne nuk japim, por ngritemi dhe e falim reqatin e mbetur, duke kënduar atë që është dashur të këndohet në të, përkatësisht **Subhâneken, Eûdhu bil-lâhin, Bismil-lâhin, Elhamdu lil-lâhin** dhe **një sure**, përkatësisht sikur që falemi vetmas. Në këtë mënyrë veprojmë edhe nëse na kanë kaluar dy reqate, me përjashtim

të farzit të akshamit, ngase ato duhet të ndahen edhe me një ulje ku e këndojmë **Tehijjâtin** dhe **Shehâdetin**. Ndërsa, në qoftë se na kanë kaluar tri reqate, atëherë pasi që të jap imami **selam**, e falim edhe një reqate dhe ulemi në gjunj ku e këndojmë **Tehijjâtin** me **Shehâdet** e pastaj i falim edhe dy **reqatet tjera**, duke kënduar në të parën **El-hamdu lil-lâhin** me **një sure**, ndërsa në të dytën vetëm **El-hamdu lil-lâhin**. Në këtë mënyrë reqati që e kemi falur me imamin ka qenë vetëm me **El-hamdu lil-lâh** dhe kjo e fundit, ndërsa dy të mesmet janë falur me **El-hamdu lil-lâh** dhe nga **një sure**. Në të ndejturit e fundit ulur e këndojmë: **Tehijjâtin, Shehâdetin, Salavâtet, duat** dhe japim **selam**.

Nëse e takojmë imamin me xhematë duke qëndruar ulur, në fund të namazit e marrim tekbinin fillestar dhe ulemi. Pas dhënies së selamit, ngritemi dhe namazin përkatës e falim vetmas. Në këtë rast e kemi fituar sevabin e namazit me xhemat.

Nëse e takojmë imamin duke falur farzin e sabahut me xhematë dhe jemi të bindur se do t'i zëjmë, ende pa dhënë selam, e falim synetin. Përndryshe iu bashkangjitemi në farz. Pas faljes së farzit, syneti i sabahut nuk falet më.

Në namazet e tjera, nëse muezini ka filluar ikametin për farz, atëherë në atë moment synetin nuk e falim, por lidhemi në farz. Pas faljes së farzit, e falim synetin e mbetur, nëse është i drekës ose xhumasë, ndërsa syneti i iqindisë dhe i jacisë, pas farzit nuk falet fare.

Në qoftë se jemi vonuar, dhe imami e ka filluar namazin e taravive, atëherë duhet të falim farzin dhe synetin e fundit të jacisë, e pastaj lidhemi në namaz të taravive. Reqatet e

mbetura, qoftë (dy, katër, gjashtë etj.) i falim kur t'i përfundon imami taravitë. Pas faljes së reqateve të kaluara, e falim *Salati-vitrin*.

Falja e namazit kaza

Çdo namaz, duhet falur në kohën e tij të paraparë, por nëse eventualisht ndonjërit prej tyre i ka kaluar koha, me arsye ose pa të, jemi të obliguar ta falim edhe pas kohe. Kjo e falur quhet *kaza*-zbatim.

Kaza, mund të falen vetëm farzet e pesë kohëve të namazit dhe Salati-vitri i Jacisë. Nëse sabahu nuk është falur para lindjes së Diellit, atëherë bëhet kaza edhe syneti, por vetëm deri në kohën e drekës.

Namazi kaza, mund të falet në çdo kohë, përveç atyre tri kohëve në të cilat nuk lejohet falja: me rastin e lindjes së Diellit, kur gjindet në zenit-mesditë dhe me rastin e perëndimit të tij.

Nijeti për faljen e namazit kaza bëhet si vijon: p.sh. për Sabah: “*Vendosa me falë farzin e sabahut të fundit për Zotin e madhërishëm, u ktheva kah Kibla “Allâhu ekber”*”.

Ky është nijeti i përgjithshëm për faljen e namazit kaza, me të vetmin përjashtim që i ndryshohet emri i kohës së namazit, kështu që nëse e falim farzin e drekës, atëherë themi në vend të sabanut të fundit: “drekës së fundit” etj.

Sehvi-sexhdja

Nëse gjatë faljes së namazit na kujtohen se me harresë ose gabimisht e kemi vonuar ndonjë pjesë përbërëse (farz) të namazit ose ndonjë nga vaxhibet e tij e kemi lënë apo vonuar, atëherë këto gabime-lëshime mund t'i përmirësojmë me Sehvi-sexhde.

Sehvi-sexhdja bëhet në këtë mënyrë: Pas dhënies së selamit, në njërën apo në të dy anët, përulemi duke i bërë edhe dy sexhde, zakonisht si sexhdet tjera të namazit, e pastaj ulemi në gjunj dhe këndojmë sikur para dhënies së selamit: **Tehijjâtin, Shehâdetin, Salavâtet, duat** dhe japim prap **Selam**, në të dy anët.

Sehvi-sexhdja bëhet në këto raste:

1. Nëse kemi harruar të këndojmë *El-hamdu lil-lâhin* në ndonjë reqatë të namazit.
2. Në qoftë se e kemi harruar këndimin e sures pas *El-hamdu lil-lâhit* në njërën nga dy reqatet e farzit ose në njërën nga katër reqatet e synetit.
3. Nëse kemi harruar të rrimë ulur pas dy reqateve në namazet që përbëhen prej tri ose katër reqateve.
4. Nëse nuk e kemi kënduar *Tehijjâtin* në uljen e parë ose të fundit të namazit.
5. Në qoftëse në uljen e parë (krye dy reqateve) të farzit, të synetit të drekës apo të xhumasë, mbas *Tehijjâtit* e kemi kënduar *Salavâtin*, madje edhe nëse vetëm pjesën e parë të tij.
6. Nëse në reqaten e tretë të *Salati-vitrit*, kemi harruar të marrim *tekbirin* ose të këndojmë *duanë* e *Kunutit*.

7. Nëse gabimisht nuk kemi ndejtur ulur në fund të namazit, por jemi ngritur duke menduar se ende nuk i kemi plotësuar reqatet, nëse na kujtohet ky gabim para se të bëjmë sexhden e rehatit të tepërt, atëherë ulemi, e këndojmë Tehijjâtin e Salavâtet, japim selam dhe bëjmë Sehvi-sexhde. Nëse ky gabim na kujtohet pas rënies në sexhde për reqati e tretë të namazit prej dy reqateve, ose reqatit të pestë të atij prej katër reqateve, atëherë ky namaz nuk vlenë, por duhet të përsëritet.
8. Nëse kemi ndejtur ulur në fund të namazit, por gabimisht jemi ngritur dhe e kemi falur më tepër një reqat, atëherë e falim edhe një dhe pas selamit e bëjmë Sehvi-sexhden. Dy reqatet e fundit numërohen nafile.

Rastet që e prishin namazin

Namazin e prishin këto veprime:

1. Të folurit në namaz;
2. Të qajturit ose të qeshurit sa e dëgjon vet. Ndërsa po të jetë me zë, prishet edhe abdesi;
3. Të kollitur e panevojshëm;
4. Të ngrënurit ose të pimurit në namaz;
5. Të angazhuarit (vepruarit) me të dy duart;
6. Të kruarit ose diç tjetër, tri herë në një rukën (pjesë kryesore e namazit, si p.sh. gjatë qëndrimit në këmbë, ose në ruqu etj.);
7. Të ecurit më tepër se dy hapa;
8. Të lexuarit gabim të ndonjë pjese të Kuranit, nëse i prishet kuptimi;

9. *Të shmangurit e gjoksit nga drejtimi i Kiblës;*

10. *Të falurit e mashkullit në një saf (rresht) me femër pa pasur ndërmjet tyre perde ose zbrazëtirë sa mund të falet një person.*

Në namaz është *mekruh* - e përbuzur lëvizja me duar ose trup pa nevojë, të shikuarit lart ose anash, peshimi herë në një këmbë herë në tjetrën, të mos drejtuarit mirë nga ruqja dhe ndërmjet sexhdeve, të shtruarit e të dy këmbëve dhe ulja mbi to pa pasur ndonjë pengesë, si dhe të mbajturit për ndonjë send duke u ngritur në këmbë pa nevojë.

Literatura e konsultuar:

- Ibrahim el Halebi, "*Halebi-s-Sagir*", Indi, 1312 h.
- Haxhi Sulejam Kemura, "*Mësimi i shkurtë mbi namazin dhe jasinin sherifin*", Prishtinë 1964.
- Fejzullah Haxhibajriq, *Ilmihal (Themelet e fesë islame) përktheu H. Sherif Ahmeti*, Prishtinë 1983
- Halil Haverić - Ismail Haverić, "*Zašto i kako se klanja namaz*", Sarajevë 1987.

Resul ef. REXHEPI

KONTRIBUTI I EBU HANIFES NË SHKENCËN E FIKHUT - JURISPRUDENCËS ISLAME

“Dikur njerëzit thoshin: Allahu e ka zbukuruar Ebu Hanifen me fikh dhe dituri, si dhe me moral të marrë nga Kurani!” Ebu Jusufi

Hyrje

Studimi i jetës, mendimeve dhe veprave të Ebu Hanifes, ka një rëndësi të veçantë për myslimanët shqiptarë dhe komunitetin islam te ne. Jo vetëm për faktin se Ebu Hanife është themeluesi i medhhebit që u pranua nga myslimanët vendas në arealin shqiptar duke pranuar Islamin përmes osmanëve, dhe as për shkak të sfidës së disa aspekteve të traditës sonë islame shqiptare të rrënjosura në medhhebin hanefi, por edhe për shkak të rëndësisë aktuale të mendimeve të tija juridike dhe zgjidhjeve konkrete për shumë probleme bashkëkohore me të cilat përballen myslimanët në mbarë botën.

Imami i fukahave, Numan b. Thabit b. el-Merzubani, i mbiquajtur Ebu Hanife, lindi në vitin 80 H./699, kurse ka ndërruar jetë në vitin 150 h./767. Rrjedh nga një familje e ndershme e me autoritet në mesin e bashkëvendësve të tij. Me origjinë vjen nga Kabuli (kryeqyteti i sotshëm i Afganistanit). Gjyshi i tij Merzubani¹ e kishte pranuar fenë islame gjatë kohës së Omer b. Hatabit dhe kishte migruar në Kufe të Irakut të sotshëm. Kështu Imami Ebu Hanife lindi në Kufe. Numani hapat e parë të fëmijërisë së tij i kishte filluar në Kufe, ku babai i tij kishte një dyqan për shitjen e rrobave, e më pas atë do ta zëvendësoj i biri.² Disa autorë kanë shkruar se ai i takoi disa nga sahabët që ishin akoma gjallë gjatë kohës sa ky rritej, si Enes b. Malik, Abdullah b. el-Harith ez-Zubejdi, Abdullah b. Ebu-l Eufa, Vasile b. el-Eskaa etj.. Nuk ka dëshmi të qëndrueshme se këto takime janë zhvilluar, por është e sigurt se Ebu Hanife i ka takuar dijetarët më të rëndësishëm dhe më të shquar të kohës së tij, dhe se ka studiuar me shumë prej tyre, si me: Zejd b. Aliun, Nafi Mevla ibni

¹ Ka edhe variante të tjera sipas të cilave thuhet se gjyshi i tij përveç Numan, quheshe edhe Merzuban, kurse sipas një varianti të tretë është quajtur edhe Zuta, megjithëse këto mundën me qenë sinonime të njëra-tjetrës. Ky, Merzubani ka qenë nën kujdesin e fisit Tejm, kështu që në sajë të kësaj edhe Ebu Hanifeja është quajtur “Et-Tejmij”, (nuk është fjala për Temim nga kurejshitet). Më gjerësisht: Abdul-Xhelil el-Karnshavi, *Dirasat fi Esh-Sheriati l Islamiyye*, botime të Universitetit të Benghazi, Libi, 1973. Gjithashtu Vehbi Sylejman Gavoqi, Ebu Hanife En-Nu'man, Daru-l-Kalem, Damask, bot. i pestë 1993, Muhamed Ebu Zehre, *Tarih el-medhaheb el-islamiye*, pj. II-të *fi tarihi l medhaheb el fikhijje*, bot. Dar el-Fikr el-Arabij, Kajro, pa v. bot.

² Nga sa dihet, Numani ka qenë fëmija i vetëm i prindërve të tij, pra nuk ka pas vëlla.

Omerit, Ibën Shihab el-Zuhriun, Rebiatu Rr'ejin, Sufjan eth-Theuriun, Shu'be el-Haxhaxhin, El-Evzaiun, Malik b. Enesin etj.. Megjithatë, ai studioi më gjatë dhe më intensivisht në rrethin e myftiut të Kufes, Hammed b. Ebu Sulejmanit, trashëgimtari i mendimit juridik të Ibrahim el-Nehaiut, i cili trashëgoi fikhun e Abdullah b. Mesudit dhe Ali b. Ebu Talibit r.a.. Ajo që ngelët e pakontestuar është se Ebu Hanifeja i ka takuar gjeneratës së tabiinëve. Gjithsesi, ai pjesën më të madhe të kohës së tij sa ka qenë i ri, e ka kaluar duke i ndjekur mësimet-ligjëratat e Hamad bin Ebi Sulejmanit dhe Ata' bin Rebahas. Pas kalimit të Hamadit nga kjo jetë, atë do ta zëvendësojë Ebu Hanifeja, sepse tashmë ishte autoriteti më i madh për çështjet e së drejtës islame dhe përfaqësuesi më i denjë i shkollës juridike kufanase. Këtë e përmendem vetëm për të ilustruar mjedisin e tij intelektual dhe shpirtëror, i cili padyshim pati ndikim në profilizimin dhe drejtimin e tij të mëvonshëm shkencor.

Në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare e shoqëroi babin e tij për ta kryer haxhin dhe për ta vizituar Xhaminë e Pejgamberit a.s. në Medine, me ç'rast që takuar me dijetarin e famshëm Abdullah el-Harith b. Xhuz'in el-Zubejdij, i cili kishte dëgjuar shumë hadithe nga Pejgamberi a.s..

Imami Ebu Hanife ka ndërruar jetë në vitin 150 h. (767 m.) në burg ose pak ditë pasi është liruar në Bagdad ku edhe është varros. Namazin e xhenazes ia kanë falur gjashtë grupe për shkak të kallaballëkut të madh.³

³ Islam Web.net, një shkrim për biografinë e Ebu Hanifes.

Në këtë punim nuk do të flasim për jetën, edukimin dhe pjekurinë intelektuale, pikëpamjet dhe angazhimet e tij doktrinare e politike, sepse kjo nuk është qëllimi jonë me këtë rast.

Pjesën më të madhe synojmë ta paraqesim për kontributin e Ebu Hanifës në fushën e fikhut, jurisprudencës islame. Kjo, para së gjithash, për disa arsye:

E para: Është e pa diskutueshme se Imami Ebu Hanife ka qenë fakihu - juristi islam më i madh i të gjitha kohërave, për se gjithsesi meriton të përmendet dhe të përkujtohet ndër breza;

E dyta: Fikhu i tij, dispozitat dhe çështjet të cilat janë të trashëguara nga ai, janë aplikuar dhe vazhdojnë të aplikohen nga më shumë se gjysma e myslimanëve në tërë rruzullin tokësorë. Për më tepër, aktualiteti i tyre ka qenë dhe vazhdon të jetë i rëndësishëm për të gjithë ata që dëshirojnë që të njëjtat t'i aplikojnë në praktikë;

E treta: Burimet mbi të cilat Ebu Hanifeja e mbështet mendimin e tij juridik, janë mjaft interesante, meritojnë qasje studimore sa herë që paraqitet nevoja. Vend me rëndësi, me këtë rast, ka sidomos qëndrimi i Imamit ndaj politikës së kohës kur ai jetoi, titullarëve politikë dhe gjeneratave të para pas Pejgamberit a.s..⁴

⁴ Muhamed ebu Zehre, Tarih el-medhaheb el-islamiye, pj. II-të *fi tarihi l medhaheb el fikhijje*, bot. Dar el-Fikr el-Arabij, Kajro, pa v. bot.

Fikhu - fusha kryesore e studimeve të Ebu Hanifes

Lidhur me interesimin permanent të këtij dijetari, sidomos me fushën e fikhut, ndonëse janë dhënë mendime të ndryshme nga ana e dijetarëve, megjithatë konsiderojmë se përgjigjja më e saktë është ajo që Imami me një rast i kishte dhënë Ebu Jusufit. Në të vërtetë, teksa imami zhvillonte mësimet, nxënësi i tij, Ebi Jusufi, e kishte pyetur nëse imami i nderuar ishte marrë më shumë me këtë fushë ? Ai i qe përgjigjur se unë e zgjodha shkencën e fikhut, sepse sa herë e lexoja, e studioja, sa herë që thellohesha në të, më bënte që ta doja akoma më shumë, kënaqesha me zgjidhjet që më ofronte, ndjeja vetën të qetë e rehat edhe kur i sistemonim teorikisht, e gjithashtu edhe kur zgjidhjet i praktikonim në praktikë. Një gjë të tillë nuk e kam gjetur te shkencat e tjera. Pastaj, për mua - vazhdoi imami - kur takoja dijetarë e sidomos fukaha, dukshëm përfitoja nga dituria e tyre, e kjo më jepte krahë. Kam vërejt se njeriu pa e mësuar mirë e mirë këtë shkencë, pra fikhun, nuk mund t'i kryej ashtu siç duhet dhe siç kërkohen nga ai obligimet fetare. Ne nuk do të mund t'i kryejmë obligimet tona si për këtë botë ashtu edhe për botën tjetër (Ahiretin) pa mos qenë të njoftuar mirë me dispozitat që i ka kjo shkencë. Kjo më ka shtyrë që unë t'i përkushtohem kësaj shkence, natyrisht duke iu kushtuar vëmendje edhe shkencave të tjera, sepse pa i njohur edhe ato nuk mundet të jesh i kompletuar.

Nga një konstatim kaq bindës, me plotë kureshtje për të bërë zgjidhje meritore për çështje teorike dhe praktike, me kaq pasion për t'iu qasur kësaj shkence sa të gjerë po aq edhe

interesante, këtë e gjejmë vetëm tek imami i nderuar. Nxënësit e tij, të cilët e përcillnin atë në çdo hap, ishin dhënë aq shumë dhe kishin arritur të thelloheshin aq mirë në çështjet e fikhut. Madje, disa prej tyre si Ebu Jusufi, Muhamed H. Shejbaniu, Zyfer bin Hudhejl el-Kajsiu e ndonjë tjetër, arritën gradë të lartë studimore në këtë fushë, aq sa në raste të caktuar kishin mendimet personale, nganjëherë edhe në kundërshtim me imamin - mësuesin e tyre. E, kjo i dhuronte imamit kënaqësi të vërtetë, kënaqej me të arriturat e nxënësve të tij.

Karakteristikat e mendimit juridik të Ebu Hanifes

Ebu Hanifeja, gjatë kohës kur ai jetoi, është marrë me çështje të fikhut në mënyrë teorike dhe praktike. Shkenca e fikhut si dhe bazat e metodologjisë së fikhut (Usul el-fikh) nuk kanë qenë të sistemuara ashtu siç duhet, prandaj Imami Ebu Hanife është i pari nga dijetarët e ymetit që është marrë me këtë fushë në mënyrë të detajuar dhe duke sistemuar rregulla të fikhut, duke realizuar kështu një përparim të lakmueshëm në praktikën juridike, dhe, natyrisht se aty ka lënë gjurmë të pashlyeshme.

Ndër karakteristikat kryesore të mendimit juridik të Ebu Hanifes mund ta përmendim se interpretimi i tij është konsistent, teknikisht i zhvilluar mirë dhe i pastruar nga ndërhyrjet anësore. Megjithatë, ai asnjëherë nuk e ka konsideruar interpretimin e tij të së drejtës fjalë të fundit të shkencës, e aq më pak edhe si dogmë. Në këtë kontest, është e mirënjohur thë-

nia e tij: *“Kjo njohuri e jona është vetëm një mendim; kjo është më e mira që kemi mundur ta arrijmë. E, kush mundet të bëjë një zgjidhje tjetër, ka të drejtë në mendimin e tij njëjtë sikur ne që kemi të drejtë në mendimin tonë.”*⁵

Burimet mbi të cilat mbështetej Imami Ebu Hanife me rastin e zgjidhjes së interpretimeve juridike janë sipas kësaj radhitjeje:

1. *Kurani* - الْقُرْآنُ الْكَرِيمُ . Është shtylla e Sheriatit, është burimi i parë mbi të cilin mbështetej imami. Zgjidhjen e akëcilës mesele të fikhut duhet kërkuar në Kuran, kështu që zgjidhjen që e ofron Kurani, imami e pranon me përparësi.
2. *Syneti - tradita e Pejgamberit a.s.* - السُّنَّةُ الشَّرِيفَةُ , megjithëse ishte mjaft detajist dhe mjaft i përpiktë në pranimin e haditheve,⁶ ai e konsideronte shpjegues të Kuranit, interpretues të asaj që ka zbrit përmbledhurazi. Syneti është kumtim (teblig) i Pejgamberit a.s. për mesazhin e Allahut xh.sh. drejtuar njerëzimit. Ebu Hanifeja thoshte: *“Nëse e kam shprehur mendimin tim për*

⁵ Qadri Anvar Ahmed, *Islamic Jurisprudence in the modern World*, Lahore, 1981.

⁶ Ebu Hanifeja është akuzuar nga disa dijetarë të kësaj shkence se nga “hadi-thi-kauli” si të saktë (mutevatir) i ka pranuar vetëm 17 transmetime, ndonëse, më vonë autoritetet hanefite këtë e kanë demantuar duke e vërtetuar me shembuj konkret nga praktika e imamit se ai sipas nevojës hadithet i ka përdorur mjaft shumë, por gjithnjë duke e vërtetuar saktësinë e hadithit. Këto demantime janë përmbledhur dhe në literaturë njihen si *“Mesanidu Ebi Hanife”*, punë kjo që e kishte bërë djali i Ebu Jusufit, e më vonë edhe dijetarë të tjerë. Të gjitha këto më vonë qenë botuar në Indi. Më gjerësisht: Fikret Karçiq, *“Historia e së drejtës së sheriatit”* bot. FSHI, 1987, Sarajevë.

një çështje të caktuar, e më pas dikush për të njëjtën ka sjellë një hadith, me këtë rast duhet vepruar sipas hadithit, sepse nuk ka mendim të kujtdo qoftë karshi hadithit. Hadithi - pohonte ai - është medhhebi im!”⁷

3. *Ixhmai i sahabëve - إجماع الصحابة - konsensusi i dijetarëve të një epoke, në këtë rast, ai i kohës së sahabëve. Sahabët kanë qenë dëshmitarë të zbritjes (zbulesës) së Kuranit, e kanë përjetuar zbritjen e ajeteve, ata i njohin mirë momentet dhe rastet e ndryshme të zbritjes së ajeteve dhe thënies së haditheve. Fundja, ata e kanë bartur dhe përcjellë dijen e Pejgamberit a.s. te gjenerata pasuese. Prandaj, duhet thënë se fjalët e sahabëve nuk janë të këtij niveli.*
4. *Kijasi - الْقِيَاسُ - analogjia, - aq sa, ndonëse Ebu Hanifeja njihet botërisht si përdorues i rezonimit të lirë (Er-Re'ju), megjithatë, ai nuk ka insistuar që të përdorët rezonimi i lirë para analogjisë. Imami e ka përdor kijasin-analogjinë vetëm atëherë kur nuk ka gjetur ajet të Kuranit apo hadith autentik (sahih), megjithëse, edhe në raste të tilla përdorimi i kijasit detyrimisht ka qenë i bazuar në dy burimet e para, në Kuran ose hadith.*
5. *Istihsani - الْإِسْتِحْسَانُ , është kur fekihi muxhtehid nuk e përdorë një dispozitë të përgjithshme, por e merr një të veçantë për arsye se i jep përparësi. E, pra, dhënia e përparësisë për shkak të një arsyeje është istihsan. Ebu Hanifeja lejoi që duke e përdorur istihsanin, mund të*

⁷ Muhamed Ebu Zehre, Tarih el-medhaheb el-islamiye, pj. II-të *fî tarihi l medhaheb el fikhijje*, bot. Dar el-Fikr el-Arabij, Kajro, pa v. bot.

bazohesh në një zgjidhje sipas kijasit (analogjisë) së mbështetur në dy burimet e para.

6. *Maslahatu l mursele* - مَصْلَحَةُ الْمُرْسَلَةِ , është dobi për të cilën është interes i njerëzve dhe e cila është brenda suazave të përcaktuara nga Ligjvënësi. Në literaturë, shpeshherë përmendet se në vend të *maslahatu-l-mur-selës*, ai e ka shfrytëzuar *ixhmain* - konsensusin e dijetarëve të një epoke për një çështje të caktuar. Në literaturën burimore hanefite, studiuesi mund të has zgjidhje fikhere edhe sipas njërës edhe sipas së dytës, ndonëse në sasi të vogël, ashtu siç i ka përdor imami i nderuar.

7. *Urfi* - العُرْفُ - ose *tradita* e një mjedisi të caktuar ashtu siç ata e kanë konceptuar një çështje të caktuar, thuaj po të duash edhe adetet (zakonet) e një populli (në qoftë se nuk e cenojnë të drejtën islame, nëse nuk janë në kundërshtim me dispozitat e Sheriatit). *Urfi-tradita* mund me qenë e vërtetë ose jo e vërtetë. E para nuk është në kundërshtim me Kuran ose Sunet, llogaritet për argument dhe me të argumentohet në Sheriat. E dyta, nuk konsiderohet argument dhe nuk argumentohet me të. *Urfi*, kryesisht është përdorur në fushën e muamelatit (të drejtën qytetare).

Përdorimi i burimeve të sipërpërmendura nga ana e Imamit Ebu Hanife, ia ka mundësuar që shkolla e tij juridike të jetë mjaft fleksibile (jo e ngrirë) dhe të ofrojë zgjidhje meritorë të cilat kanë qenë lehtësim për aplikuesit. Në kohë të caktuar dhe në rrethana të caktuara, pasimi i shkollës juridike hanefite ka ndikuar në masë të madhe në lehtësimin e përdor-

rimin të atyre dispozitave, natyrisht jo se i kanë devijuar argumentet e përdorura.

Fikhu i Ebu Hanifes

Se Ebu Hanifeja ka qenë fekih i vërtetë, kjo as që diskutohet. Imam Maliku për të ka thënë: *انه لفقيه* - “Ai, vërtet, është fekih.” Kurse, me një rast, Imam Shafiiu kishte thënë: *الناس في الفقه عيال على أبي حنيفة* - “Njerëzit në fikh-jurisprudencë islame janë fëmijë të Ebu Hanifes!”

Është thënë edhe më sipër se Ebu Hanifeja ka mësuar nga mësuesi i tij Hamad bin Sylejmani përafërsisht 18 vjet pandërprerë. Ndërkaq, ky dijetar i asokohshëm (Hamadi) mësimet i kishte marrë nga hazreti Ymeri, hazreti Aliu, Abdullah bin Mesudi, Abdullah bin Abbasi etj.. Prandaj, marrja e diturisë nga sahabët e Pejgamberit a.s., të përmendur me këtë rast, ka qenë tepër e rëndësishme, sepse i bie që Ebu Hanifeja të jetë mbështetur pikërisht në atë dituri, të cilën ata e kishin fituar nga Pejgamberi a.s..

Imam Ebu Hanifeja konsiderohet dijetari i parë i cili i ka rregulluar çështjet e fikhut dhe i ka sistemuar në regjistra të posaçëm, sepse ai është cilësuar si sistemues teorik dhe si promotor i teknikës juridike, punë të cilën e kanë bërë me shumë kujdes nxënësit e imamit: Ebu Jusufi dhe M. Esh-Shejbaniu dhe të tjerë, sa që dijetari shqiptar Vehbi Sylejman Gavoqi, ka përmendur se numri i meseleve të cilat ata i kanë shpjeguar, rregulluar, sistemuar e regjistruar ka qenë mjaft i madh.⁸

⁸ Vehbi Sylejman Gavoqi, *Ebu Hanife En-Nu'man*, Daru-l-Kalem, Damask, bot. i pestë 1993.

Mënyra e këtillë e sistemimit ka bërë që kjo disiplinë shkencore islame të përhapet gjithandej, si te dijetarët po ashtu edhe te populli në përgjithësi, filluar nga Kufeja e për të vazhduar në tërë Irakun dhe më gjerë. Më vonë, gjatë shekullit të dytë të hixhretit, fikhu i sistemuar është shtrirë në Afganistan, Buhara, Indi, për të vazhduar të depërtojë edhe në Lindje e Perëndim, në Jug e Veri, sa që dijetari i famshëm që ka bërë emër në fikh, hadith, tefsir e usul, i quajtur Ali bin Sultan el-Kari' (ka vdekur më 1014), konstaton se pasuesit e imamit në shekullin XI përbënin 2/3 e myslimanëve të botës. Prandaj, me të drejtë është konstatuar se interpretimi i tij ka qenë elegant, konsistent dhe teknikisht i zhvilluar mirë.

Për meritat dhe kontributin e imamit në sistemimin dhe rregullimin e çështjeve të fikhut kanë shkruar shumë dijetarë të fushave të ndryshme, duke e pohuar faktin se imami ka qenë i pari ndër dijetarët që ka kontribuar në këtë fushë. Kështu, Muhamed bin Jusuf es-Salihij ed-Dimeshkij, fekih dhe muhadith i njohur, pohon se Ebu Hanifeja është i pari që ka shkruar në Usulu d-din, në Usul el-fikh, në të drejtën trashëgimore, duke i radhitur çështjet e caktuara në formën më të mirë.

Imam Shafiu r.a. me një rast tjetër, kishte thënë: *“Nuk kam pa kurrë më të ditur në fikh sa Ebu Hanifeja!”*

Ibrahim bin Tuhmani: *“Ebu Hanifeja (Allahu e pastë mëshiruar!) ka qenë imam në çdo kuptim (imam me plotë kuptimin e fjalës).”*

Muhamed bin el-Bakir ka thënë: *“Udhëzim më të mirë dhe dije më të madhe në fushën e fikhut sesa Ebu Hanifeja nuk ka pas!”*

Ibën el-Mubareku ka thënë: *“Askush nuk është më meritator për t’u pasuar se sa Ebu Hanifeja, ka qenë prijës i devotshëm, i singertë, dijetar i madh në fikh, atë që ka bërë ky dijetar askush nuk ka mund ta arrijë...”*⁹

Ebu Hanifeja me rastin e nxjerrjes së meseleve të fikhut ka ndjekur një rrugë të posaçme, më vonë e mirënjohur ndër çarqet e fukahave si metoda e Ebu Hanifes. Për më tepër, është transmetuar nga imami se me një rast kur ishte pyetur për metodologjinë që ka ndjekur ai me rastin e nxjerrjes së një vendimi - dispozite, ai kishte thënë:

*“Fillimisht kërkoj në Librin e Zotit xh.sh., e nëse nuk gjejë në të ajet adekuat, kërkoj në Synetin e Pejgamberit a.s., e nëse nuk gjejë as në Librin e Zotit xh.sh. as në Synetin e Pejgamberit a.s., e marrë mendimin e sahabëve të tij...marrë nga akëcili të dua dhe e lë mendimin e cilitdo që dua, ama nuk dal nga mendimet e tyre te mendimet e të tjerëve përveç tyre. E, në qoftë se puna mbaron tek Ibrahim (En-Nehaiu), te Sha'biu, tek Ibni Sirini, te Hasani, tek Atau, dhe Seid ibën Musejjebi...e po ata janë njerëz që kanë hulumtuar, ndaj dhe unë hulumtoj siç ata kanë hulumtuar!”*¹⁰ Kjo akoma më shumë e vërteton pohimin e më sipërm se Ebu Hanifeja, e më pas edhe nxënësit e tij, kanë qenë shumë të kujdesshëm se në

⁹ Si më sipër. fq. 144.

¹⁰ Në një version tjetër të ngjashëm me këtë është regjistruar se ka thënë: *“...e nëse puna vjen tek Ibrahim..., epo ata janë burra siç edhe ne jemi burra!”* Tarih Bagdad, pjs. 13, fq. 368. Kjo dëshmon se Imam Ebu Hanife nuk e ka marrë në konsideratë mendimin e tabinëve (gjeneratës pasuese pas asaj të sahabëve).

kënd janë mbështetur dhe nga kush i kanë marrë argumentet për mendimet e shprehura. Përzgjedhja e tyre ka qenë meritore dhe e pa kontestuar.

Si përfundim

Shkolla juridike hanefite, falë fleksibilitetit të saj, falë argumentimit meritore dhe nivelit të lartë shkencor arriti të gjejë përfaqim gjithandej nëpër botë. Sot ajo është e përhapur dhe atë e kanë përqafuar më shumë se gjysma e myslimanëve në tërë rruzullin tokësor. Mendimet dhe fiksionet juridike të Ebu Hanifes dhe nxënësve të tij prore kanë gjetur besueshmëri dhe aplikim ndër besimtarë.

Ebu Hanifeja ka qenë i pari nga dijetarët e ymetit, dhe këtë duhet theksuar në veçanti, që i vuri bazat dhe dispozitat e nevojshme për të drejtën tregtare. Duke qenë se ai vetë për një kohë të gjatë u mor me tregti, s'do mend se si disiplinë interesante dhe për të e nevojshme, iu është dashtë të merret deri në detaje dhe e vuri në binarë të shëndosh, ngase edhe sot e tërë ditën, njerëzit shërbejnë me të arriturat e tij.

Marrë në përgjithësi, kontributi i imam Adham Ebu Hanifes, ka qenë i jashtëzakonshëm në shumë fusha shkencore - fetare, e në veçanti në shkencën e fikhut me të gjitha disiplinat e saj.

Për ne myslimanët shqipfolës, në Kosovë dhe jashtë saj, është me rëndësi me e njohur këtë shkollë mirë e mirë, sepse tradita e zbatimit dhe praktikimit të shkollës juridike hanefite ndër ne është më shumë se gjashtë shekullore, ndaj dhe kjo na obligon që ta njohim. Sa ma shumë që e njohim, aq ma

shumë veprojme sipas mësimëve të saj. Në anën tjetër, përgjatë këtyre shekujve, veprat e Ebu Hanifes dhe të mendimit të medhhebit hanefit ndër ne, janë mësuar e studiuar në nivele të ndryshme të shkollave të kohës, duke filluar që në mejtepe e deri në nivelet më të larta, kurse në aspektin praktik, sikurse u tha, zbatueshmëria, zgjidhja dhe shpjegimi i çështjeve të ndryshme juridike është bërë ekskluzivisht sipas kësaj shkollës juridike islame. Pikërisht për këtë, edhe kontributet shkrimore të juristëve tanë islamë-shqiptarë, shumica në dorëshkrim dhe që presin dorën e studiuesve për të parë kontributin e tyre origjinal në këtë fushë, janë po sipas medhhebit juridik hanefit, që në fakt, ishte edhe medhhebi zyrtar përgjatë periudhës osmane dhe edhe më pastaj. Edhe sot e gjithë ditën, medhhebi hanefi është medhhebi zyrtar i komunitetit mysliman në Kosovë, përkatësisht i Bashkësisë Islame të Kosovës, organeve dhe institucioneve të saj. E kur jemi këtu, duhet theksuar se shkolla juridike hanefite sot ka një shtrirje, zbatim e praktikim të gjerë në botën islame me tendenca gjithnjë e më të mëdha të shtrirjes së saj, sidomos për shkak të mendimeve racionale që e karakterizojnë dhe e veçojnë këtë medhheb.

Këtë kontribut modest do ta përmbyllë me mendimin e imam Jahja bin Seid el-Kattan, i cili me një rast kishte deklaruar: *“Nuk ka dyshim se Ebu Hanife - dhe për këtë betohem në Allahun - ka qenë më i dituri i këtij ymeti për atë ç'ka ka ardhur nga Allahu dhe i Dërguari i Tij!”*

إن أبا حنيفة - و الله - لأعلم هذه الأمة بما جاء عن الله و رسوله

Literatura e shfrytëzuar:

1. Vehbi Sylejman Gavoqi, *Ebu Hanife En-Nu'man*, Daru-l-Kalem, botimi i pestë, Damask, 1993.
2. Muhamed Ebu Zehre, *Tarih el-medhaheb el-islamiye*, pj. II-të *fî tarihi l medhaheb el fikhijje*, bot. Dar el-Fikr el-Arabij, Kajro, pa v. bot.
3. Abdul-Xhelil el-Karnshavi, *Dirasat fî Esh-Sheriati-l-Islamijje*, botime të Universitetit të Benghazi, Libi, 1973.
4. Fikret Karçiqi, *Historia e së drejtës së Sheriatit*, Fakulteti Teologjik Islam, Sarajevë, 1987.
5. Qadri Anwar Ahmed, *Islamic Jurisprudence in the modern World*, Lahore, 1981.
6. Muhamed el-Hudarij, *Tarihu-t-teshri'i-l-islamijji*, El-Kahire, 1965.
7. Kemal Faruki, *Jurisprudenca Islame*, Lahore, 1962.
8. Abdu l Adhim Sherefuddin, *Tarihu t-Teshri' el-Islamijji*, 1974, Benghazi.
9. Resul Rexhepi, “Ebu Hanife” te “Edukata Islame”, nr. 26, viti 1980, bot. Shoqata e ylemave, Prishtinë.

Dr. Ajni SINANI

PEJGAMBERI A.S. NËN MBIKËQYRJEN E ALLAHUT QË NGA LINDJA E TIJ

“Vërtet, ti je në një shkallë të lartë morali.” (El Kalem, 4)

Nga ky lavdërim që Kurani fisnik i bën Muhamedit a.s., mësojmë se ai i referohet moralit që ai ka pasur para pejgamberisë së tij. Jeta e tij para shpalljes ofron modelin e lartë dhe ishte një fazë e parapërgatitjes dhe e ushtrimit për pranimin e Mesazhit Hyjnor.¹

Personaliteti i të Dërguarit a.s. para Shpalljes përfshinte shumë cilësi të virtytshme dhe kjo kuptohet edhe nga fjalët e hazreti Hatixhesë.² Kur Pejgamberi a.s. u kthye në shtëpi duke u dridhur pasi pranoi shpalljen e parë dhe kishte frikë se mos i kishte ndodhur gjë, Hatixheja i tha: “Mos ki frikë se Zoti yt nuk të poshtëron asnjëherë. Ti respekton farefisën, flet

¹ Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, Fikhu sire studimet metodologjike – shkencore për biografinë e Muhamedit (alejhi salam), Shkup, 2018, f. 12.

² Shih: Ali Gunejm, Shajsijetur resul kable el-bitteh:

<https://alseerahalnabaweyah.com/r/%>

gjithmonë të vërtetën, u jep të varfërve, e pret mikun dhe i ndihmon njerëzit në fatkeqësi.”³

Zoti e kishte përgatitur mbarë botën për ardhjen e Pejgamberit a.s.. Kishte përgaditur Gadishullin Arabik dhe familjen e tij.⁴ Muhamedi a.s. u nderua me moral dhe sjellje të mirë. Ai është shembulli më i përkryer për besimtarët. Sjelljet shembullore dhe besnikëria e Pejgamberit a.s. dyzet vjet me popullin e tij dhe shquarja e tij në mesin e tyre me epitetin “*el emin*” para Shpalljes, nënkupton se Pejgamberi a.s. gjatë asaj periudhe ishte besnik.⁵

Gjatë tërë historisë, shoqëritë të cilat janë thirrur nga të dërguarit e Zotit, krahas përmbajtjes së mesazhit, janë interesuar edhe për personalitetin dhe identitetin e atij që ua ka sjellë mesazhin. Muhamedi a.s. asnjëherë nuk u mundua që të shtirëj e të ndërtonte një karizëm artificiale, e as që e ndjeu nevojën për gjë të tillë.⁶ Prandaj, jeta e Pejgamberit a.s., ishte një jetë e nderuar dhe në të nuk ka pasur asnjë rrëshqitje kur ai ka qenë i ri. Ai nuk e ndoti atë me zakonet e injorancës.⁷

Biografia e Muhamedit a.s. nuk është një tregim thjesht vetëm për t’u lexuar. Lidhjet që kanë myslimanët me Pejga-

³ Muhamed Gazali, Fikhu Sirah, Analizë e jetës së Profetit a.s., Furkan, Shkup, 2011, f. 111.

⁴ Amër Halid, Gjurmëve të të Dashurit Tonë, SHB “Furkan ISM”, Shkup, 1427/2006, f. 23

⁵ Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, op. cit., f. 86.

⁶ Mustafa Islamogllu, Muhamedi alejhisselam, 3 Muhameda 2 Imagjinar, 1 i vërtetë, Logos-A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2011, f. 305-306

⁷ Shih: Kejf kanet hajatur resuli kable el-bitheh:

<https://www.almrsal.com/post/>

mberin a.s. janë më të forta dhe më të thella. Prandaj këtë studim nuk duhet ta konsiderojmë të ngjashëm me studimet e zakonshme historike.⁸

Lindja e tij e lavdishme

Lindja e Pejgamberit a.s. u bekua me nderimin hyjnor dhe u mbikëqyr nga Provania e Shenjtë. Pas lindjes së tij, Allahu xh.sh. shfaqti shumë çudira dhe mrekulli, si paralajmërim për pejgamberinë e tij.

Ishte caktim i Allahut që ai të rritej jetim. Babai Abdullahu kishte vdekur kur ai ishte në barkun e nënës së tij vetëm dy muaj. Kur lindi Muhamedi a.s., Emineja i çoi fjalë Abdul Mutalibit që të vinte e ta shihte nipin. Ai e mori nipin në kra-hë dhe e mbajti deri te Qabeja, ku i bëri një lutje falënderimi Zotit për këtë dhuratë.⁹

Ai do të rritej nën përkujdesjen e Tij, larg mbështetjes njerëzore, pa privilegje dhe larg pasurisë, me qëllim që të mos jepej pas tyre.¹⁰ Nëna dhe babai kanë një rol të rëndësishëm në brumosjen e karakterit dhe të orientimit të fëmijës në periudhën e formimit të tij. Formimin dhe edukimin e Muhamedit a.s. e kishte marrë përsipër Allahu i Lartmadhëruar.¹¹

Allahu e kishte parë të përshtatshme këtë formim për Muhamedin a.s., të cilin më vonë do ta ngarkonte me detyrën

⁸ Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, op. cit., f. 12.

⁹ Martin Lings, Muhamedi alejhisselam, jeta e tij sipas burimeve më të hershme, Logos.A, Shkup- Prishtinë- Tiranë, 2011, f. 31.

¹⁰ Osman Nuri Topbash, Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit 4, Hazreti Muhammed Mustafa a.s., shtëpia botuese Erkam, Stamboll, 2011, f. 17.

¹¹ Prof. dr. Ibrahim Saricam, Hz. Muhamedi dhe mesazhi i tij universal, Botimet e Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë, Ankara, 2018, f. 100.

e profetësisë. Edhe Isai a.s. u rrit jetim. Nuk gjeti babë kur erdhi në këtë botë. Madje u informua se nuk pati fare. Mbase Allahu zgjodhi për ta bonjakërinë që të shkaktoj erupsion mëshire në zemrat e tyre.¹²

Pejgamberi a.s. ishte shembulli i përkryer i qenies njerëzore, i përcaktuar ta sjellë mendimin njerëzor në pjekuri që gjeneroi një energji të re dhe një forcë jetësore të pashtershme për njerëzimin.¹³

Epërsia e prejardhjes fisnike

Populli e njihte prejardhjen fisnike të Pejgamberit a.s., prejardhje e cila sugjeronte drejtësi, ndershmëri dhe besim, qysh shumë kohë para se t'i vinte detyra profetike, prandaj edhe e vlerësonte dhe e miratonte atë.¹⁴

Muhamedi a.s. lindi në një familje të dëlirë, me paraardhës fisnikë, ku u kombinuan të gjitha cilësitë e mira të njerëzve. Lindja e Pejgamberit në një familje të tillë të dalluar ishte një nga mënyrat e suksesit që Allahu përgatiti për të Dërguarin e Tij.¹⁵

¹² Halid Muhamed Halid, Humaniteti i Muhamedit a.s., Shkup, 1990/1411, f. 12.

¹³ Sejjid Muxhteba Musavi lari, Vula e profetëve dhe mesazhi i tij, Prizren, 2006, f. 80.

¹⁴ Doc. dr. Omer Celik - dr. Mustafa Ozturk, Murat Kaja, Personaliteti shembullor, njeriu më i mirë në devocion dhe adhurim, Progresi, Shkodër, 2010, f. 23.

¹⁵ Muhamed Gazali, op. cit, f. 73

Buhariu ka transmetuar, nga Ebu Hurejre r.a., se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: *“Unë kam rrjedhur nga gjeneratat më të mira të bijve të Ademit, gjeneratë pas gjenerate, derisa erdha nga gjenerata nga e cila erdha.”* Kjo do të thotë se dega e tij familjare nuk përmbante asnjë lindje të paligjshme. Vetë i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: *“Unë vijë nga lidhjet e martesës, jo nga kurvëria.”*¹⁶

Hapja e gjoksit

Allahu e begatoi shtëpinë e Halimes, sepse në prehrin e saj pushonte Muhamedi a.s. dhe nga qumështi i saj ushqehet ai. Kjo argumenton dhe tregon pozitën qysh kur ai ishte fëmijë i vogël.

Muslimi, transmeton se në shkretëtirë, në Beni Sad, kur Muhamedi a.s. ishte 4 vjeç, dy engjëj ia hapën gjoksin dhe ia pastruan atë me dëborë. Kështu qenia e tij e brendshme është pastruar që në fëmijëri nga forcat engjëllore të Zotit. Urtësia e kësaj ngjarjeje qëndron në faktin se mbrojtja dhe përgatitja e tij për për një mision madhor ishte qysh prej fëmijërisë së hershme.¹⁷

Enesi r.a. tregon: “Xhibrili shkoi te Muhamedi kur ai po luante me djemtë e tjerë. Xhibrili e mbajti, e shtriu, ia hapi kraharorin, ia nxori zemrën dhe i hoqi një copë prej saj. Pastaj i tha: “Kjo është pjesa e ligë që ndodhej brenda teje.” Më pas ai e pastroi atë në një enë të artë me ujë zezemi. Më pas

¹⁶ Hafidh Ibën Kethiri ka thënë: “Transmetim i saktë.”

¹⁷ Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, op. cit., f. 57.

ia vulosi kraharorin dhe e ktheu ku ishte më parë. Djemtë vrapuan te nëna e tij prej qumështi (mëndesha Halime) dhe bërtitën duke i thënë se Muhamedi a.s. u vra. Kur shkuan tek ai, e gjetën të zverdhur (transmeton Muslimi dhe Ahmed).¹⁸ Ngjarja e hapjes së kraharorit thekson kujdesin që Allahu tregoi ndaj peygamberit të Tij, duke e çliruar nga mangësitë e natyrës njerëzore dhe nga ngasjet e botës që në fëmijëri.¹⁹

Jeta e tij ishte e programuar nga Krijuesi

Peygamberët janë të mbrojtur nga kryerja e çdo gabimi dhe mëkati të fshehtë a të hapur. Si rrjedhojë e këtij atributi, ata janë mbrojtur si para ashtu edhe pas peygamberisë së tyre nga llumi i politeizmit dhe i herezisë. Po të mos zotëronin atributin e pafajshmërisë, njerëzit nuk do t'u besonin në drejtësinë dhe vërtetësinë e lajmeve që ata jepnin, gjë që do të linte hije në dëshminë e peygamberisë së tyre.²⁰

Prandaj, sjelljet e Peygamberit a.s., pas mesazhit të tij, ishin të ndërtuara mbi moralin natyror të tij para profetësisë. Allahu nuk ka dashur që Muhamedi a.s. ta nxjerrë dhe ta flakë të kaluarën e tij, por e ka zhvilluar personalitetin që ai kishte para shpalljes, karakterin e lartë dhe virtytshmërinë.²¹

¹⁸ Muhamed Gazali, op. cit., f. 80.

¹⁹ Muhamed Gazali, op. cit., f. 89.

²⁰ Osman Nuri Topbash, Hazreti Muhamed Mustafa, Shkodër, 2012, f. 174.

²¹ Mustafa Islamogllu, op. cit, f.316- 317.

Zhvillimet në jetën e tij, madje edhe ato para shpalljes, ishin të programuara nga Krijuesi i botëve, e jo nga spontaniteti. E gjithë jeta e Pejgamberit a.s. u zhvillua nën mbikëqyrjen hyjnore. Kjo ishte përgatitje për atë që do të vinte më pas. Allahu po e përgatiste të Dërguarin e Tij për çdo rast dhe situatë, sepse ai do të udhëhiqte njerëzimin.²² Kjo krijesë, më e pastra dhe më fisnikja e qenieve njerëzore, shpalosi cilësi të veçanta qysh në fëmijëri të njomë. Edhe në moshë të re, ai ishte i dashur e i butë dhe e donte paqen e vetminë.²³

Allahu e ka mbrojtur nga të këqijat e kohës së injorancës

Zemrat e pejgamberëve nuk preken kurrë nga ligësitë që mund të mbushin mjedisin sepse janë në kujdesin permanent të Allahut.²⁴ Ishte përkujdesja hyjnore që e mbrojti të bëjë ndonjë gjë që bënin njerëzit e kohës së injorancës. Një herë, Muhamedi a.s. kishte dashur të merrte pjesë në një dasmë në Mekë. Në momentin kur duhej të hynte brenda saj, atë e zuri gjumi. Në këtë mënyrë, Allahu e parandaloi që të mos bënte diçka të papëlqyeshme, sepse Ai e ruante Muhamedin a.s. për diçka shumë më të rëndësishme.²⁵

²² Sejjid Muxhteba Musavi lari, op. cit, f. 80.

²³ Sejjid Husein Nasr, Muhamedi njeri i Allahut, “Biblioteka e Traditës”, pa vit dhe vend botimi, f. 18.

²⁴ Muhamed Gazali, op. cit, f. 89.

²⁵ Leila Azzam -Aisha Gouverneur, Jeta e të Dërguarit Muhamed s.a.v.s., Logos-A, Shkup, 1420/1999, f. 28.

Qysh në rini, Allahu ia hapi Pejgamberit a.s. rrugën e ndritshme që çante errësirën e injorancës.²⁶ Allahu xh.sh. e ka ruajtur Muhamedin a.s., ndërsa ky ishte duke u rritur dhe kështu ai e kaloi rininë në mënyrën më fisnike. Ai nuk ishte dhënë ndaj veprimeve të këqija që karakterizonin shumë të rinj të moshës së tij, siç ishin alkooli, kumari, amoraliteti dhe hajdutëria. Ai nuk kishte zënë as shoqëri me individë të kësaj kategorie, por kishte qëndruar larg tyre dhe nuk ishte ndikuar nga ata.²⁷

Allahu e kishte rrethuar me ruajtjen dhe kujdesin e Vet. Kishte bërë që ai t'i urrente ato vese dhe gjëra të kota e të këqija që ishin prezentë në popullin e tij.²⁸ Kjo do të thotë se para se ta marrë mesazhin hyjnor, pranuesi i shpalljes duhet të jetë i kulluar dhe i kthjellët. Kjo ngase Zoti nuk shkruan thjesht mbi çdo zemër. Nevojitet pastërtia e zemrës, e shpirtit dhe e mendjes, të panjolllosura nga të mësuarit njerëzor, që të shërbenin si rrasa mbi të cilën do të gdhendej fjala hyjnore.²⁹

Ai njihej në popullin e tij për cilësi e veti të larta, për sjellje të ndershme e fisnike dhe virtyte të fisme. Mbrojtja e Allahut xh.sh. e përfshiu të Dërguarin e Allahut a.s. në çdo aspekt të qenies së tij dhe në çdo gjë që ai bënte, gjatë gjithë jetës, që në moshën e tij më të re. Prandaj Pejgamberi a.s. ishte i mbrojtur prej kryerjes së mëkateve dhe çoroditjeve morale që nga lindja e tij.

²⁶ Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, op. cit, f. 64.

²⁷ Prof. dr. Ibrahim Saricam, Botimet e Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë, 2017, f. 107.

²⁸ Prof. Safijurrahman el Mubarekfuri, Lulishtja e dritave, Biblioteka "Familja Myslimane" 2, Tiranë, 2000, f. 20.

²⁹ Sejjid Husein Nasr, Muhamedi, op. cit., f.32.

Veprat e Pejgamberit a.s. pas pranimit të Shpalljes nuk i trajtojmë ndaras prej sjelljeve të tij para pranimit të Mesazhit hyjnor. Sikur Pejgamberi a.s. të ishte njollosur qoftë edhe nga një mëkat i vetëm, kjo do të përdorej si një armë efikase për uljen e prestigjit shoqëror të tij.³⁰

Lindja e Muhamedit a.s. si jetim, përkujdesja e Halime Sadijes ndaj tij, hapja e gjoksit, mbajtja larg dukurive negative të periudhës së injorancës, ruajtja e deleve, marrja me tregti, pastaj vetmimi i tij, nuk ishin tjetër veçse një qasje e plotë dhe e integruar në ndërtimin e karakterit të Pejgamberit në të gjitha aspektet për pranimin e Shpalljes.³¹

Ai qëndronte larg idhujve

Vigjilenca hyjnore e shoqëroi Pejgamberin a.s., që në fëmijërinë e tij të hershme, kështu që ai u rrit me natyrshmëri të shëndoshë, çiltërsi të zemrës dhe larg politeizmit. Ai nuk kish-te marrë pjesë asnjëherë në festat që organizoheshin për idhujt. Nuk hante kurrë nga mishi që therej për idhujt ose për dikë tjetër përveç Allahut. Ai nuk i duronte dot as betimet për Latin dhe Uzzanë, as prekjet me dorë apo afrimin tek ata idhuj.³²

Ai do të qëndronte larg nga idhujt dhe figurat e gdhendura, larg nga nderimi i tyre apo betimi për ta, duke i shmangur praktikat e idhujtarëve. Ai asnjëherë nuk i preku me dorë idhujt dhe nuk u ishte afruar atyre. I Dërguari i Allahut i ki-

³⁰ Sejjid Muxhteba Musavi lari, op. cit., f. 68-69.

³¹ <https://dergipark.org.tr/tr/download/article-file/405122> Vuxhuh er riajeti ilahijeti lin nebiji

³² Prof. Safijurrahman el Mubarekfuri, Lulishtja e dritave, op. cit., f. 20.

shte thënë hazreti Hatixhesë: “*Në të vërtetë, Hatixhe, unë kurrë nuk e adhuroj Latin e as Uzanë!*”³³ Ai ishte i vetëdijshëm se e vërteta ishte diçka krejt ndryshe nga të gjitha këto, prandaj preferonte malet dhe natyrën e hapur.³⁴

Misioni i pejgamberisë kërkon që pejgamberët të jenë të pastër prej të metave

“Kujto (o i dërguar) kur Zoti i vet, Ibrahimin e provoi me disa obligime, e ai i përmbushi ato, e Ai tha: Unë ty po të bëj prijës (imam) të njerëzimit! Ai (Ibrahimi) tha: Edhe nga pasardhësit e mi! (Zoti) Tha: ‘Mirësinë Time nuk mund ta gëzojnë mizorët!’ (El Bekare, 124).

Muhamedin a.s. e njohën të tjerët në fillimin e jetës së tij për moralin dhe edukatën e tij, para se ta njihnin atë për profetësinë e tij.³⁵

Pejgamberi i bekuar nuk ishte njeri i zakonshëm, por ishte një qenie e veçantë në sytë e Zotit. Megjithatë, ai nuk ishte mishërim i ndonjë qenieje mbinatyrore. Ai ishte personalitet i vlerave sublime.

Ishte e nevojshme që, para se të shpallej pejgamber, të gjithë kurejshët duhej të dëshmonin mirë për të. Kjo me qëllim që pasi të pranonte shpalljen dhe ata ta përgënjeshtrojnë

³³ Musnedi i Imam Ahmedit.

³⁴ Muhamed Gazali, op. cit., f. 99.

³⁵ Po aty, f. 99.

atë, të kuptohej që diçka e tillë ishte për çështje interesash dhe jo se nuk i besonin atij.³⁶

Pejgamberi a.s. u ngjit në malin Safa, duke i thirrur të gjitha fiset e kurejshëve, dhe u tha: *“A do të më besoni nëse ju them se matanë kësaj kodrine po fushon ushtria e armikut, e cila po bëhet gati të pushtojë qytetin?”* Ata iu përgjigjën: “Ti kurrë nuk na ke gënjyer dhe i besojmë secilës fjalë tënde!” Pra, ata deklaruan se gjithçka që kishin parë nga ai, që nga rinia e tij, ishte ndershmëria.³⁷

Morali i tij a.s.

Besueshmëria (emanet) është cilësi e përbashkët e të gjithë pejgamberëve. Para se Muhamedi a.s. të merrte mesazhin e shenjtë, pozita e tij në Mekë ishte në ngritje.³⁸

Pejgamberët ishin kandila që shkëlqenin në errësirë, yje ndriçues gjatë netëve më të errëta me të cilët udhëzohen të hamendurit dhe udhërrëfehen të humburit. Pa sakrificat e tyre, ne do të ishim të pashpresë dhe nuk do të orientoheshim në rrugën e lumturisë.³⁹

Kështu Zoti xh.sh. e ruajti atë që në fëmijërinë e djalërinë e tij. Prandaj ai u pajis me virtytet më të mira, me vetitë më

³⁶ Amër Halid, Gjurmëve të të Dashurit Tonë, SHB “Furkan ISM”, Shkup, 1427/2006, f. 58.

³⁷ Muhammed Hamidullah, Muhamedi alejhiseelam Jeta I, Logos Shkup - Prishtinë - Tiranë, 2011, f. 81.

³⁸ Karen Armstrong, Muhamedi një biografi e profetit, Jehona Study Center, Tiranë, 2006, f. 103.

³⁹ Hasan Ejub, Katër halifët e drejtë, ShB “Furkan ISM” Shkup, 1424/2003, f. 9.

të bukura, megjithëse lindi e u rrit në shoqërinë e injorancës. Allahu e mbrojti atë nga turpet, egërsitë dhe zullumet e saj. Ai kishte zemërgjerësi dhe bujari të madhe, sjellje të shkëlqyeshme, ishte më i drejti në fjalë, më i sigurti në besë dhe larg çdo ndotësie e sjellje të keqe, si asnjë tjetër.⁴⁰

Morali i mrekullueshëm, edhe përpara profetësisë së tij, kishte lënë gjurmë të thella te çdo njeri që e njihte atë. Ai e pati bërë të dashur veten për të tjerët. Personaliteti i tij pati paraqitur një përkryerje të tillë saqë për shkak të sinqeritetit para Shpalljes, populli i tij i dha emrin “*emin*” dhe “*sadik*”, i besueshëm dhe besnik.⁴¹

Ishte ky nam i pazakonshëm pastërtie, ndershmërie, paanshmërie dhe ndjenjë drejtësie që e çoi një grua të pasur dhe fisnike të Mekës, sikurse ishte Hatixheja r.a., që t’ia besonte Muhamedit a.s. veprimtarinë e saj tregtare.⁴² Duke parë besnikërinë e tij, Hatixheja u martua me Muhamedin a.s.. Ai shpalosi që në rini pastërti karakteri, ndjenjë ndershmërie dhe besueshmëri. Dhe me këtë identitet dhe miratim e pati filluar komunikimin e fesë.⁴³

Morali i tij ishte prodhim i formatimit hyjnor të cilin e kishte ndërtuar Allahu. Natyrën e kishte të mbrojtur, edhe vetë ishte i mbrojtur, ngase ishte një ligj hyjnor i “Mbrotjes së atyre që ruhen.”⁴⁴

⁴⁰ Vehbi Sulejman Gavoci, Muhammedi alejhisselam jeta dhe vepra, Logos A, Shkup – Prishtinë - Tiranë 2012, f. 35-36.

⁴¹ Doc. dr. Omer Celik - dr. Mustafa Ozturk, Murat Kaja, op. cit., f. 23.

⁴² Sejjid Husein Nasr, Muhammedi, op. cit., f. 23.

⁴³ Doc. dr. Omer Celik - dr. Mustafa Ozturk, Murat Kaja, op. cit., f. 23.

⁴⁴ Mustafa Islamogllu, Muhammedi alejhisselam, op. cit., f.316- 317.

Duhet përmendur se parimi themelor në lidhje me veprimet e Pejgamberit a.s., para Shpalljes është se ato nuk janë sunet legjislativ, përpos nëse sheriatu më pas i ka legjitimuar si të detyrueshme ose të dëshirueshme. Kështu, ato vepra bëhen pjesë e legjislacionit për ne.⁴⁵

Allahu i kujton Pejgamberit a.s. mirësitë dhe nderimin që i kishte bërë

Allahu xh.sh., në suren *Ed Duha*, i kujton Pejgamberit a.s. mirësinë e Tij, mbrojtjen që i kishte dhuruar dhe kujdesin që kishte bërë për të, që nga fëmijëria e tij e hershme, duke ia numëruar të gjitha mirësitë dhe nderimin që i kishte bërë:

“Pasha paraditen! Pasha natën kur shtrin errësirën! Zoti yt nuk të ka lënë, as nuk të ka përbuzur. Dhe se bota e ardhshme është shumë më e mirë për ty se e para. E Zoti yt do të të japë ty, e ti do të kënaqesh. A nuk të gjeti ty jetim, e Ai të bëri vend? Dhe të gjeti të paudhëzuar e Ai të udhëzoi? Dhe të gjeti të varfër, e Ai të begatoi? Pra, mos e përul jetimin! As lypësin mos e përzë! E me të mirat që t’i dha Zoti yt, trego!” (Ed Duha, 1-11).

Zoti i Madhërishtëm betohet në agimin dhe natën kur shtrin errësirën (*Pasha paraditen! Pasha natën kur shtrin errësirën!*) për ta siguruar Pejgamberin a.s. dhe besimtarët se Ai nuk e kishte shkëputur kujdesin e Tij ndaj Muhamedit a.s.

⁴⁵ Akvalu ve efalu Resul Allahi kable el-bitheh:
<https://islamqa.info/ar/answers>.

për asnjë çast. Surja *Ed Duha* bën një ndërlidhje me të kaluarën e Muhamedit a.s. kur ai nuk ishte pejgamber.

Abduhu - robi i Allahut dhe *resuluhu* - i dërguari i Tij, paraqesin dy pjesë të së vërtetës së tij. Të qenët njeri (qenie humane) është gjysma e së vërtetës së njerëzshmërisë së tij që i përgjigjet robëreshmërisë së tij, ndërsa profecia e tij dëgjueshmërisë së tij. Të qenët robi i Tij, vinte përpara së të qenët profet.⁴⁶

Parashtesa *inne*, që gjendet në fillim të ajetit, përdoret edhe për të përforcuar pohimin, edhe për të treguar shkakun dhe arsyen. Ky është morali i bukur i Muhamedit a.s., që sqaron arsyen e zgjedhjes së tij pejgamber, veçoritë të cilat çdokush i di dhe askush nuk i kritikon dot. Në ajet ka edhe një parashtesë që është “*ala*”, që do të thotë se morali i mrekullueshëm i Muhamedit a.s. është bërë shtylla kryesore e karakterit dhe e veprimeve në jetën e tij. Prandaj, jeta e tij para Shpalljes ishte pjesë integrale e këtij shembulli të përkryer.⁴⁷

Muhamedi a.s., ashtu siç ka lindur prej nënës së tij, ka arritur që të jetë i mbrojtur nga njollosja me kulturën e prishur të asaj kohe. Në historinë njerëzore ka pasur njerëz të njohur si mbretër, pushtues, reformatorë, asketë të mëdhenj që kanë dëshmuar për vlerat e tyre. Por gjithë këto tipare mund t’i gjejsh vetëm te një njeri sikurse ishte rasti me Muhamedin a.s..⁴⁸

⁴⁶ Mustafa Islamogllu, Muhammedi alejhisselam, op.cit., po. cit., f. 305-306.

⁴⁷ Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, op. cit., f. 86.

⁴⁸ Muhammed Hamidullah, op. cit., f. 16.

Dr. Orhan BISLIMAJ

TRI TIPARET E ANTIISLAMISTËVE NË KURAN

Hyrje

Në qendër të këtij punimi do ta kemi një ajet të Kuranit, ku Allahu i Madhërishëm, i ka evidentuar tiparet e një kategorie të njerëzve, që e urrejnë fenë islame dhe mundohen që me çdo kusht t'i largojnë njerëzit nga rruga e Zotit.

Shpjegimi i ajetit

Allahu i Madhërishëm në Kuran ka thënë:

الَّذِينَ يَسْتَحِبُّونَ الْحَيَاةَ الدُّنْيَا عَلَى الْآخِرَةِ وَيَصُدُّونَ عَنْ سَبِيلِ
اللَّهِ وَيَبْغُونَهَا عِوَجًا أُولَئِكَ فِي ضَلَالٍ بَعِيدٍ

“Ata që e duan jetën e dynjasë më shumë se Ahiretin, që i pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut, dhe që gjurmojnë ndonjë të metë eventuale në fe për ta shtrembëruar atë sipas dëshirave të tyre, të tillët qartas janë në humbje të thellë.” (Ibrahim, 3)

Në parim, ky ajet flet për rrethanat e myslimanëve në kohën e Pejgamberit a.s. dhe përballjen me sulmet e antiislami-stëve, të cilët vazhdimisht bënin intriga e kurthe kundër tyre.

Por ç'e do, edhe pse Kurani ka zbritur para 14 shekujsh, megjithatë, ky ajet e spikatë një rrethanë shumë aktuale me të cilën përballen myslimanët gjithandej botës dhe që është bërë preokupim edhe për shoqërinë tonë.

Bëhet fjalë për disa grupe dhe disa individë, të cilët zëshëm i kundërvihen fesë së Zotit, kulturës islame, si dhe nuk i lënë rehat myslimanët në jetën e tyre e në punët e tyre të përditshme. Ata, me qëllim i shqetësojnë myslimanët me deklarata nënçmuese, e kur u jepet mundësia edhe me veprime konkrete.

Në jetën shoqërore i hasim me profile apo emërtime të ndryshme, por sido që t'i quajmë (komunistë, neokomunistë, antiislamistë, islamofobë, materialistë, krishterimocentristë, etj.), ata mbeten të njëjtit, kundërshtarë të Islamit dhe myslimanëve.

Prandaj, me qëllim të identifikimit të tyre, Allahu i Madhërishëm, brenda këtij ajeti i ka evidentuar tri tipare thelbësore të tyre, si në vijim:

- 1) Ata, e duan dynjanë më shumë se Ahiretin;
- 2) Ata, i pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut;
- 3) Ata, e gjurmojnë ndonjë të metë apo paqartësi në fe për ta devijuar atë sipas dëshirave të tyre; dhe
- 4) Të tillët qartas janë në humbje të thellë.

Në vazhdim, do të bëjmë shpjegimin e këtyre katër pikave, duke e ndërlidhur teorinë me realitetin tonë praktik.

1. Tipari i parë: "E duan dynjanë më shumë se Ahiretin"

Në këtë pjesë të ajetit, Allahu i Madhërishëm po na tregon për diçka që është thelbësore tek antiislamistët dhe epigondër e botëkuptimeve të tyre.

Është shprehur literalisht përmes antonimeve dynja/ahiret, porse nuk është në pyetje thjesht dashuria për dynjanë apo mosdashuria për të. Sepse, fundja të gjithë njerëzit e duan dynjanë, ngaqë është në natyrën e tyre dhe kjo nuk diskutohet.

Përtej kësaj, prerja e ajetit ka të bëjë me vlerësimin kategorik të fetarisë islame kundrejt jofetarisë, shpirtërores kundrejt materiales, idealeve të qiellit kundrejt idealeve të tokës. Ka të bëjë me antagonizmin në mes të këtyre dy koncepteve, e që antiislamistët të shtyrë nga mllëfi e kanë shndërruar në frymë konfliktuoze, duke shkaktuar polarizime të thella, si dhe duke cenuar paqen dhe tolerancën ndërs shoqërore.

Gjersa dynjaja po na vjen këtu si simbolikë e jofetarisë (materiales - tokësore), në anën tjetër Ahireti prezantohet si simbolikë e fetarisë (shpirtërores - qiellores).

1.1. E shenjtërojnë dynjanë

Kjo është e vërtetë, ata që e duan dynjanë më shumë se Ahiretin, ata e shenjtërojnë dynjanë materialiste jashtë mase. Çdo ambicie e lidhin për të, sepse e përjetojnë si burim i mirësive, kurse ata që e duan Ahiretin, e duan Allahun më shumë se çdo gjë tjetër dhe e besojnë Atë për Krijues të çdo mirësie.

Nga pasioni i madh që kanë për të, e shndërrojnë në objekt adhurimi dhe ia dedikojnë gjithë dashurinë asaj (dynjasë). Atë dashuri për Krijuesin, që Zoti i gjithësisë ia ka skalitur njeriut në shpirt, ky i fundit e orienton keq, duke e drejtuar drejt kulteve tokësore, e që sot në terminologjinë shkencore njihet si ‘fe civile’.

Këtë tipar të ateistëve e përshkruan Allahu qartë: ***“Ka njerëz që në vend të Allahut marrin idole, i duan sikur Allahun, por besimtarët më fortë e duan Allahun.”*** (El Bekare, 165)

Në këtë pasqyrë, përthyhen fjalët e disa njerëzve kur thonë ‘pasi të vdes nuk po më intereson se ku do të shkoj’. Domethënë, dynjanë e kanë qëllim dhe mjet, pra e kanë ideal të vetëm, për dallim prej besimtarëve që e kanë qëllim e ideal Ahiretin, kurse dynjanë mjet për të arritur atje.

Kemi të bëjmë me dallim të madh, me një dallim aq thelbësor saqë e dizajnon përmbajtjen e jetës së njeriut në përgjithësi, prej lindjes deri në vdekje; e determinon fatin e tij në Ahiret se në cilin vend do të përfundojë përgjithmonë, në Xhenet apo Xhehenem.

Bile, sulmet e kundërshtimet e ashpra që islamofobët ua bëjnë vlerave islame e vetë myslimanëve, në shoqërinë tonë shqiptare, duhen parë si pasojë e këtij dallimi të madh.

1.2. E marrin dynjanë për zot

Edhe më tej, grupi që e do dynjanë më shumë se Ahiretin, tek ata “Zot” i vërtetë praktikisht është dynjaja e jo Allahu. Zgjidhen në mëngjes dhe bien në mbrëmje me ëndrrat e dynjasë. U kalon dita, java, muaji e vitet pa asnjë lidhje besimi me Zotin, pa asnjë falënderim ndaj Krijuesit. Shikimin e jetës nuk e kanë kah Zoti dhe Ahireti, ta zëmë siç e kanë besimtarët, por nga vetvetja dhe dynjaja. Këtyre njerëzve nuk u bën përshtypje përgjegjësia para Zotit, por vetëm frika nga njerëzit. Njeriun, nuk e shohin si qenie humane, por si interes për ndonjë apetit të tyre.

Me një fjalë, pasqyrë e tyre është dynjaja materialiste, çka do që vjen në pajtim me synimet e saj, aprovohet, kurse çka do që vjen në kundërshtim, refuzohet. Dhe, ky përkushtim është aq i madh, saqë Allahu e cilëson dynjanë zot të tyre:

***“A e ke parë atë i cili e ka marrë epshin e vet si zot të vetin, atë Allahu, me dije, e ka lënë të humbur dhe e ka vulosur zemrën e tij, edhe veshët e tij, kurse para syve të tij ka vënë një grillë. Kush do ta drejtojë atë në rrugë të drejtë në mos Allahu? A nuk mendoni pak?
(Xhathije, 23)***

Ndalunë në këtë ajet dhe analizoje pak. I Madhi Zot e ka portretizuar gjendjen reale të ateistëve materialist, ku tri organet vitale të informacionit, zemra, veshët e sytë i kanë të pllakosura dhe ngjasojnë me njeriun e bunkerizuar, që nuk njihet tjetër gjë, përpos aspiratave brenda bunkerit. Ose, në rastin tjetër, ngjasojnë me njeriun e periudhës së neolitit (antikiteti i thellë), që nuk ka pasur fare dijeni për këto arritje teknike e teknologjike, për botën digjitale, pra që nuk e ka

njohur aeroplanin, internetin, kompjuterin, etj., e mos të flasinim për anijen kozmike, e satelitët, që transmetojnë të dhënat faktike në kohë reale.

Dhe, po t'i thuhej atij, se dielli është më i madh se toka, ai nuk do ta be sonte; po t'i thuhej se do ta dalë një aparat ultrazëri, që e incizon trupin e njeriut në detajet më të vogla, nuk do ta besonte; po t'i thuhej se do të dalë një mjet që fluturon në qiell, mijëra kilometra në orë, nuk do ta besonin; po t'i thuhej se do ta dalë një dron që noton në ajër pa pilot fare, nuk do ta besonin fare, etj., etj..

Nuk do t'i besonin, sepse u besojnë vetëm asaj që duket brenda bunkerit të tyre. Kurse, Zoti i Madh ia ka zbritur njerëzimit Kuranin për t'ua treguar atyre edhe gjërat përtej dynjasë, përtej bunkerit njerëzor, për t'i vendosur në një pistë përparimtare.

Për këtë arsye, ateistët janë njerëzit më jo të qëndrueshëm shpirtërisht, sepse nuk besojnë përveç asaj që shqisat e tyre të limituara e perceptojnë, andaj dashuria e tyre për dynjanë kundrejt Ahiretit, e shprehur në ajetin në ballë të këtij punimi, ka ardhur si një simptomë e injorancës së tyre anakronike.

2. Tipari i dytë: "I pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut"

Kjo pjesë e dytë e ajetit flet për një tjetër tipar të tyre, e që është pengimi i njerëzve nga rruga e Allahut. Në fakt, me këtë epitet, Allahu po i cilëson si njerëz destruktivë për paqen ndërsхоqërore, po edhe si jomyslimanë, sepse vetëm jomesimtarët mund të kenë pretendime të tilla.

Përveç kësaj, ajeti aludon te një shtresë që ka pozitë dominimi apo pushteti në shoqëri. Këtë realitet e vërejmë edhe te një pjesë e shoqërisë sonë, duke filluar nga disa nivele të larta të një pjese të pushtetit qendror, në ato të nivelit lokal, te njësitë më të vogla, e deri te prindi në familje që ushtron presione nga më të ndryshme ndaj atyre që përdhën në rrugën e Zotit.

Kurrë nuk e harroj një rast që vetë e kam parë, kur një person i njohur për mua, iu ngërmua një nxënësi që sapo ishte regjistruar në medresenë e mesme të Prizrenit. Nuk la gjë të keqe pa i thënë për Medresenë, se paske gabuar, e paske humbur vetën, leje e shko me ndonjë shkollë tjetër, hiq fesë..., etj. Ky nxënës, pas disa muajsh e braktisi Medresenë që sapo e kishte nisur dhe kaloi në një shkollë tjetër, por kurrë nuk e mbaroi. E, mua më shkon ndërmend se ai person u bë shkaktar që i njëjti ta braktisë Medresenë, si një tempull i vlerave fetare, qytetare e kombëtare.

Fundja, nuk ka rëndësi rasti, sepse mund të variojnë rastet e arsytet, por qasja e tyre imponuese dhe kundërshtimi i fesë me aq shumë pasion, kjo ka rëndësi.

Çka po i shtynë këta njerëz kundër fesë së Zotit, çfarë zori kanë? Në vend se të gëzohen për cilindo që i përkushtohet sinqerisht adhurimit të Zotit, ata e bëjnë të kundërtën. Kjo është për t'u shqetësuar.

Sot, në shoqërinë tonë kosovare, po edhe më gjerë, janë tre grupe publike që po mundohen t'i largojnë njerëzit nga rruga e Zotit: një pjesë e pushtetit, organizatat joqeveritare antiislamiste dhe individët e pavarur neokomunistë.

2.1. Pushtetarët antifetarë

Pejgamberi a.s. ka thënë:

إِنَّ أَخَوْفَ مَا أَخَافُ عَلَى أُمَّتِي الْأُتَمَّةِ الْمُضَلَّلُونَ

“Ajo që më së shumti frikësohem për ymetin tim janë udhëheqësit e devijuar.” (Hadithi sahih).

Ky hadith, ndonëse nuk e përjashton edhe udhëheqësinë e brishtë fetare, megjithatë në fokus të çështjes i ka pushtetarët antifetarë, përkatësisht antiislamistët, që e luftojnë fenë e Zotit me mjetet e pushtetit.

Populli shqiptar e di më së miri se çka do të thotë të kesh një pushtet të huaj e antifetar në vend. Njerëzit që i kanë ushtruar dhe përjetuar tmerret e ideologjisë komuniste, disa janë akoma gjallë.

Fatkeqësisht, edhe pas shembjes së komunizmit, në Kosovë e Shqipëri, vazhdon akoma fryma publike kundër fesë. Për mendimin tim, kjo nuk ka të bëjë me laicitetin e shtetit apo sekularizmin, siç e justifikojnë disa islamofobë, por thjesht ka të bëjë me një luftë speciale, me një front armiqësor posaçërisht kundër kulturës islame, e që laicitetin e përdorë si fasadë.

Për shembull, pjesa dërrmuese e shteteve të Bashkimit Evropian, e kanë futur lëndën e mësimin fetar nëpër shkollat laike shtetërore, por një gjë të tillë nuk e bën Kosova e as Shqipëria, siç e kanë rregulluar shtetet fqinje, ta zëmë Kroacia, Serbia Mali i Zi dhe Bosnja. Nuk e bëjnë, apo më mirë të themi do të eskivojnë edhe për shumë kohë të gjatë, ngaqë nga edukata fetare apriori do të përfitonte më së shumti kul-

tura islame, e kjo do t'i kundërviej planeve të tyre për abstrahimin e fesë në shoqëri.

Por, lufta antislame në Kosovë e Shqipëri, është duke u zhvilluar edhe nëpërmjet injorimit kategorik të kulturës islame, në njërën anë, dhe favorizimit kategorik të kulturës së krishterë në anën tjetër. Kjo duket qartë në shumë instanca shtetërore, duket qartë edhe nëpër librat shkollorë, pastaj gjatë festave fetare të krishtera, ku udhëheqësit e personalitetet shtetërore shkojnë në kishë, por jo edhe në xhami, etj.

Tentohet që përmes këtyre formave të paraqitet Islami si i huaj, kurse krishterimi si profil shtetëror dhe identitet i shqiptarëve. Në fakt, kjo është intriga më e keqe kundër Islamit, sepse do të ketë konsistencë afatgjate dhe përditë e më shumë po bëhet logjikë e disa institucioneve shtetërore.

2.2. Organizatat joqeveritare antifetare

Kësaj fryme antiislame, po i fryjnë në masë të madhe disa organizata joqeveritare (OJQ). Sot, në Kosovë e Shqipëri, operojnë mijëra sosh në sfera të ndryshmet. Veç në Kosovë, deri në vitin 2019 kanë qenë 10.214 të tilla, prej tyre 542 ndërkombëtare.¹

Natyrisht, një pjesë e tyre, bëjnë punë të mira dhe shoqëria jonë ka nevojë për ekzistencën e tyre, por një pjesë e ma-

¹ Shih: Gazeta Indeksonline, “Mbi 10 mijë OJQ të regjistruara në Kosovë”, (version elektronik), datë 27 mars 2019, sipas: <https://indeksonline.net/mbi-10-mije-ojq-te-regjistruara-ne-kosove/>.

dhe kanë qëllime të errëta dhe janë krejtësisht të panevojshme.²

Së paku në këto dy dekada, e kemi parë se OJQ-të e kanë formuar një rrjet bashkëpunimi, që në të shumtën e rasteve shpërfaqet në përkrahje të disa pikëpamjeve publike kinse emancipuese në shoqëri (lexo: degjeneruese), e posaçërisht kundër pikëpamjeve fetare islame.

Nuk gabojmë aspak kur themi se OJQ-të e kanë uzurpuar debatin publik në Kosovë, duke u shndërruar në faktorë kyçë për orientimin kulturor të shoqërisë kosovare.

2.3. Individët neokomunistë

Fatkeqësisht, në vallen ideologjike të antiislamistëve, kanë hyrë edhe individë me emra e mbiemra myslimanësh. Është e vërtetë se janë grup i vogël (gazetarë, analistë, politikanë, diplomatë, studiues, etj.), por janë shumë aktiv në opinionin publik. Kanë media, kanë burime financiare të mëdha, kanë rrjet mediatik, mbështetje politike, etj..

Fundja, krejt në rregull, meqë në shoqëri secili e ka hisen e vet, por e keqja e tyre e pa tolerueshme fillon aty kur po mendojnë se janë kujdestarët për emancipimin e shoqërisë, gruas, rinisë, etj.. Për më keq kur po hiqen si shpëtimtarë të kombit shqiptar.

² Shih: Nadije Ahmeti, “Ç'interese përfaqësojnë OJQ-të në Kosovë?” (versioni elektronik), 5 maj 2013, sipas: <https://www.evropaelire.org/a/24976995.html>.

Për nga tipologjia, ngjasojnë me ata mynafikët e rrezikshëm të kohës së Pejgamberit a.s., kundër myslimanëve, që i përmend Allahu në Kuran:

“E kur atyre u thuhet, mos bëni fesat në tokë, ata thonë ‘ne jemi vetëm përmirësues’. Përkundrazi, mu ata janë që po bëjnë fesat e trazira, por nuk e kuptojnë!”
(El Bekare, 11-12).

Allahu po dëshmon se ata nuk janë as besimtarë e as dobiprurës, përkundrazi kanë për mision luftën kundër fesë. Këtë gjykim të Allahut e ka vërtetuar praktika historike, siç po dëshmohet edhe ndër ne.

Lufta e tyre kundër moralit fetar e të moralshmes në përgjithësi, kundër kulturës fetare e traditave kombëtare, në një-rën anë, si dhe heshtja e tyre ndaj sjelljeve perverse e amonale, në anë tjetër, e ka shndërruar shoqërinë tonë në burim të akteve më të turpshme, që nuk i kemi njohur më parë.

3. Tipari i tretë: “Gjurmojnë ndonjë të metë në fe për ta devijuar atë sipas dëshirave të tyre”

Kjo pjesë e ajetit flet për tiparin e tretë të islamofobëve, e që ka të bëjë me përpjekjen e tyre për të gjetur ndonjë të metë në fe, me qëllim që ta shfrytëzojnë për ta damkosur fenë islame, me qëllim të ftohjes së njerëzve.³

³ El-Kurtubij, “*El-Xhamiu li ahkami'l Kur'an*”, komentimi ajetit, Ibrahim, 3, versioni elektronik.

Pothuajse për çdo ditë, në mediat tona publike dëgjojmë analistë që keqinterpretojnë normat e fesë, gjithnjë sipas një diskursi që e paraqet Islamin si primitivizëm, kurse myslimanët si të prapambetur.

Me këtë pretekst, herë e ofendojnë Pejgamberin a.s. me lloj-lloj shpifjesh e akuzash, herë e injorojnë Kuranin, duke e trajtuar si anakronik për realitetin tonë, pastaj herë çohen kundër ezanit e xhamive, e deri tek ofendimet për shkak të iftareve në sheshet publike.

Të tillët, kapën pas disa deklaratave terse e fragmentare dhe ndërtojnë narrativë kundër fesë, edhe pse e dinë fare mirë versionin zyrtar për akëcilën çështje fetare.

Në fakt, përtej mosdurimit fetar, ata synojnë manipulimin e besimtarëve, duke ua servur Islamin sipas versionit të tyre dhe siç nuk është në të vërtetë. Thënë të drejtën, deri në një masë ia kanë arritur qëllimit duke futur huti në masë, sidomos te disa myslimanë me vetëdije të cekët fetare.

4. Epilogu: "Të tillët qartas janë në humbje të thellë"

Në këtë pjesë të fundit të ajetit, i Madhi Zot po e jep epilogun për të gjithë ata që i kanë tiparet e përmendura, se janë në humbje të thellë.

Dhe, këtë gjykim nuk është duke e dhënë njeriu, por Allahu, Ai që e ka krijuar njeriun dhe e di qëllimin e krijimit të tij, si dhe që e di se çfarë e ardhme e pret atë.

Për ta kuptuar arsyen se përse janë në humbje, mjafton ta analizojmë se në çka ftojnë ata. Ata ftojnë në një jetë pa fe,

pa moral fetar, etj., e kjo do të thotë se janë tërësisht në anën e kundërt të historisë.

Neve nuk na mbetet hapësirë debati, përveç aspektit se në çfarë mase i kanë këto tipare, po aq janë në devijim dhe po aq përbëjnë rrezik.

Mbi të gjitha, kjo kategori e njerëzve, që i kundërvihen fetarisë së shoqërisë, që i pengojnë njerëzit nga rruga e Allahut, që mbështesin një korpus të veseve degjeneruese, janë e keqja më e madhe e shoqërisë.

Këta janë imazhi fatkeq i atyre ‘demokratëve’ të kohës tonë, ‘pro evropianëve’ të kohës tonë, ‘laikëve’ të shtetit tonë dhe i atyre që po hiqen si mbrojtës të kombit!? Këta janë mynafikët fetarë e kombëtarë.

Në të vërtetë, këta janë misionarë për tjetërsimin e popullit shqiptarë, në emër të ‘emancipimit laik’. Nëse ndjek ata, do të mbetesh pa rrënjë, pa familje, pa fëmijë, pa fe, pa komb, pa kulturë, pa atdhe.

Rezistenca kundër ideologjive ateiste të tyre, në çdo vend a shoqëri, duhet t’i bashkojë të gjithë myslimanët, në mënyrë që e keqja si dhe ndëshkimi i Zotit mos t’i përfshijë të gjithë.

Dr. Sedat ISLAMI

SALAVATET PËR MUHAMEDIN A.S. DHE NDIKIMI I TYRE NË PËRMBUSHJEN E KËRKESAVE DHE NEVOJAVE TONA

Lidhja jonë me Muhamedin a.s., është e veçantë. Është përtej lidhjes së pasuesve me liderin. Është fe. Për këtë shkak, forma se si trajtohet ai prej nesh është e veçantë. Emri i tij nuk përmendet sikur emri i çdo njeriu, kushdo qoftë ai. Çdoherë që përmendim emrin e tij dërgojmë edhe salavat. Allahu xh.sh., na mëson në Kuran që t'i dërgojmë salavat sepse është vetë Ai që bashkë me engjëjt i dërgojnë salavate. Allahu xh.sh. thotë:

﴿إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا﴾

“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me “selam”!” (El Ahzabë, 56)

Duke qenë kështu, atëherë përmendja e këtillë e Muhamedit a.s., është vepër me shpërblim.

"مَنْ صَلَّى عَلَيَّ مِنْ أُمَّتِي صَلَاةً مُخْلِصًا مِنْ قَلْبِهِ؛ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ بِهَا عَشْرَ صَلَوَاتٍ، وَرَفَعَهُ بِهَا عَشْرَ دَرَجَاتٍ، وَكَتَبَ لَهُ بِهَا عَشْرَ حَسَنَاتٍ، وَحُما عَنْهُ عَشْرَ سَيِّئَاتٍ"

*"Për pasuesin tim që më dërgon salavat me gjithë zemër, Allahu do të bjerë salavat përmbi të dhjetë herë, do ta ngrit në dhjetë pozita, do t'ia shkruajë dhjetë të mira si dhe do t'ia shlyejë dhjetë të këqija."*¹

Salavati ka një rol të veçantë edhe në përmbushjen e kërkesave dhe nevojave tona. Ubej b. Kabi r.a., rrëfen:

كَانَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ إِذَا ذَهَبَ ثُلُثُ اللَّيْلِ قَامَ، فَقَالَ: "يَا أَيُّهَا النَّاسُ، اذْكُرُوا اللَّهَ، جَاءَتِ الرَّاجِفَةُ، تَتْبَعُهَا الرَّادِفَةُ، جَاءَ الْمَوْتُ بِمَا فِيهِ، جَاءَ الْمَوْتُ بِمَا فِيهِ" قُلْتُ: يَا رَسُولَ اللَّهِ، إِنِّي أَكْثِرُ الصَّلَاةَ عَلَيْكَ، فَكَمْ أَجْعَلُ لَكَ مِنْ صَلَاتِي؟ قَالَ: "مَا شِئْتَ" قُلْتُ: الرَّبْعُ، قَالَ: "مَا شِئْتَ، فَإِنْ زِدْتَ فَهُوَ خَيْرٌ لَكَ" قُلْتُ: فَالْصَّف؟ قَالَ: "مَا شِئْتَ، فَإِنْ زِدْتَ فَهُوَ خَيْرٌ لَكَ" قُلْتُ: فَالثَّلَاثِينَ؟ قَالَ: "مَا شِئْتَ، فَإِنْ زِدْتَ فَهُوَ خَيْرٌ لَكَ" قُلْتُ: أَجْعَلُ لَكَ صَلَاتِي كُلَّهَا؟ قَالَ: "إِذَا تَكْفَى هَمَّكَ، وَيُغْفَرَ لَكَ ذَنْبُكَ"

Ka qenë praktikë e të Dërguarit të Allahut a.s., që kur të ketë kaluar 1/3 e natës të çohet dhe të thoshte: "O

¹ Hadithin e shënojnë Nesaiu nr. 9893; Bezzari, nr. 3799; Taberaniu 22/195, ndërsa Albani në *Sahih et-Tergib*, nr. 1695, e konsideron *hasen sahih*.

njerëz! Kujtojeni Allahun! Erdhi dridhja² pas së cilës pason dridhje (tjetër). Erdhi vdekja me tërë atë që përmban! Erdhi vdekja me tërë atë që përmban!”³

I thashë: “O i Dërguari i Allahut, unë të dërgoj shpesh salavate, kur të lutem, sa të kushtoj hapësirë për salavat ndaj teje?”

Tha: “*Sa të duash.*”

“Një të katërtën (bën)!” - i thashë.

“*Sa të duash, por sa më shumë, më mirë për ty!*” - mu përgjigj.

“Atëherë gjysmën” - i thashë.

“*Sa të duash, por sa më shumë, më mirë për ty!*” - mu përgjigj.

“Atëherë 2/3!” - thashë.

“*Sa të duash, por sa më shumë, më mirë për ty!*” - mu përgjigj.

“Atëherë tërë lutjen po e kthej në salavat!” - i thashë.

“*Atëherë të përmbushet nevoja dhe të falet mëkati!*” - më tha.⁴

² Simbolikë e kataklizmës. Shih përdorimin e këtyre shprehjeve për kiametin në kapitlinë Naziat, ajetet 6-7.

³ “*Erdhi vdekja me tërë atë që përmban!*”, duke filluar me dhënien e shpirtit, varrin, llogarinë e gjërat që pasojnë. Shih: El-Mubarekfuri, Abdurrahman b. Abdurrahim, *Tuhfetu el-ahvedhij*, (Bejrut: Dar el-kutub el-ilmije), 7/129.

⁴ Hadithin e shënon Tirmidhiu në *Sunen*, ndërsa Albani në *Sahih et-Tirmidhi*, nr. 2457, e ka vlerësuar hasen.

Rëndësia e kësaj lutjeje

Ebheriu në komentim të hadithit të Ubejit r.a., ka thënë: “Nëse tërë kohën tënde të lutjes ia kushton salavateve për mua, atëherë kjo do të mjaftojë për tërë atë që të brengosë dhe shqetëson.”⁵ Pra, ajo për çka je lutur, do të plotësohet. Brenga (ar. el-hemm) që është përmendur në hadith përfshin çdo gjë që lidhet me dynjanë dhe ahiretin.⁶ Kështu, shpëtimi ndodhë në të dyja botët, sepse, atij që Allahu ia largon bren-gat e dynjasë, ai ka shpëtuar nga sprovat e saj; atij që i falen mëkatet, i sigurohet Xheneti.

Pra, të lutemi duke thënë:

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ
وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ اللَّهُمَّ بَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ
مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ

Allahumme sal-li ala Muhamedin ve ala ali Muhamed,
kema sal-lejte ala Ibrahime ve ala ali Ibrahime inneke
Hamidun Mexhid! Allahumme barik ala Muhamedin
ve ala ali Muhamed, kema barekte ala Ibrahime ve
ala ali Ibrahime inneke Hamidun Mexhid!

*O Allah lavdëroje (te melekët e lartë) Muhamedin dhe
familjen e tij, ashtu siç lavdërove Ibrahimin dhe fa-*

⁵ Ali b. Muhammed, *Mirkat el-mefatih*, vep. cit., 2/746; Ubejdullah bin Muha-mmeh, *Mir'atu el-mefatih sherhu Mishkati el-mesabih*, (Indi: Universiteti selefit, ed. 3, 1984), 3/279 -280; Muhammed bin Ali bin Adem, *Sherhu Suneni en-Nesaij*, (Rijad: Dar el-mi'raxh ed-deulijje li en-neshr, 1996), 15/205.

⁶ El-Mubarekfuri, *Tuhfetu el-ahvedhij*, vep. cit., 7/130.; Ubejdullah bin Mu-hammed, *Mir'atu el-mefatih*, vep. cit., 3/279.

*miljen e tij, vërtet Ti je i Lavdishëm dhe i Madhëruar!
O Allah begatoje Muhamedin dhe familjen e tij, ashtu
siç begatove Ibrahimin dhe familjen e tij, vërtet Ti je i
Lavdishëm dhe i Madhëruar!*

...ka rëndësi aq të madhe saqë kërkesa jonë plotësohet, madje edhe nëse nuk e përshekruajmë fare.

Atëherë:

- Çfarë i bën salavatet kaq të rëndësishme?
- Çfarë fshihet në salavate?

Dy llojet e lutjes

Dijetarët kanë shpjeguar se lutjet janë dy llojesh:

1. Lutje të adhurimit (ar. *dua ibadetin*), dhe
2. Lutje të kërkesës (ar. *dua mes'eletin*).

Duaja e ibadetit nënkupton çdo vepër me të cilën ti synon kënaqësinë e Allahut dhe fitimin e shpërblimit tek Ai. Këtu hyjnë falja e namazit, agjërimi i Ramazanit, dhënia e sadakës dhe zekatit, kryerja e haxhit, kerkimi i diturisë, etj. Kjo për shkak se ne, kur i kryejmë këto vepra i kryejmë me njetin që përmendëm më sipër, andaj sikur po lutemi praktikisht, me vepër dhe gjendje, që Allahu të na japë kënaqësinë dhe Xhenetin. Ndërsa duaja e mes'eles (kërkesës) nënkupton parashtrimin tekstual të kërkesës, p.sh.: “O Allah! Më fal mua, prindërit e mi dhe të gjithë besimtarët!”⁷

⁷ Muhammed b. Salih el-Uthemjmin, *Mexhmu fetava ve resail fadileti esh-Shejh Muhammed bin Salih el-Uthejmin*, (Rijad: Dar eth-thurejja, 1998), 9/906; Muhammed b. Salih el-Uthemjmin, *Sherhu Rijadi es-salihinë*, (Rijad: Dar el-vatan), 3/91.

Lutja duke çuar salavat klasifikohet në rangun e parë.

Kuptimet e salavateve dhe esenca e tyre

Zhytja në thellësi të salavateve na dhuron shpjegime madhështore të cilat na bindin për këtë fuqi dhe potencial të tyre për zgjidhjen e problemeve dhe arritjen e shpëtimit në të dyja botët. Dijetarët kanë dhënë disa shpjegime, ajkën e të cilave po e sjellim këtu:

1. Çuarja salavate për Muhamedin a.s., referuar ajetit të sipërshtënuar (El Ahzabë, 56), nënkupton para së gjithash përfillje dhe zbatim të urdhrit të Allahut xh.sh.. Pra, kur ne çojmë salavate për Muhamedin a.s., ne në fakt e përfillim një urdhër të Allahut xh.sh., gjë kjo që ka rëndësi për përmbushjen e kërkesave tona, sepse, siç thuhet, gjërat që janë tek Allahu arrihen vetëm duke e respektuar Atë.
2. Salavatet përmbajnë në vete edhe dhikrin, përmendjen e Allahut xh.sh.. Duke qenë se dhikri është mjet me të cilin fitohet kënaqësia e Allahut,⁸ atëherë përmbushja e kërkesës nëpërmjet salavateve që janë mjet për fitimin e kënaqësisë së Allahut xh.sh., është e madhe.
3. Salavatet paraqesin respektin tonë të thellë për Muhamedin a.s.. Ne lutemi për të dhe i japim përparësi atij në dua edhe ndaj vetes sonë për shkak të bindjes se kë-

⁸ Shih ajetin: *“Pra më kujtoni Mua, Unë ju kujtoj juve...”* (El Bekare, 152).

shtu përmbushet besimi ynë⁹ dhe kështu shlyejmë një pjesë të borxhit tonë karshi tij. Me këtë rast, duhet të sjellim ndërmend atë që Ibën Abduselami ka thënë se, ne duke i çuar salavat Muhamedit a.s., nuk është se ndërmjetësojmë për të, sepse ne nuk jemi në atë pozitë që të ndërmjetësojmë për dikë si Muhamedi a.s., por thjesht, duke qenë se Allahu na ka urdhëruar ta kompensojmë të mirën dhe ne nuk mund t'ia kompensojmë mundin atij, e ka ligjësuar salavatit si një formë e shlyerjes së një pjese të borxhit tonë karshi tij.

4. Fitim i shpërblimit të madh duke çuar salavat. Nëse i referohemi hadithit të sipërshënuar në të cilin për një salavat parashihen katër lloje shpërblimi (salavati i Allahut për ne, pra mëshira e Tij, ngritja me dhjetë pozita, begatimi me dhjetë të mira dhe shlyerja e dhjetë të këqijave), atëherë kalkuloni se sa të mirat mund t'i fitojmë duke shtuar salavatet.¹⁰

⁹ Enesi r.a. tregon se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: *“Pasha Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, asnjëri prej jush nuk ka besuar plotësisht përderisa unë të mos jam për të më i dashur se babai i tij, se fëmija e tij dhe se të gjithë njerëzit bashkë.”* Hadithin e shënon Buhariu, nr. 15.

¹⁰ Muhammed Ali bin Muhamemd bin Alan, *Delil el-falihinë li-turuk Rijadi es-Salihinë*, (Bejrut: Dar el-ma'rifeh, 2004), 5/18; Ali b. Muhammed, *Mirakat el-mefatih sherhu Mishkati el-mesabih*, (Bejrut: Dar el-fikr, 2002), 2/746; Ubejdullah bin Muhammed, *Mir'atu el-mefatih sherhu Mishkati el-mesabih*, (Indi: Universiteti selefit, ed. 3, 1984), 3/279 -280; Muhammed bin Ali bin Adem, *Sherhu Suneni en-Nesaij*, (Rijad: Dar el-mi'raxh ed-deulijje li en-neshr, 1996), 15/205.

Mësimet

1. Shpeshtimi i salavateve, veçmas në ditën e xhuma kur ato i prezantohen Muhamedit a.s., dhe kur është momenti në të cilin lutja nuk refuzohet.
2. Fillimi i çdo lutje duke falënderuar Allahun dhe duke dërguar salavate për Muhamedin a.s., sepse kështu është etika e lutjes, por edhe mundësia më e madhe që lutja të pranohet.
3. Rikujtimi se esenca e salavateve përkon me vetëdijen tonë për detyrimet që kemi karshi Muhamedit a.s., andaj të marrim shkas këtë që të mësojmë më shumë për Muhamedin a.s., për detyrimet tona karshi tij, për edukatën dhe etikën që duhet ta kemi në raport me të. Të mos lejojmë që të përmendet emri i tij, ndërsa ne të mos çojmë salavat për të.
4. Bashkimi ndërmjet lutjes dhe salavateve. Pra, jo çdoherë bëjmë vetëm njërën e ta braktisim tjetrën, por, ndonjëherë bëjmë lutje, siç ka bërë edhe vet Muhamedi a.s., e herë të tjera i çojmë salavate.

Prof. ass. dr. Musa VILA

PASTËRTIA FIZIKE DHE SHPIRTËRORE NË ISLAM

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ قَالَ: إِنِّي سَمِعْتُ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَقُولُ إِنَّ أُمَّتِي يُدْعَوْنَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ غُرًّا مُحَجَّلِينَ مِنْ آثَارِ الْوُضُوءِ فَمَنْ اسْتَطَاعَ مِنْكُمْ أَنْ يُطِيلَ غُرَّتَهُ فَلْيَفْعَلْ.

Tregon Ebu Hurejra r.a. se e ka dëgjuar Resulullahun s.a.v.s. duke thënë:

“Në Ditën e Ringjalljes, pasuesit e mi do të thirren në bazë të shkëlqimit vezullues nga gjurmët e abdesit dhe kushdo që mundet ta shtojë pjesën që shkëlqen (duke e kryer këtë pastrim në mënyrën sa më të përkryer) duhet ta bëjë këtë.”¹

Fjalët e panjohura:

Fjala غُرًّا - *Gurren*, në kuptimin leksikor d.m.th. *balosh* i bardhë në ballë të kalit جَبْهَةِ الْفَرَسِ , d.m.th. pullë e bardhë, shkëlqimi që del nga koka e besimtarit.

¹ “Sahihul Buhari”, vëll. I, fq.130, nr.136.

Në këtë kontekst kemi hadithin, kur u pyet Resulullahu s.a.v.s. se si do t'i njohë pasuesit e tij që do të vijnë pas tij e ai nuk i ka parë më parë. Ai s.a.v.s. iu përgjigj:

أَرَأَيْتَ لَوْ أَنَّ رَجُلًا لَهُ حَيْلٌ غُرَّ مُحَجَّلَةٌ

“Më trego nëse një person është pronar i një kali që në ballë ka baloshin e bardhë, a nuk do ta njohë atë?” Ata iu përgjigjën: “Po, si jo!” Ai tha: “Vërtet ymeti im do të vijnë duke shkëlqyer nga abdesi dhe unë i pres ata te kroi i Xhennetit (Havdi).”²

Fjala التَّحِيلُ - *Et-tehxhil*, ka kuptimin e shkëlqimit vezullues që del nga gjymtyrët, duart dhe këmbët e besimtarit - بَيَاضٌ فِي يَدَيْهَا وَرِجْلَيْهَا.

Që të dy nocionet غُرَّ مُحَجَّلِينَ - *Gurren Muhaxhelinë*, tregojnë për pjesët, gjymtyrët e trupit të cilat myslimanët i lajnë gjatë pastrimit për përgatitjen për falje dhe për vepra të tjera adhurimi ndaj Allahut xh.sh., të cilat do të ndriçojnë në Ditën e Ringjalljes dhe që melaqet do t'i thërrasin me këtë emër nga gjurmët e abdesit.

Shpjegimi i hadithit

Hadithi bazë tregon për një karakteristikë të veçantë të ymetit islam në Ditën e Ringjalljes, e që është shkëlqimi i gjymtyrëve të trupit të besimtarit nga gjurmët e abdesit. Po ashtu, ky hadith korrespondon me njohjen e pasuesve të Resulullahut s.a.v.s. atë Ditë, kur njerëzit do të tubohen dhe për

² “Sahihu Muslim”, vëll. I, fq.218, nr.249.

nga numri do të jenë të shumtë sikurse kokrrat e orizit. Pra, Resulullahu s.a.v.s. do t'i njohë pasuesit e tij, Ditën e Ringjalljes nga pasuesit e Musait a.s., Isait a.s., Nuhut a.s., Ibrahim-it a.s. përmes gjurmëve të abdesit që hetohen nga shkëlqimi i pjesëve të trupit. Në fytyrat e besimtarëve, në duart, në këmbët, në flokët, në veshët, në qafat e tyre, do të ketë shkëlqim vezullues që është rezultat i marrjes së abdesit në këtë botë, për të kryer adhurime të ndryshme ndaj Allahut Fuqiplotë.

Si epërsi e këtyre besimtarëve në Ditën e Gjykimit, do të jetë edhe dhënia e ujit nga kroi i Xhenetit nga Resulullahu s.a.v.s., i cili personalisht do t'u shërbejë atyre me dorën e Tij të nderuar, duke e shuar etjen, e që pas këtij momenti ata nuk do t'i kapë etja për ujë.

Besimtarët sa ishin në këtë botë e nderuan Allahu xh.sh., e nderuan Pejgamberin e Tij me marrjen e abdesit, e në botën tjetër ata një nderim të veçantë do ta përfetojnë nga Allahu xh.sh. me shkëlqimin vezullues të pjesëve të trupit nga gjurmët e abdesit dhe një nderim të veçantë nga Resulullahu s.a.v.s., duke iu shërbyer me ujë për ta hequr etjen nga trupi i tyre, në atë Ditë, kur njerëzit do të jenë gati të mbuluar nga djersët e tyre.

Në lidhje me këtë, Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

فَإِنَّهُمْ يَأْتُونَ غُرًّا مُحَجَّلِينَ مِنَ الْغُضُوءِ وَأَنَا فَارِطُهُمْ عَلَى الْحَوْضِ

“Vërtet ata – pasuesit e mi (Ditën e Ringjalljes) do të vijnë duke shkëlqyer nga abdesi, dhe unë i pres ata te kroi i Xhenetit (Havdi).”

Sa u përket atyre njerëzve që nuk e njohën abdesin, nuk e praktikuan, nuk ranë në sexhde, nuk u falën, refuzuan e ishin

prej hipokritëve dhe të devijuarve, Pejgamberi s.a.v.s. për këta tha:

أَلَا لِيَذَادَنَّ رِجَالٌ عَنْ حَوْضِي كَمَا يُذَادُ الْبَعِيرُ الضَّالُّ أَنَادِيهِمْ أَلَا
هَلُمَّ فَيَقَالُ إِنَّهُمْ قَدْ بَدَّلُوا بَعْدَكَ فَأَقُولُ سَحَقًا سَحَقًا.

*“Vini re! Do të përzihen nga kroi im (bazeni) burra, ashtu siç përzihet deveja e humbur. Unë i thërras ata që të vijnë (te kroi), atëherë thuhet: vërtet ata kanë devijuar pas teje, e unë u them: Qëndroni sa më larg, qëndroni sa më larg.”*³

Vlera e braktisjes së shtratis për abdes

Në një *ether* (gjurmë)⁴ thuhet se:

“Vërtet Allahu xh.sh. e mëshiron robin e Tij besimtar kur ngritët nga shtrati i tij për ta falur namazin e sabahut. Ngritët i shqetësuar duke u dridhur (rrëqethur) i afrohet ujit të ftohtë për të marrë abdes dhe për ta falur namazin, atëherë Allahu xh.sh. u thotë melaqeve: “O melekët e mi, shikojeni atë robin Tim besimtar, i cili e ka braktisur shtratin e tij komod dhe të rehatshëm, jorganin e nxehtë dhe merr abdes me ujë të ftohtë për t’u falur, ngritët tek Unë duke kërkuar

³ “Sahihu Muslim”, vëll. I, fq.218, nr.249.

⁴ El-etheru - الأَئْثَرُ nënkupton transmetimin gojor apo praktik që vjen nga sahabët dhe tabinët. Te shumica e hadithologëve, nocioni El-Ether është sinonim i nocionit hadith. (Mu’xhem mustalehatil hadith, fq.13).

ndihmë, atëherë jini dëshmitarë se Unë e kam falur dhe e kam futur në Xhenet.”

Kjo është një vepër madhore për besimtarin, njëherësh është një shpërblim madhor dhe i pa diskutueshëm për vepërën e tij.

Në një hadith tjetër, Resulullahu s.a.v.s. ka thënë:

عَجِبَ رُبُّنَا عَزَّ وَجَلَّ مِنْ رَجُلَيْنِ رَجُلٍ ثَارَ عَنْ وَطَائِهِ وَلِحَافِهِ مِنْ بَيْنِ أَهْلِهِ وَحَيَّهِ إِلَى صَلَاتِهِ فَيَقُولُ رَبُّنَا أَيَا مَلَأَيْكَتِي أَنْظُرُوا إِلَى عَبْدِي ثَارَ مِنْ فِرَاشِهِ وَوُطَائِهِ وَمِنْ بَيْنِ حَيَّهِ وَأَهْلِهِ إِلَى صَلَاتِهِ رَعْبَةً فِيمَا عِنْدِي وَشَفَقَةً مِمَّا عِنْدِي وَرَجُلٍ عَزَا فِي سَبِيلِ اللَّهِ عَزَّ وَجَلَّ فَأَنْهَزُوا فَعَلِمَ مَا عَلَيْهِ مِنَ الْفِرَارِ وَمَا لَهُ فِي الرُّجُوعِ فَرَجَعَ حَتَّى أُهْرِيقَ دَمُهُ رَعْبَةً فِيمَا عِنْدِي وَشَفَقَةً مِمَّا عِنْدِي فَيَقُولُ اللَّهُ عَزَّ وَجَلَّ لِمَلَأَيْكَتِهِ أَنْظُرُوا إِلَى عَبْدِي رَجَعَ رَعْبَةً فِيمَا عِنْدِي وَرَهْبَةً مِمَّا عِنْدِي حَتَّى أُهْرِيقَ دَمُهُ.

“Allahu xh.sh. mahnitet me dy persona: Nga personi, i cili e braktisë shtratin dhe jorganin e tij nga të dashurit dhe familja e tij për ta falur namazin. Atëherë Allahu xh.sh. thotë: Shikojeni robin tim, e ka braktisur krevatin (gruan), të dashurit dhe familjen e tij për namaz duke dëshiruar atë që është tek Unë, dhe duke shpresuar në mëshirën Time; dhe nga personi i cili lufton në rrugën e Allahut, ku shokët i janë vrarë dhe ai e di për vrasjen e tyre dhe është i vetëdijshëm se çka e pret nëse kthehet (te shokët), por prapë ai kthehet (në fushë të betejës te shokët e vrarë) derisa e jep gjakun e tij. Atëherë Allahu xh.sh. u thotë melaqeve të

tij: “Shikojeni robin tim, u kthye dhe e dha gjakun e vet vetëm e vetëm për të shpresuar shpërblimin tim dhe mëshirën time.”⁵

Vërtet Allahu xh.sh. është i çuditur dhe i mahnitur me veprat e këtyre dy personave. Këto vepra kanë peshë dhe vlerësim madhështor tek Allahu xh.sh., ngase kanë mundim dhe vështirësi. Po ashtu personi duhet të jetë këmbëngulës dhe i paluhatshëm në to.

Në këtë hadith, braktisja e shtratit për të marrë abdes është krahasuar me luftëtarin që merr pjesë në luftë kundër armikut, kjo është bërë për nga pesha dhe vlera që ka abdesi. Pikë e përbashkët e këtyre dy personave është lufta. Tek e para është kundër nefsit dhe shejtanit, ndërsa te personi i dytë është lufta kundër dushmanit dhe shejtanit. Pra, ku t’i gjejmë këta njerëz të tillë në mesin tonë, këta besimtarë për t’ua dhënë këtë shpërblim të madh në Ditën e Ringjalljes.

Gjithashtu, Resulullahu s.a.v.s. ka thënë:

الطُّهُورُ شَطْرُ الْإِيمَانِ وَالْحَمْدُ لِلَّهِ تَمْلَأُ الْمِيزَانَ

“Pastërtia është gjysma e besimit, ndërsa falënderimi ndaj Allahut e mbush peshojën (me shpërblim).”⁶

Kjo fjalë e Pejgamberit a.s. tregon se pastërtia fizike e jashtme e njeriut konsiderohet gjysma e besimit, ndërsa pastërtia shpirtërore e brendshme është çështje e Zotit xh.sh., por

⁵ “Sunen Ebi Davud”, vëll. III, fq. 19, nr.2536; “Musned Ahmed”, vëll. I, fq. 416.

⁶ “Sahihu Muslim”, vëll. I, fq. 203, nr.223.

nëse ndodh që besimtari e pastron edhe të brendshmen, atëherë besimtari *e ka plotësuar besimin e tij* - فَقَدْ اسْتَكْمَلَ الْإِيمَانَ.

Pra, Pejgamberi a.s., abdesin e konsideroi gjysmë të besimit, ku me të tregohet një shenjë e bindjes fetare, ngase ai që merr abdes shpalos shenjën e besimit. Pejgamberi a.s. transmetohet se ka thënë:

لَا يُحَافِظُ عَلَى الْوُضُوءِ إِلَّا الْمُؤْمِنُ

*“Abdesin nuk e ruan përveçse besimtari.”*⁷

Kur dihet se marrja dhe ruajtja e abdesit është një fshehtësi në mes robit dhe Zotit dhe askush nuk mund ta dijë për tjetrin se a ka abdes apo jo. Vetëm Allahu është Ai i Cili e di fshehtësinë e njeriut dhe atë çka fshehin zemrat e tyre. Ai e di edhe fshehtësinë e gjokseve dhe të vjedhurat e syve. Njeriu ka mundësi të falë namazin pa qenë i pastër, askush prej njerëzve nuk mund ta dijë këtë. Njeriu ka mundësi të hyjë në xhami për t’u falur pa abdes, por duke e ditur se një gjë të tillë e di dhe e sheh Allahu Fuqiplotë, ai merr abdes, e kur të marrë abdes, e ka arritur gjysmën e besimit, ngase me këtë njeriu e di vëzhgimin e Zotit në fshehtësi dhe haptazi.

⁷ “El-Mustedrek ala sahihajni lil Hakim mea tealikati Dh-dhehebij fit-telhisi”, vëll. I, fq.221, nr.449, hadith sahih.

Shlyerja e mëkateve përmes abdesit

Abdesi nuk është vetëm pastrim trupor, në të njëjtën kohë me të synohet edhe heqja dorë nga papastërtitë shpirtërore siç janë mëkatet.

Në këtë kontekst, Resulullahu s.a.v.s. ka thënë:

أَلَا أُذَلِّكُمْ عَلَى مَا يَمْحُو اللَّهُ بِهِ الْخَطَايَا وَيَرْفَعُ بِهِ الدَّرَجَاتِ قَالُوا بَلَى يَا رَسُولَ اللَّهِ قَالَ إِنْ بَاغُ الْوُضُوءِ عَلَى الْمَكَارِهِ وَكَثُرَ الْخَطَا إِلَى الْمَسَاجِدِ وَانْتَظَرُ الصَّلَاةَ بَعْدَ الصَّلَاةِ فَذَلِكُمْ الرِّبَاطُ فَذَلِكُمْ الرِّبَاطُ.

“Keni vëmendjen! A dëshironi t’ju tregoj për atë që Allahu ia shlyen mëkatet dhe ia ngrit pozitën me të? Ata thanë: Po, si jo, o i Dërguar i Allahut! Ai tha: Marrja e abdesit në formë të përkryer në vështirësi, hapat e shumtë deri në xhami, pritja e namazit dhe vëmendja te namazi tjetër, pra namaz pas namazi. Ky është xhihad, ky është xhihad (sikur luftëtari në vijën e frontit).”⁸

Me fjalën: اسْبَاغُ الْوُضُوءِ عَلَى الْمَكَارِهِ - *“Marrja e abdesit në formë të përkryer në vështirësi”* nënkupton marrja e abdesit në kohë të ftohtë me ujë të ftohtë dhe çaste të vështira, kur me vështirësi dhe mund, arrihet te abdesi. Kështu njeriu ia mësyn abdesit vetëm e vetëm për të fituar vlerësimin dhe shpërblimin e Allahut, e me këtë veprim Allahu xh.sh. ia shlyen dhe ia heq mëkatet, ashtu siç bien prej erës fletët e gjetheve nga pema në kohën e ftohtë të vjeshtës dhe dimrit.

⁸ “Sahihu Muslim”, vëll. I, fq.219, nr.251.

Në lidhje me shlyerjen e mëkateve nga gjymtyrët e trupit, Resulullahu s.a.v.s. ka thënë:

إِذَا تَوَضَّأَ الْعَبْدُ الْمُسْلِمُ أَوْ الْمُؤْمِنُ فَعَسَلَ وَجْهَهُ حَرَجَ مِنْ وَجْهِهِ كُلُّ خَطِيئَةٍ نَظَرَ إِلَيْهَا بِعَيْنَيْهِ مَعَ الْمَاءِ أَوْ مَعَ آخِرِ قَطْرِ الْمَاءِ فَإِذَا عَسَلَ يَدَيْهِ حَرَجَ مِنْ يَدَيْهِ كُلُّ خَطِيئَةٍ كَانَ بَطَشَتْهَا يَدَاهُ مَعَ الْمَاءِ أَوْ مَعَ آخِرِ قَطْرِ الْمَاءِ فَإِذَا عَسَلَ رِجْلَيْهِ حَرَجَتْ كُلُّ خَطِيئَةٍ مَسَّتْهَا رِجْلَاهُ مَعَ الْمَاءِ أَوْ مَعَ آخِرِ قَطْرِ الْمَاءِ حَتَّى يُخْرَجَ نَفِيًّا مِنَ الذُّنُوبِ.

*“Kur robi mysliiman apo besimtari merr abdes dhe lanë fytyrën, atij i shlyhet çdo mëkat që e ka shikuar me sy, përmes larjes me ujë apo përmes pikës së fundit të ujit që bie (nga fytyra). Kur i pastron duart, atij i shlyhet çdo mëkat i veprimt të duarve të tij, përmes larjes me ujë apo përmes pikës së fundit të ujit që bie (nga duart). Kur i pastron këmbët, atij i shlyhet çdo mëkat i ecjes së këmbëve përmes ujit apo pikës së fundit të ujit që bie (nga këmbët), derisa ai pastrohet nga të gjitha mëkatet.”*⁹

Në abdes pastrohet fytyra, gjuha, goja, veshët, duart dhe këmbët nga mëkati. Këtu shihet një inkurajim për ata që bëjnë adhurime, t'i bëjnë me abdes të pastër dhe të çiltër para Allahut xh.sh.. A mund të ketë shpërblim më të madh se ky?! I përgëzojmë ata që brenda një dite marrin abdes për pesë kohët e namazit, pastrohen fizikisht dhe shpirtërisht, qoftë edhe në çaste të vështira dhe të pamundshme, me ujë të ftoh-

⁹ “Sahihu Muslim”, vëll. I, fq.215, nr.244.

të në kohë të ftohta. Këtu përmendet syri i veçuar, ngase gjymtyrët e tjera pastrohen krahas fytyrës. Goja dhe hunda janë pjesë të fytyrës, por në pastrim janë të veçanta.

Nëse ne jemi praktikues të asaj që e kemi mësuar dhe dëgjuar, atëherë edhe begatitë dhe mirësitë do të shumëfishohen në mesin tonë. Abdesi është çështje e thjeshtë për nga praktika dhe mësimi, por ka nevojë t'u shpjegohet dhe t'u mësohet njerëzve. Kështu, një ditë, Othmani r.a. i kishte ftuar dhe tubuar sahabët jashtë xhamisë së Pejgamberit a.s. për t'ia mësuar atyre abdesin praktikisht. Ai iu tha:

“Ma sillni një enë.” Dhe filloi t'i pastrojë duart tri herë, pastaj dorën e djathtë e futi në enë dhe e shpërlau gojën, futi ujë në hundë dhe e pastroi atë, pastaj fytyrën e pastroi tri herë dhe krahët deri në bërryla tri herë ... pastaj tha: “Kështu e kam parë duke marrë abdes Pejgamberin a.s. dhe tha:

مَنْ تَوَضَّأَ نَحْوَ وُضُوئِي هَذَا ثُمَّ صَلَّى رَكْعَتَيْنِ لَا يُحَدِّثُ فِيهِمَا نَفْسَهُ
غُفِرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ.

“Kush merr abdes sikurse ky abdesi im, dhe i falë dy rekate, duke ju larguar mendimeve dhe veseve në to, Allahu xh.sh. do t'ia falë mëkatet e mëparshme.”¹⁰

Kjo është rruga më e lehtë, pa ekzagjerime, pa komplikime, por në mënyrë të thjeshtë dhe me veprim praktik ua paraqet dhe mëson një kusht prej kushteve të namazit, e ai

¹⁰ “Sahihul Buhari”, vëll. I, fq.259, nr.159;

është abdesi. Po ashtu, tregon Ebu Bekri se Resulullahu s.a.v.s. ka thënë:

مَا مِنْ رَجُلٍ يُذْنِبُ ذَنْبًا ثُمَّ يَقُومُ فَيَتَطَهَّرُ ثُمَّ يُصَلِّي ثُمَّ يَسْتَغْفِرُ اللَّهَ
إِلَّا غَفَرَ اللَّهُ لَهُ

“Nuk ka njeri që bën mëkat, e pastaj ngritët e merr abdes, pastaj falë namaz, pastaj i kërkon falje Allahut përveçse do t’i falet ai mëkat.”¹¹

Në këtë hadith nuk përfshihen *mëkatet e mëdha* - الْكَبَائِرُ , e që janë veprat që kanë ndëshkime, ato që Pejgamberi s.a.v.s. i ka emërtuar mëkate të mëdha, ato që përbëjnë kërcënim nga Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe të drejtat njerëzore (borxhi).

Pra, qoftë i shpëtuar secili që merr abdes dhe ia mësyn shtëpisë së Allahut - xhamisë, i penduar dhe me modesti të plotë. Qoftë i shpëtuar ai, i cili për hir të Allahut e ka pastruar anën trupore dhe shpirtërore, anën e jashtme dhe të brendshme.

Pastërtia nuk është çështje e vonuar në Kuran

Kur filloi shpallja nga Allahu xh.sh., qysh në fillim, zbritën disa ajete që urdhërojnë në pastërti. Kuptohet në pastërtinë trupore që është cilësi e jashtme dhe në pastërtinë shpirtërore që është cilësi e brendshme e që nënkupton tevhi-

¹¹ “Sunen Et-Tirmidhi”, vëll.VI, fq.213, nr.3006; Ibën Maxhe, vëll. I, fq.446, nr.1395.

din apo njeshmërinë e Krijuesit. Allahu xh.sh. në këtë kontekst thotë:

يَا أَيُّهَا الْمُدَّثِّرُ. قُمْ فَأَنْذِرْ. وَرَبَّكَ فَكَبِّرْ. وَثِيَابَكَ فَطَهِّرْ. وَالرُّجْزَ فَاهْجُرْ.

“O ti i mbuluar (o Muhamed), qohu dhe lajmëroji dhe Zotin tënd madhëroje, dhe petkat tua pastroji dhe papastërtisë largoj.” (El Mudethir, 1-5)

Nga ky ajet, shihet qartë se pastërtia fizike dhe trupore nuk është çështje e vonuar në Kuran, por përkundrazi konsiderohet prej çështjeve që kanë zbritur në tokë qysh prej momenteve të para të shpalljes nga Krijuesi Fuqiplotë.¹²

Pastërtia është detyrim para hyrjes në namaz, kështu që marrja e abdesit, pastrimi i rrobave, vendi i pastër dhe mbulimi i vendeve të turpshme janë prej kushteve të namazit.

Detyrimi i marrjes së abdesit që në gjuhën arabe i thuhet vudu, është përcaktuar në këtë varg kuranor:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَاطَّهَّرُوا...

“O ju që keni besuar. Kur doni të falni namaz, lani fytyrën dhe duart deri në bërryla, jepni kokës mes’h (fshijeni me duar të lagura), lani edhe këmbët deri në

¹² Dr. Musa Vila, “Komentimi i haditheve”, fq.50. Shiko link.youtube.com, Dr. Musa Vila, Feja është pastërti (abdesi).

nyje, e nëse jeni të papastër (xhunub), pastrohuni.” (El Maide, 6)

Këtu, në këtë varg kuranor bëhen të qarta edhe katër farzet e abdesit, të cilat janë: 1. Larja e fytyrës nga fillimi i rrënjës së flokut në ballë deri poshtë mjekrës, dhe nga veshi deri në veshin tjetër; 2. Larja e duarve deri në bërryla; 3. Fshirja e një të katërtës së kokës me dorë të lagur apo mes’hi i kokës; 4. Larja e këmbëve deri mbi nyja.

Sa i përket mes’hit të kokës, për një të katërtën e saj është përcaktuar në bazë të transmetimit të hadithit nga Mugires r.a., e që e ka regjistruar Imam Muslimi:

أَنَّ النَّبِيَّ أَمَرَ سُبَّاطَةَ قَوْمِ فَبَالٍ وَ تَوْصَّأً وَ مَسَحَ عَلَى نَاصِيَتِهِ وَ حُقْنِيهِ.

“Vërtet Pejgamberi s.a.v.s. e kreu nevojën e vogël te vendi (ku njerëzit e kishin të përcaktuar), pastaj mori abdes dhe i dha mes’h kokës përpara ¼, dhe këmbëve.”

Ky hadith është argument edhe për shafitë, të cilët thonë se për mes’h mjafton vetëm lagja e tri qimeve të flokëve. Imam Maliku kushtëzon dhënien mes’h të kokës në tërësi. Disa hanefi mendojnë se dhënia mes’h kokës me tre gishta mjafton, sepse në origjinal mes’hi jepet me gishta.¹³

Këtyre farzeve të abdesit, Imam Shafi'u, ia ka shtuar edhe radhitjen الترتيب – *tertib* dhe *nijetin*. Ndërsa Imam Ahmedi, ia ka shtuar *larjen e gojës dhe të hundës*. Sipas Ebu Hanifes, këto shtesa janë prej suneteve të abdesit.

Sunetet e abdesit sipas Ebu Hanifes janë njëmbëdhjetë:

¹³ El-Merginani, “El-Hidaje sherh bidajetil muhtedi”, fq.12.

1. Përmendja e emrit të Allahut (bismilahi);
2. Nijeti për largimin e papastërtisë dhe abdesit;
3. Larja e duarve deri në kyç;
4. Përdorimi i misvakut;
5. Futja e ujit në gojë dhe hundë;
6. Larja e gjymtyrëve të abdesit nga tri herë;
7. Fërkimi i mjekrës, gishtave të dorës dhe të këmbës;
8. Mes'hi i tërë kokës;
9. Mes'hi i veshëve brenda dhe jashtë;
10. Të filluarit e larjes së gjymtyrëve nga e djathta;
11. Tertibi apo radhitja e larjes së gjymtyrëve gjatë abdesit.

Në rast të mungesës së ujit, personi mund t'i lajë gjymtyrët edhe me nga një herë. Uthmani r.a. tregon se:

تَوَضَّأَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ مَرَّةً مَرَّةً

“Pejgamberi s.a.v.s. ka marr abdes vetëm me nga një herë.”¹⁴

Duatë dhe lutjet e abdesit

Çdo pastrim i trupit apo gjymtyrëve të tij me nijet për të ruajtur dëlirësinë dhe për të kërkuar kënaqësinë e Allahut xh.sh. konsiston me një orientim dhe përkushtim edhe për kërkesat dhe dëshirat e robit - besimtar, karshi Krijuesit Fuqiplotë.

¹⁴ “Sahihul Buhari”, vëll. I, fq.273, nr.153.

Derisa besimtari lanë gjymtyrët e trupit gjatë marrjes së abdesit që kishte një prej qëllimeve edhe shlyerjen e mëkateve, ai i kërkon falje dhe i lutet Allahut për shlyerje të mëkateve dhe njëkohësisht ndihet i penduar për mëkatet e gjymtyrëve që i ka bërë në të kaluarën e tij.

Sahabiu i quajtur Ukbe bin Amiri, tregon se si ata ndërroshin dhe e zëvendësonin njëri-tjetrin në ligjëratat e Resulullahut s.a.v.s. derisa një ditë, njëri ishte bari i deveve, ditën tjetër ishte nxënës që ulej para Resulullahut s.a.v.s. për të dëgjuar këshillat, porositë dhe mësimet e tij. Një ditë në muzg (vazhdon të tregojë Ukbeja), pasi i rehatova devetë, shkova te Pejgamberi s.a.v.s., i cili ishte në këmbë duke u ligjëruar sahabëve, arrita të kapi fjalët e tij duke thënë:

“Kur ndonjëri prej jush merr abdes dhe e plotëson atë, pastaj ngritët dhe falë dy rekate namaz me një përqendrim me zemër dhe fytyrë, atëherë atij Xheneti i bëhet detyrim dhe ai është i falur.” Atëherë thash (Ukbe bin Amir): “Sa thënie e mrekullueshme është kjo!” Një person tjetër që prezantonte nga fillimi, e ai ishte Omeri r.a., më tha: “Resulullahu s.a.v.s. më herët, para kësaj thënie, kishte porositur diçka edhe më të mrekullueshme se sa kjo thënie. “Unë i thashë: “O Ebu Hafs, ç’është ajo thënie?” Ai tha: “Vërtet para se të vish, Resulullahu s.a.v.s. tha:

مَا مِنْكُمْ مِنْ أَحَدٍ يَتَوَضَّأُ فَيُسَبِّحُ الْوُضُوءَ ثُمَّ يَقُولُ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ إِلَّا فُتِحَتْ لَهُ أَبْوَابُ الْجَنَّةِ الثَّمَانِيَةِ يَدْخُلُ مِنْ أَيِّهَا شَاءَ.

“Kur ndonjëri prej jush merr abdes dhe e plotëson atë, pastaj thotë: Esh-hedu en la ilahe il-la-llahu vah-

dehu la sherike leh, ve esh-hedu enne Muhammeden abduhu ve Resuluhu (*Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Allahut, Një i Vetëm dhe i Pashoq, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob i Dërguari i Tij*), i hapen tetë dyer të Xhenetit, prej së cilës të dëshirojë, do të mund të hyjë.”¹⁵

Nga kjo lutje mund të konstatojmë se marrja e abdesit, larja e gjymtyrëve të trupit, pastaj mohimi i shirkut si pastrim shpirtëror, sjell futjen në Xhenet. Në këtë lutje, Imam Tirmidhiu, pas dëshmisë e shton edhe këtë:

اللَّهُمَّ اجْعَلْنِي مِنَ التَّوَّابِينَ وَاجْعَلْنِي مِنَ الْمُتَطَهِّرِينَ

“O Zoti im, më bëj mua prej atyre që pendohen dhe prej atyre që pastrohen (nga mëkatet).”¹⁶

سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ أَسْتَغْفِرُكَ
وَأَتُوبُ إِلَيْكَ.

“I Madhërishëm je Ti, o Zoti im! Ty të takon falënderimi; dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër përveç Teje, kërkoj falje nga Ti dhe te Ti pendohem.”

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي وَوَسِّعْ لِي فِي دَارِي وَبَارِكْ لِي فِي رِزْقِي

“O Zoti im! Fali gjynahet e mia, bëre shtëpinë time të gjerë (të mjaftueshme) dhe bekoje riskun tim!”¹⁷

¹⁵ “Musned Ahmed”, vëll. IV, fq.146; “Sunen Ebi Davud”, vëll. I, fq.43, nr.169.

¹⁶ “Sunen Et-Tirmidhi”, vëll. I, fq.78, nr.55.

¹⁷ Sejjid Sabik, “Fikhus-suneh”, vëll. I, fq.54.

Vlen të potencojmë se ne si myslimanë duhet të krenohemi me këtë karakteristikë të veçantë të ymetit të Muhamedit a.s. nga ymetet e mëhershme dhe si rezultat i këtij veprimi dhe shpërblimi të ndihemi të privilegjuar me pastrim të gjymtyrëve (abdesin) në këtë botë, dhe me shpërblimin e Xhenetit në botën tjetër. Me abdes ne jetojmë si ymet i pastër, përkundër milionave njerëzve të feve të tjera, të cilët jetojnë jetë të kafshëve që nuk pastrohen në lutje, e as pas marrëdhënieve intime bashkëshortore. Ky ymet pastërtinë e ka fundament të tij. Myslimani kur lind duhet menjëherë të pastrohet nga ndyrësitë e gjakut që e kanë shoqëruar gjatë lindjes. I hiqen flokët dhe i shkurtohen thonjtë në shenjë pastërtie. Bëhet matja e flokëve dhe në shenjë pastërtie të pasurisë jepet lëmoshë për fëmijën. Kur e përfundon jetën përcillet nga kjo botë me larje të kufomës, dhe krejt në fund i falet xhenazja në shenjë pastërtie shpirtërore nga kjo botë materiale. Pra, kur lindi u pastrua dhe kur vdiq u pastrua.

Dr. Jusuf EL KARDAVI*

A NDRYSHON DISKURSI FETAR NGA NJË KOHË NË TJETRËN?

A ndryshon diskursi fetar nga një kohë në tjetrën?, dhe, a është diskursi në epokën e globalizimit¹ i ndryshëm nga ai në kohërat e tjera të më parme? A ka secila epokë diskurs të veçantë? A është diskursi si veshjet e njerëzve?, veshje për dimër dhe veshje për verë, veshje për qytetar dhe veshje për fshatar. Veshjet e njerëzve të një profesioni janë të ndryshme nga veshjet e njerëzve të profesionit tjetër? A nuk është feja, nga e cila rrjedh diskursi fikse, përse të ndryshojë diskursi dhe të bëhet i llojllojshëm për arsye të ndryshme?

Për këto pyetje, kërkohet të japim një sqarim, ngase feja në origjinën e saj dhe në tërësinë doktrinare, adhuruere, etike dhe ligjore nuk ndryshon, por ndryshon stili i arsimimit dhe thirrjes në të.

* Më 26 shtator 2022, ndërroi jetë dijetari Jusuf el Kardavi. Në kujtim të tij, po e botojmë këtë shkrim.

¹ Mbi “Konceptin e Globalizimit”, shih në librin tonë “Muslimanët dhe Globalizimi” (fq. 9-17).

Nëse studiuesit dhe juristët e islamit kanë vendosur se fetvaja ndryshon me ndryshimin e kohës, vendit, rastit dhe gjendjes, dhe fetvaja është në lidhje me dispozitat e Sheriatit, atëherë e njëjta logjikë thotë se ndryshimi i thirrjes apo diskursit me ndryshimin e kohës, vendit, rastit dhe gjendjes është edhe më meritohet dhe më prioritar.

Ajo që u thuhet myslimanëve, nuk është e njëjtë me atë që u thuhet jomyslimanëve.

Ajo që i thuhet myslimanit që është rishtas në Islam, nuk është e njëjtë me atë që i thuhet myslimanit të lashtë në Islam.

Ajo që i thuhet myslimanit të drejtë dhe të përkushtuar, nuk është e njëjtë me atë që i thuhet myslimanit jopraktikues dhe mëkatar ndaj Zotit të tij.

Ajo që i thuhet myslimanit në shtetin islam, nuk është e njëjtë me atë që i thuhet myslimanit në një shoqëri jo islame.

Ajo që u thuhet të rinjve, nuk është e njëjtë me atë që u thuhet pleqve.

Ajo që u thuhet grave, nuk është e njëjtë me atë që u thuhet burrave.

Ajo që u thuhet të pasurve, nuk është e njëjtë me atë që u thuhet të varfërve.

Ajo që u thuhet sundimtarëve, nuk është e njëjtë me atë që u thuhet vartësve.

Ajo që thuhet në një nga fshatrat e Gjirit, Egjiptit të Epërm apo në fshatrat e Pakistanit, nuk është e njëjtë me atë që u thuhet njerëzve përmes kanaleve satelitore, të cilat i përcjell tërë bota.

Ajo që u thuhet njerëzve në kohëra të izolimit, nuk është e njëjtë me atë që u thuhet atyre në epokën revolucionit të komunikimit, e cila të gjithë botën e bëri si një fshat, dhe kjo është çështje e rëndësishme në domethënien e fjalës “epoka e globalizimit”, përkatësisht, epoka e konvergencës globale.

Nuk ka dyshim se ka tërësi të përbashkëta të cilat ju adresohen të gjithëve dhe të cilat përdoren nga të gjithë, por aty mbetet edhe një sasi e veçantë për secilën kategori prej atyre që u përmenden, të cilës ligjëruesi apo thirrësi duhet t’i adresohet me fjalim përkatës, ku duhet t’u përgjigjet në pyetjet e tyre, dhe t’ua zgjidh problemet e tyre, si dhe t’ua largojë dyshimet e tyre, ashtu siç veproi Pejgamberi a.s., kur e dërgoi Muadh ibën Xhebelin r.a. në Jemen. Pejgamberi a.s. i tha: *“Ti je duke shkuar te një popull që janë ithtarë të Librit, andaj ajo që së pari kërkohet prej tyre, le të jetë dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut...”*² Hafidh ibën Haxheri, në shpjegimin e këtij hadithi, mbi arsyen e fillimit të tij me këtë fjali “Ti je duke shkuar te një popull që janë ithtarë të Librit”, ka thënë: “Ajo është si hyrje për këshillën për ta tërhequr interesimin e tyre për të, sepse ithtarët e Librit kanë njohuri mbi fjalinë, andaj kujdesi në adresimin e tyre, nuk duhet të jetë i njëjtë, siç është adresimi ndaj injorantëve dhe idhujtarëve.”³

Së këndejmi, nuk është për t'u habitur që diskursi ynë fetar në epokën e globalizimit të jetë i ndryshëm në një masë

² Transmeton el-Buhariu nga Ibn Abbasi disa vende në librin e tij me numrat: 1395, 1496, 1458 dhe të tjerë. Gjithashtu e transmeton edhe Muslimi.

³ Fat’hul- Bari 3/358, shpjegimi i hadithit nr. 1496, në librin e zekatit.

nga diskursi ynë fetar para epokës së globalizimit, nëse dëshmohej se me të vërtetë ekziston një epokë e re që e karakterizon globalizimin. Ndoshta ka qenë diskursi ynë i myslimanëve para asaj kohe, me karakter lokal, dua të them, ne aty flitnim për veten dhe nuk supozonim se po na dëgjon edhe dikush tjetër, apo po na lexon, apo po e sheh prodhimin tonë shkencor dhe thirrës. Kjo, pa dyshim, është e vërtetë, dhe ju përket disa kategorive tona, të cilat flitnin me veten brenda shtëpive të tyre, duke mos llogaritur se dikush e dëgjon fjalën e tyre, apo i intereson ajo, edhe pse ndoshta fjalimi i tyre ka mundur dikë ta lëndojë, ta ofendojë apo frikësojë, qoftë nga përmbajtja, nga toni apo edhe nga konteksti.

Kam marrë pjesë në një kongres të madh islamik në një shtet mysliman, ku merrnin pjesë rreth 500 njerëz nga e gjithë bota. Një nga pjesëmarrësit u ngrit dhe i befasoi të gjithë të pranishmit me një fjalim, në të cilin doli nga kornizat dhe drejtimi i kongresit, kur tha: “Nuk ekziston diçka që quhet dialog ndërfetar apo afrim midis feve, sepse ekziston vetëm një fe, e ajo është Islami. I Plotfuqishmi thotë: **“Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami.”** (Ali Imran, 19).

As nuk ekzistojnë fe qiellore përveç Islamit. Siç thotë Allahu i Plotfuqishëm: **“E ai që kërkon tjetër fe përveç fesë islame, nuk do t’i pranohet.”** (Ali Imran, 85).

Pranë meje ishte i ulur kryetari i kongresit, të cilit i thash: “Ky referues e bëri një diskutim të rrezikshëm, mund ta dëmtojë imazhin e këtij kongresi dhe drejtimin e tij pozitiv, nëse nuk i përgjigjemi dhe nëse nuk ia hedhim poshtë atë që tha.”

Ai më tha: “Ai këto fjalë po i thotë midis nesh, të cilat nuk e tejkalojnë këtë sallë.” Unë i thashë atij: “Kjo mund t’i refuzohet atij nga dy aspekte:

I pari, këtu askush nuk po flet për veten e tij, apo për një grup i cili do ta kufizojë fjalimin brenda një salle të mbyllur. Këtu ka gazetarë dhe përfaqësues të stacioneve të radios dhe televizioneve, të cilët po transmetojnë çdo gjë që po thuhet këtu në të gjithë botën.

I dyti, ajo që tha ai, në vetvete nuk është e vërtetë, sepse ka edhe fe të tjera përveç fesë islame. I Plotfuqishmi thotë: **“Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!”** (El Kafirun, 6).

Kurse ajetin me të cilin ai argumentoi, mund t’i përgjigje mi me ajetin: **“E, kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame...”** (Ali Imran, 85) (El Kafirun, 6). Dhe ajeti tjetër: **“O ithtarë të librit, mos e teproni në fenë tuaj...”** (El Maide, 77).

Pastaj na urdhërohet dialogu ndërjetar, kur i Plotfuqishmi thotë: **“Dhe, diskuto me ta si është më së bukuri!”** (En Nahl, 125).

Ndoshta ky fjalim i përçmon të tjerët, ose nuk iu kushton vëmendje atyre, ose nuk iu jep rëndësi. Ndoshta është i ngarkuar me zemërim dhe urrejtje ndaj tyre për shkak të qëndrimit të tyre ndaj Islamit dhe çështjeve të ymetit të tij, si dhe qëndrimit të tyre me armiq të tij.

Ndoshta kjo mund të jetë rezultat i njohurive të pamjaftueshme për tjetrin. Arabët në kohët e lashta kanë thënë: “Njeriu është armik i asaj që nuk e di.”

Ndoshta ka qenë kjo, ose ka qenë diçka tjetër, por e gjithë kjo duhet rishikuar në konsiderimin e diskursit tonë fetar, e dëgjua dhe e lexuara, a janë të përshtatshme për kohën tonë apo jo? A mund të realizohet thirrja për tek Allahu me largpamësi? A janë plotësuar kushtet e fjalimit elokuent, i cili

pasqyron pajtimin ndërmjet rrethanave dhe të folurit të bukur?

Nuk është e diskutueshme se diskursi fetar ndryshon sipas shkollës së cilës i takon predikuesi dhe shprehet për të.

Diskursi mistik nuk është diskurs arkeologjik, kurse diskursi i tyre nuk është diskurs i kelamistit. Ai gjithashtu nuk është diskurs i fekihut.

Kurse diskursi i fekihut të përkushtuar me imitim të një medhhebi është diskurs tjetër nga ai i fekihut, i cili është i lirë nga zgjedha e imitimit.

Diskursi i predikuesit që është në kontradiktë me krejt misticizmin, nuk është i njëjtë me diskursin e predikuesit i cili merr nga ai, atë që e konsideron të drejtë dhe e lënë atë që mendon se është e gabuar.

Pastaj, diskursi i predikuesit që kufizohet në trashëgiminë e të parëve, nuk është i njëjtë me diskursin e atij që i ka hapur sytë ndaj kohës së tij, kulturës dhe rrymave.

Diskursi i predikuesit i cili nuk ka dalë nga vendi i tij, nuk është sikurse i atij që ka shëtitur botën, është njohur me njerëzit, fetë, sektet dhe kulturat.

Të gjitha këto janë nga shkaqet e diversitetit të diskursit fetar në përgjithësi, edhe pse fillimisht ato pajtohen që të gjitha rrjedhin nga të vërtetat e Kuranit, nga hadithet autentike të Pejgamberit a.s., nga konsensusi i paraardhësve të ymetit, sepse ky ymet nuk bashkohet në devijim.

Qasja më e mirë optimale është që të bashkohet diskursi i predikimit tonë islam në kombinim midis spiritualitetit të mistikës, kapjes arkeologjike, nacionalitetit të folësit dhe

shkencores së juristit. Ai merr nga të gjitha klasat më të mirën e tyre dhe i përzien ato në përputhje dhe harmoni.

Vetë Kurani është argument për ndryshimin e diskursit

Argumenti më i fortë i ndryshimit të diskursit sipas ndryshimit të rrethanave dhe detyrimeve të tij është vetë Kurani. Ne kemi parë se diskursi i Kuranit mekas (përkatësisht, para Hixhretit në Medine) është i ndryshëm nga diskursi i Kuranit medinas. Kjo është çështje e njohur dhe e determinuar te studiuesit e Kuranit. Këtë e vënë re të gjithë ata që lexojnë Kur'an dhe i njohin suret mekase dhe suret medinase.

Tematikat medinase të Kuranit janë të ndryshme nga ato mekase në përgjithësi, gjithashtu edhe stili i Kuranit medinas ndryshon nga stili i Kuranit mekas në përgjithësi.

Temat mekase të Kuranit sillen kryesisht rreth konsolidimit të besimit në monoteizëm me seksionet e tij të ndryshme, rreth konfirmimit të pejgamberisë, rreth shpërblimit në ahiret, rreth besimit në të padukshmen, rreth thirrjes për vepra të mira, për sjellje të mira, dhe për gjërat që i mbështesin këto nga tregimet e pejgamberëve dhe besimtarëve, si dhe për përgjigje ndaj kundërshtarëve.

Temat medinase të Kuranit sillen rreth krijimit të shoqërisë besimtare dhe legjislacionit për të, andaj nuk janë shpallur në Mekë: **“O ju që keni besuar...”** Në suret medinase gjenden të gjitha ato dispozita për të cilat ka nevojë shoqëria, si në aktet e adhurimit, në transaksione, në legjislacione, ashtu edhe në sanksione.

Edhe stili mekas i Kuranit, gjithashtu në përgjithësi, nuk është si stili medinas i Kuranit. Në stilin mekas dominon intensiteti dhe nxehtësia, toni i shpejtë, përsëritja e disa domosdoshmërive, siç është në suret: Esh Shuara (poetët), El Kamer (hëna), Er Rrahman (i Gjithëmëshirshmi) dhe në suren El Murselat (engiëjt). Ai ju drejtohet zemrave, i ngre ndjenjat, ballafaqon arrogancën dhe ua mbyll gojën oponentëve. Ndryshe nga stili medinas, ky është stil arsimor, legjislativ që qetëson shpirtin, me ton të qetë, ju flet mendjeve së pari, ndonëse nuk mbetet pa iu drejtuar edhe zemrave, sepse tema të tij janë legjislacioni dhe arsimimi.

Sekreti i ndryshimit të diskursit këtu dhe atje është se suret e Kuranit, mekase dhe medinase, marrin parasysh auditorin dhe i flasin me atë që i përshtatet. Kurani mekas ju adresohet së pari politeistëve, të cilët e kundërshtojnë doktrinën e monoteizmit, e refuzojnë pejgamberinë e Muhamedit dhe e kundërshtojnë atë, prandaj në diskurs mbizotëronte gjuha e shqetësimit dhe nxehtësisë.

Ndërsa sa i përket Kuranit medinas, ai i drejtohet komunitetit të ri besimtar, të cilit iu besuan urdhrat dhe ndalimet, me direktivat dhe legjislacionet, andaj në këtë diskurs mbizotëronte gjuha e qetësimit dhe arsimimit.

Së këndejmi, ai që e lexon një sure medinase, si p.sh. suren El Bekare, dhe një sure mekase, si p.sh. suren Esh Shuara, do të vërejë ndryshim të qartë në diskurs ndërmjet dy sureve, si në përmbajtje, ashtu edhe në stil.

Përktheu nga arabishtja:

Miftar Ajdini

Prof. asist. dr. Rexhep SUMA

NEVOJA PËR BESIMIN E QËNDRUESHËM DHE FRIKËN NDAJ ZOTIT NË SFERËN E PREDIKIMIT TË ISLAMIT

Çështja e përgatitjes së anës shpirtërore të predikuesit të vlerave të Islamit është komponentë jetike së pari për vetë predikuesin dhe pastaj edhe për vetë misionin e thirrjes dhe vetëdijesimit të masës (xhematit). Ky tregues po ashtu nuk është më pak i rëndësishëm sesa treguesit e tjerë. Ai rafinon shpirtin, i disiplinon veprimet, e vë nën kontroll gjuhën dhe e bën njeriun t'i shoh gjërat më me maturi. Po ashtu, kjo ndjesi i mundëson besimtarit raporte të forta dhe të dallueshme, duke ia kushtuar jetën dhe vdekjen vetëm Krijuesit: ***“Thuaj: “Namazi im, kurhani im dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve.” (El En'am, 162).***

Për t'u kryer me përpikëri komunikimi i mesazhit të Allahut xh.sh., vetë bartësi i saj duhet të jetë i bindur thellë se ajo është e vërtetë dhe si të tillë do ta shfaqë te të tjerët. Me këtë kuptohet se ta gjithë ofertat e tjera, nuk janë shpëtim për njeriun, sepse në vete përmbajnë devijim dhe shtrembërim të fjalës së përbashkët. Allahu i Lartësuar në Kuran tho-

të: ***“Thuaj: “Unë i përmbahem të vërtetës (që më erdhi) nga Zoti im. Ju e gënjet atë, e për atë që nguteni ju (dënimin), nuk e bëj unë, vendimi i takon vetëm Allahut; Ai e rrëfen të vërtetën dhe Ai është më i miri i gjykatësve.” (El En’am, 57).***

Kurani, në lidhje me besimin e thellë dhe të palëkundur në këtë çështje, na ka ofruar shembuj të shumtë në ajetet kur-anore, siç është rasti me premtimin ndaj Ibrahimit a.s., i cili nuk u gjunjëzua dhe dorëzua para mbretit Nemrud, i cili kishte pushtet të jashtëzakonshëm, Musait, i cili nuk iu frikësua Faraonit, tregimi i *Ashabul-uhdud* (të zotët e hendeqeve), të cilët u vranë në mënyrën më makabre, duke u hedhur në hendek të mbushur me zjarr, nuk u trembën, por qëndruan të palëkundur në imanin e tyre.¹ Muhamedi a.s. na ka paralajmëruar se këso rastesh do të ndodhin edhe gjatë shekujve dhe viteve të ardhme.

Ebu Seid el Hudriu r.a. transmeton se: “I Dërguari i Allahut na rrëfeu një hadith të gjatë për Dexhallin dhe, në mes tjerash, tha: *“Dexhalli do të vije deri afër disa zonave të shkreta rreth Medinës, porse do ta ketë të ndaluar të hyjë brenda saj. Atë ditë do t'i dalë një njeri, që do të llogaritet si njeriu më i mirë, - ose ka thënë: ndër njerëzit më të mirët, - dhe do t'i thotë: “Dëshmoj se ti je Dexhalli, për të cilin na ka treguar i Dërguari i Allahut. Dexhalli u thotë (ihtarëve të tij): “Nëse e vras këtë, e pastaj e ringjall, a do të kenë dyshim në çështjen (vërtetësinë) time?” - Jo, - i thonë ata. Kështu, e vret atë, e më pas e ringjall. Kur njeriu në fjalë ringjallet, i*

¹ Muhamed Hadad, “*Ed-davetu ve-l-islam menahixhu ve esalibu*”, Daru-l-kalem”, botim i 4, Damask, 2014, f.143.

*thotë: “Betohem në Allahun se asnjëherë nuk kam qenë më i bindur se sot (se ti je Dexhalli).” Dexhalli thotë: “Dua ta vras atë, por nuk mundem.”*²

Kjo ngjarje reflekton se ai djalë besimtar, në kohën e fundit që do të ndodh, ka një besim të palëkundur në mesazhin e Muhamedit a.s., derisa forca e Dexhallit nuk e tremb atë. Edhe predikuesi, në këtë rast, duhet të kujtojë këto raste të regjistruara në tekstet fetare dhe të mendon se me iman të fortë dhe të palëkundur e fiton Ahiretin.

Lënia pas dore e edukimit të rinjve me frikën ndaj Zotit, ka sjellë fenomene të tilla, si vrasja, madje edhe në muajt e shenjtë e në shtëpinë e shenjtë të Allahut, dhe atyre u duket sikur janë në udhë të mbarë! Ka ndodhur që nga këta njerëz që nuk druhen nga Zoti, të shohim veprime të tilla si, ndarje nga prindërit, cenim i dinjitetit të dijetarëve, marrja nëpër gojë e nderit të vëllezërve të tyre, ku ka pasur raste që u kanë marrë edhe jetën, përdhosje e shenjtërisë së xhamive etj.. Të gjitha këto me pretendimin se urdhërojnë për të mirë dhe po ndalojnë nga e keqja, se kundërshtarët e tyre janë bidatçinj apo se kanë menhexh (metodologji) të gabuar, e të tjera pretendime si këto, me të cilat kanë sjellë turbullira dhe telashe të shumta. Për shkak të kësaj mangësie, këta njerëz janë shndërruar në egërsira grabitqare, që çjerrin nderin, zhvatin pasurinë dhe derdhin gjakun e njerëzve.

Në një kohë që Allahu na urdhëron t’u bëjmë thirrje njerëzve, i sheh disa thirrës që kërkojnë llogari, shpallin vërtitke

² Buhariu, 1882, Muslimi 7375.

për t'u zbatuar ndaj tyre, madje disa kanë marrë pozitën e Zotit në këto vendime, duke përcaktuar se kush do të hyjë në Xhenet dhe kush në Xhehenem. Allahu urdhëron që njerëzit të ftohen me mirësi e butësi, duke këshilluar për t'u mbuluar gjynahet, ndërkohë që ata u nxjerrin njerëzve të lara dhe të palara, përhapin mes tyre gjynahet dhe gabimet.

Por, prej këtyre të rinjve ka nga ata që japin fetva (gjykimet fetare) në çështje të tilla, që edhe dijetarëve të mëdhenj po t'u viheshin përpara, por edhe sahabëve, do të ishin tërhequr. Pra, këta njerëz japin fetva për probleme, para të cilave janë stepur kolosët e dijes, ndërkohë që për ta janë gjëra të thjeshta, madje me ata që nuk nxjerrin fetva për të tilla raste, këta të rinj tallen me ta dhe dijen e tyre.

Nëse të habisin këto gjëra, habitu më mirë me atë që bënin havarixhët, kur nuk guxonin të merrnin për të ngrënë një hurmë që kishte rënë në tokë dhe guxuan të vrisnin shokun e Profetit, Abdullah bin Habab dhe gruan e tij shtatzënë!³ Por jo vetëm kaq, kërkonin të merrnin shpërblimin e Allahut duke vrarë njeriun më të mirë në sipërfaqen e tokës në atë kohë, prijësin e besimtarëve, Aliun, të birin e Ebu Talibit (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Kur një prej havarixhve donte të godiste Ebu Ejubin, ai i tha: "O armik i Allahut, të përgëzoj se do të hysh në zjarr!" Dhe havarixhi i tha: "Do ta marrësh vesh se cili prej nesh do të hyjë në të i pari." Shiko çfarë kryeneçësie kishin këta njerëz ndaj sahabëve. E gjitha kjo sepse u mungonte droja nga Allahu xh.sh.. Këtu ia vlen të përme-

³ Ahmed Ali ibën Haxher el Askalani, "*El Isabetu fi temjijzi-s-sahabe*", Darul-kutub el ilmije, Bejrut, 1995, v.6, f. 64.

ndim një rregull që thotë: “Nëse gjykon të tjerët, edhe ti do të gjykohesh, dhe nëse ruhesh nga Zoti, do të shpëtosh.” Pra, nëse i gjykon njerëzit, do të pyetesh për këtë gjykim dhe do të gjykohesh para Zotit tënd. Nëse ruhesh duke mos dhënë gjykime për njerëzit dhe duke mos folur për nderin e tyre, Allahu do ta shlyejë ngarkesën e mbartjes së llogarisë dhe gjykimit të tyre. Ka një ndryshim të madh mes atij që do të merret në gjykim dhe atij që falet nga kjo gjë.⁴

Imani i plotë, e para dhe më e rëndësishmja, dhe ne besojmë në Allahun e Lartëmadhërishëm, se Ai është Krijuesi i gjithësisë dhe Sunduesi i tij, është i Vetmi që meriton të adhurohet me të vërtetë, i cilësuar me atributet më të përsosura të madhështisë, përsosurisë dhe bukurisë, i pastër nga çdo e metë, e duam Atë, besojmë se është Një, i Vetëm, e madhërojmë, i frikësohemi, shpresojmë tek Ai. I thërrasim të gjithë myslimanët, e në veçanti thirrësit, që çështjes së akides t'i kushtojmë vëmendje të posaçme, në kuptim dhe besim, ndjenjë dhe sjellje, të jetë parësorja absolute ndaj çdo gjë tjetër, është baza e parë dhe më madhore e të gjitha çështjeve të fesë, bazike dhe sekondare. Tevhidi është baza e cila i shoqëron në vazhdimësi çështjet e tjera, siç e shoqëron myslimanin në çdo gjë në jetë. Akideja nuk është kapitull i një libri që e lexojmë, që pastaj ta mbyllim atë dhe të kalojmë në tjetrin. Akideja për myslimanin paraqet kapitullin e parë që e lexon, që pastaj të vazhdojë me atë t'i lexojë edhe kapitujt e tjerë.

⁴ Adnan al Araur, “*Menhexhu eddaveti fi dav'til kitab ve essune*, Xhaizetu-l-Naif bin Abdulaziz Al Saud el alemije lis-s-uneti en-n-ebevijje, ved-d-irasat el islamije el muasire, Riad, 2005, f. 68.

Akideja është gjendje mendore, shpirtërore dhe praktike, që e shoqëron myslimanin dhe që e qeverisë jetën e tij deri në vdekje. Mes gjërave të tjera të kërkuara, kjo kërkon, që myslimani të pajiset me njohje të thellë, të saktë dhe gjithëpërfshirëse, me të gjitha gjërat e duhura lidhur me akiden, ndër më të rëndësishmet: tevhidin e Allahut të Madhërishëm, adhurimin e denjë të Tij, të Vetmin, të njohë dispozitat e Tij, siç kërkon që ky të njoh gjërat që dëmtojnë akiden në fjalë, e që e bëjnë të dalë nga feja, tërësisht ose pjesërisht. Është për t'u çuditur, edhe atë shumë bile, që fëmijët e myslimanëve në këtë botë të dinë për gjërat që e prishin abdesin, e të mos dinë për gjërat që prishin akiden. Është e vërtetë se të dyja paraqesin rëndësinë, por mes tyre është një dallim i madh. Në anën tjetër, duhet të kemi kujdes që çështja e akides të mos shndërrohet në mësim përmendsh e i thatë, që të zotët e saj të pretendojnë se vetëm ata janë në udhëzim, që të përhapet në mesin e tyre vetëmashttrimi dhe superioriteti, që me të tjerët të sillen me ashpërsi dhe mendjemadhësi. Besimi në qëndrimin e tyre të vërtetë është i lavdëruar dhe i kërkuar, por duhet që të shoqërohet me ndjenjën e bukur e të butë ndaj të tjerëve. Vetëm kështu do të jenë thirrës të dashur, mëshirues e të respektuar, e jo neveritës e të ashpër. Qëllimi është që tevhidi në jetën e tyre të prezantohet në formën më të bukur, me mençuri, ndërgjegje dhe sjellje.⁵

1. Andaj të gjithë predikuesit e fushës së thirrjes islame dhe ata që merren me studimin e shkencës së besimit –

⁵ Hisham Talib, "*Besëlidhja e thirrjes islame*", Logos-A, Shkup, 2017, f.25-26.

akaidit, duhet të kenë parasysh gjërat në vijim: që Libri i Allahut dhe Suneti i vërtetë, i cili e sqaron, të jenë burim i besimit të dëshiruar dhe të pritur, larg prej kalbësirave, shtesave dhe tepricave që i janë shtuar gjatë historisë, ashtu që akideja të jetë e pastër, e qartë dhe e thjeshtë. Gjithashtu, nuk guxojmë të marrim mendimet e ndonjë shkolle të caktuar si bazë, sipas të cilave do të harmonizonim Kuranin dhe do të tërhiqim ajetet për t'i përkrahur të njëjtat.

2. Të pasojmë metodat e Kuranit në drejtimin e mendjes dhe zemrës bashkërisht, me qëllim të formësimit të imanit të drejtë. Ndërtimi i besimit vetëm me mendje, siç është drejtimi filozofik, apo vetëm me zemër, siç është tesavufi, nuk pajtohet me universalitetin e metodës islame, ku imani mbështetet në bindjen e mendjes, aktivizimin e zemrës dhe vërtetësinë e vullnetit.
3. T'i kushtohet kujdes argumenteve kuranore të cilat i ka përmendur Kurani për argumentimin e besimeve të veta, për bindjen e atyre të cilët i thërret, me të cilat iu përgjigj armiqve të vet dhe me të cilat i përgënjeshtroi dyshimet dhe gënjeshttrat e tyre të cilat ata i lansojnë, si p.sh. argumentet kuranore për ekzistencën e Allahut, për të cilat kanë treguar Ibën Rushdi në veprën "*Me-nahixhul-Edil-le*", Akadi në veprën "*Allahu*", Xhisri në veprën "*Kissatu-l- iman*" etj.. Gjithashtu, duhet pasur kujdes për argumentet kuranore mbi Njeshmërinë e Allahut, mbi ringjalljen, mbi pejgamberinë e Muhamedit a.s.. Krejt këto janë argumente të qarta dhe racionale, e nuk janë oratorike siç kanë menduar disa

skolastike (Skolastika është filozofi idealiste e Mesjetës, që merrej me shpjegimin dhe argumentimin e dogmave të kishës me anë të arsyetimeve abstrakte të logjikes formale).

4. T'i kushtohet kujdes problemeve bashkëkohore racionale dhe marrjes me çështjet e mëdha të akides siç janë: ekzistenca e Allahu të Lartësuar, Njeshmëria e Tij, pejgamberia, Ahireti, përcaktimi i Allahut. Megjithatë, sa u përket problemeve historike siç janë: krijimi i Kuranit, cilësitë e Allahut dhe raporti i tyre me Qenien e Tij, a janë ato vetëm Qenie apo diçka tjetër, apo nuk janë as njëra e as tjetra etj., këto duhen studiuar si histori e mendimit islam, dhe mos të harxhojmë në to kohën dhe mundin që na nevojitet për zgjidhjen e problemeve të kohës tonë.
5. Duhet të shfrytëzohet shkenca bashkëkohore, sidomos ato që kanë të bëjnë me lëmin e shkencave natyrore, siç janë: astronomia, mjekësia, fizika etj., ashtu që me to të argumentojmë dhe vërtetojmë çështjet e besimit, sikur që bënë shumë hulumtues të kohës sonë, të huaj dhe myslimanë, siç janë autori i veprës *“El-Ilm ilel-iman”*, autorët e veprës *“Allahu jetexhel-la fi asril-ilmi”*, autori i veprës *“Kissasul- iman”*, si dhe autori i veprës *“Allah vel-ilmul-hadith”* dhe *“El- Islam jete-hadda”* dhe shumë vepra të tjera.
6. Të pranojmë mënyrën e paraardhësve tanë gjatë prezantimit të Allahut të Lartësuar, ashtu si e ka përshkruar Ai Vetën, pa formësim, ngjashmëri, devijim dhe mohim. Është kjo mënyrë që e pranuan viganët e kësaj

shkence, prej Eshariut dhe të tjerët, sikur Ebu Hasan Eshariu në veprën e tij *“El-Ibane”*, Gazaliu në veprën e tij *“Ilxhamul-avani an ilmil-kelami”*, Fahrudin Raziu në veprën e tij *“Ahkamudh-dhati”* ku thotë: “Studiova metodën filozofike, si dhe atë skolastike, por nuk gjeta që të shërojnë të sëmurin, e as t’i japin ujë të eturit. Gjeta metodën më të mirë, metodën e Kuranit. Për vërtetim lexo ajetin: **“Mëshiruesi që qëndron mbi Arsh.”** (Ta Ha, 5); Për mohim lexo këtë ajet: **“Asnjë send nuk është si Ai...”** (Esh Shura, 11) dhe kush e shijon përvojën time, do të arrijë deri te përfundimi im.”

7. Duhet që çdo dyshim të orientalistëve, misionarëve krishtere, komunistëve dhe armiqve të tjerë të Islamit t’u përgjigjemi me përgjigjeje ideore-shkencore të formuluar me gjuhë bashkëkohore.⁶

Predikuesit e Islamit (imamët) duhet të tregojnë zgjuarsiri dhe të kenë kujdes për vetveten së pari, e pastaj edhe për masën (xhematin) nga gabimet dhe devijimet, qoftë në ide (mendime) e edhe në sjellje të përditshme në raport me masën. Bota moderne nuk çan kokë për Ahiretin dhe nuk përgatitet për këtë Ditë të Madhe të Llogarisë së vështirë. Ajo është e preokupuar vetëm me tokësoren, ajo mbetet e lidhur ngushtë me të mirat dhe pasuritë e saj. Fjalët, që ndoshta ndonjëherë i dëgjon për jetën e përjetshme, nuk e tërheqin vëmendjen e saj. Ndodh që ajo shumë shpejtë t’i harrojë e t’i

⁶ Jusuf Kardavi, *“Thekafetud-d-aije, Muesesetur-r-isale”*, botim i 11, Bejrut, 1987, f.93.

kthehet përpjekjeve të jetës, të mirave të saj kalimtare dhe shpërblimit të shpejtë. Të gjithë të dërguarit pohuan se jeta e kësaj bote është parathënie e shkurtër e librit të gjatë, se njerëzit të cilët në këtë botë rrojnë me ligjin e kohës, do të përcillen në jetën tjetër ku nuk vlen ligji i kohës, njësoj si kur humbet pesha në jetën e astronautëve sot. Ahireti nënkupton përjetshmërinë e pafundmë. Njerëzit duhet ta përgatisin veten me pastërti dhe ngritje, që të jenë të denjë ta meritojnë këtë jetë të re të përjetshme. Është për t'u çuditur nga fakti se Dhiata e Vjetër nuk e përmend fare takimin me Allahun e as përshekrimin e Xhenetit dhe Xhehenemit, madje as përgatitjen për atë jetë të përjetshme e të vërtetë.

Kjo shkujdesje e shëmtuar për një të vërtetë që asnjë shpallje nuk e la pa e përmendur, llogaritet ndër format më të këqija të devijimit që i ndodhi Tevratit. Ne, myslimanët, pohojmë se faqet e mbrojtura të Kuranit janë ato të cilat na njoftojnë me misionin e Musait, pra, jo shkrimet që iu nënshtuan epsheve të ndryshme, që i lejuan vetës ta shënojnë atë që duan dhe ta heqin atë që nuk e duan. Përshekrimin e misionit të Musait e gjejmë në këto rreshta të Kuranit: ***“E kur shkoj tek Ai (zjarri), u thirr: O Musa! Vërtet Unë jam Zoti yt, hiq atë që ke mbathur (opinga e nalle), se je në luginën e shenjtë Tuva. Unë të zgjodha ty (për peygamber), prandaj dëgjo mirë se ç’po të shpallet! Vërtet, vetëm Unë jam Allahu, nuk ka zot tjetër pos Meje, pra Mua më adhuro dhe fal namazin për të më kujtuar Mua. S’ka dyshim se momenti (kiameti) do të vijë patjetër. Unë gati e kam fshehtë atë; (do të vijë) për t’u shpërblyer secili njeri për atë që ka bërë. Prandaj, të mos shmang ty nga***

kjo, ai që nuk i beson atij dhe që është dhënë pas dëshirave, se atëherë shkatërroresh.” (Ta Ha, 11-16).

Çfarë pasojash solli ky shtrembërim? Izraelitët (Beni Israilët) u bënë shpërfillësit me të mëdhenj të Ditës së Gjykimit, pengues të besimit në të dhe duke pasur parasysh se i zunë postet më të rëndësishme në qendrat e informimit dhe orientimit në botë, u bënë thirrës për adhurim të trupit dhe të jetës së dynjasë. Ata nuk çanë kokë që ta përmendin Allahun në çështje serioze, e as t’ua rikujtojnë të tjerëve takimin me të, ditën e natën. Ngjashëm vepruan edhe ithtarët e feve pagane, të cilët i djegin kufomat e të vdekurve, ndërsa pluhurin e hedhin në ajër, e pastaj harrojnë se kush ishte dhe çfarë ishte ai. Këtyre u përngjajnë ateistët e Lindjes komuniste dhe shekullarët e Perëndimit, të cilët vetëm emri i lidh me disa doktrina fetare, ndërsa sytë e tyre kurrë nuk e kanë parë qiejllin. Besimi në ringjalljen dhe llogarinë është vazhdimësi e besimit në Allahun Një. Dëshira e madhe e përhapur në kohën moderne për të mos e kujtuar Ditën e Gjykimit, i kthehet lëkundjes së këtij besimi ose zbrazjes së zemrave nga ky besim. Islami e vë në spikamë lidhshmërinë e sjelljeve të përditshme me besimin, i cili Ditën e Gjykimit e bën plotësim të jetës në këtë botë. Ndodh që ti ta harxhosh pasurinë që e ke për shkak se dëshiron të njihesh si dhënë, por ndodh ta harxhosh atë për përmbushjen e nevojave të të varfërve, siç ndodh që nga harxhimi i saj të përfitosh sa më shumë pasues ose ta harxhosh për t’i shlyer borxhet që i ke. Mirëpo, Kurani famëlartë na e tërheq vëmendjen për një shkak tjetër të harxhimit të pasurisë, që është i pranuar tek Allahu i Madhërishëm: ***“Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve,***

jetimëve dhe të zënëve robër. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimit) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë vështirë. Po Allahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh.” (El Insan, 8-11).

Ndodh të kërkoksh post të veçantë, si plotësim për autoritetin tënd shoqëror ose ndoshta e kërkon, sepse sipas mendimit tënd, e meriton të jesh prijës ose udhëheqës, por ndodh ta kërkoksh postin për shkak se të tjerët të kanë propozuar për atë post, siç ndodh ta kërkoksh për shkak të përfitimeve të ndryshme dhe pasurive të shumta që i sjell. Këto shkaqe janë krejt ndryshe nga shkaqet e tjera që e vënë në spikamë kërkimin e postit për ta bërë të vërtetën ngadhënjyese dhe për ta zhdukur të pavërtetën, për ta ngritur lart fjalën e Allahut dhe për ta vendosur drejtësinë mes robërve të Tij. S’ka dyshim se udhëheqësi në këtë rast është sikur imami në namaz, që u prinë njerëzve, ndërsa puna e tij llogaritet ibadet, sikur puna e imamit e cila bëhet për hir të Allahut. Janë shumë shkaqe psikologjike, të cilat veprojnë pas marrjes së guximit për vetëveprim dhe heqjes dorë nga ai, pas aktivitetit dhe flakjes së tij, pas heshtjes dhe bisedës dhe pas kënaqësisë dhe zemërimit. Puna nuk ka peshë nëse pas saj nuk qëndron besimi i vërtetë. Allahu i Madhërishëm në librin e Tij fisnik thotë: ***“Kush ka për qëllim jetën e kësaj bote dhe të mirat e saj, Ne do t’u plotësojmë atyre shpërblimin e veprave të tyre në të, dhe atyre në të, dhe atyre nuk do t’u mungojë gjë. Të këtillëve në botën tjetër u përket vetëm Xhehenemi. Ajo që punuan dhe vepuruan ata ka dështuar dhe është asgjësuar.” (Hud, 15-16).***

Civilizimi modern është civilizim tokësor dhe njerëzor, që beson se asgjë nuk ka zbritur nga qielli, se vetëm njeriu është zotëri i kësaj gjithësie, se e tashmja është ajo që duhet dhe meriton të shijohet, se vdekja është gjë e dhembshme, por çfarë të bëjmë? Ta shfrytëzojmë atë që është para vdekjes, e të mos çajmë kokë për atë që është pas saj. Ajo që është pas saj, nuk na intereson fare. Ne nuk mendojmë se ekziston një ndikim i vogël i feve të cilin ende disa e trashëgojnë. Mirëpo, cila është dobia e këtij ndikimi? Ky ndikim i përngjan tymit të disa fabrikave që e ndryshojnë arin, por erërat vijnë me shpejtësi dhe e shpartallojnë atë. Unë një kohë të gjatë e kam kaluar me pleq e të rinj, mësues e nxënës, udhëheqës e njerëz, ushtarë e civilë dhe nuk me ka rënë të dëgjoj - pos disa herë - që ata të flasin për takimin me Allahun dhe për jetën në botën e ardhme. Njerëzit janë të burgosur brenda interesave të tyre personale dhe nuk duan që të dalin prej aty ku janë e ta shohin jetën e ardhme. Këta i refuzojnë ngushëllimet që u vijnë nga të tjerët që ua duan shpëtimin dhe që duan t'ua lehtësojnë dhembjet dhe vuajtjet. Si është e mundur që njerëzit të mendojnë se nuk është gjë e keqe nëse nëpunësi e shtrin dorën për të marrë ryshfet që ta kënaqë vetveten, ndërsa për atë që tregohet i ndershëm dhe i përmbajtur për hir të Allahut, duke shpresuar në shpërblimin e Tij dhe duke e kryer punën me nder, të mendojnë se është i marrë. Analogjia e tillë ka të bëjë edhe me pasuritë e njerëzve, gjakun dhe nderin e tyre. Sot ka shumë që e shtrijnë dorën e tyre në pasurinë, gjakun dhe nderin e njerëzve. Ato nuk i pengon kujtimi i Xhenetit dhe i Xhehenemit. Sikur Xheneti dhe Xhehenemi

janë fjalë të prapambetëse që kanë të bëjnë me njerëz të prapambetur.⁷

Në përmbyllje, vlerësojmë se qëndrimi i palëkundur në lidhjen me Krijuesin tonë, mbetet një ujë i pashterur që secili mysliman ka nevojë për të, e veçanërisht predikuesit e mesazhit hyjnor. Ajo mbetet forcë dhe mbështetje kur burimet e tjera ndërpriten. Andaj predikuesi e ruan këtë lidhje duke reflektuar dhe duke qenë model i mirë për qëndrueshmëri e cila, është mjeti më me ndikim, me anë të cilit i fton njerëzit në besim në një Zot dhe përkushtim në vepra të mira.

⁷ Muhamed el Gazali, *“Pesë temat e arta të Kur’anit Famëlartë”*, Logos-A, Shkup, 2009, f.133-134.

Dr. Sadik MEHMETI

MEKTEBI I TAHIR EFENDI LLUKËS - vatër e kultivimit të dashurisë për gjuhën shqipe -

Dihet mirëfilli se në Perandorinë Osmane, pra edhe te ne, arsimi fillor i myslimanëve kryhej në mektebe (mejtepe), të cilat, për dallim nga shkollat e tjera të kësaj kohe, - siç ishin medresetë, pastaj gjimnazet e ulëta e të larta (rushdije dhe idâdije) dhe shkollat e larta pedagogjike (dâru muallimîn), - ishin shumë të përhapur dhe me numër më të madh. Këso nivele shkollash, pra mektebe, ka pasur gjithandej qyteteve tona, por edhe nëpër fshatra.

Të dhënat që ka sot në dispozicion shkenca e historisë, konfirmojnë se mektebi më i vjetër, *i ndërtuar si objekt i veçantë arkitektonik* që është dokumentuar deri tash ndër shqiptarët, është ai i Sinanudin Jusuf Çelebiut, i ngritur në Ohër, para vitit 1491, porse si mektebe në ose pranë xhamisë kanë ekzistuar shumë më herët.¹ Ndërsa ndër mektebet më të vjet-

¹ Që para viti 1411, në Shkup ka vepruar *Medreseja e Is'hak Beut*, që është niveli më i lartë i shkollave dhe të cilën e kanë ndjekur nxënësit pasi të kenë përfunduar mektebin. Përndryshe, *Medreseja e Is'hak Beut* në Shkup është medreseja më e vjetër e ngritur në trojet shqiptare.

ra në Kosovë, është mektebi i Suzi Çelebiut nga Prizreni, i ngritur pranë xhamisë së tij në Prizren para vitit 1513, pastaj mektebi i Kuklibegut në Opojë, i ngritur para vitit 1538 etj.²

Mirëpo, meqë nuk kishte ndonjë strukturë a rregull për hapjen e këtyre shkollave dhe se qeveria nuk përzihej në punën e tyre, është e vështirë të përcaktohet edhe numri i saktë i këtyre shkollave që kanë vepruar te ne. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se në mjediset myslimane, numri i xhamive ishte i madh, atëherë mund të përfundohet se numrit të xhamive përfaqësojnë i përgjigjej edhe numri i mektebeve, sado që në disa shekuj më vonë dhe sidomos pas gjysmës së dytë të shek. XIX, kanë ekzistuar ndryshime gjithnjë më të mëdha, ku krahas shkollave fillore klasike islame (mektebeve sibjân), hapen edhe shkolla fillore moderne publike (mektebet iptidâije), ku këto të fundit kishin planprogram më të zgjeruar dhe ishin më të organizuara.

Sidoqoftë, në mjediset myslimane, arsimi i fëmijëve myslimanë fillonte që në moshën e re, me dërgimin e tyre në mekteb apo te hoxha. Kuadrin mësimor në mekteb e përbënte mësuesi (*muallimi*), e në mungesë të tyre këtë e bënte imami i xhamisë së mektebit përkatës.

Arsyeja thelbësore e këtyre shkollave ishte, të mësonte fëmijët të shkruanin dhe të lexonin dhe t'ua mësonin atyre bazat e fesë islame dhe Kuranin. Si rezultat i kësaj u bënë përpjekje për t'ua mësuar fëmijëve alfabetin, Kuranin, t'u

² Shih: Hasan Kaleši, *Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku*, Prishtinë, 1972, f. 115); Hasan Kaleši-Ismail Redžep, *Prizrenac Kuklibeg i njegove zadužbine*, "Prilozi za orijentalnu filologiju", VII-IX/1958, Sarajevë, 1960.

mësojnë fëmijëve përmendsh disa sure (kaptina) të Kuranit fisnik, mënyrën e recitimit të Kuranit, t'u mësojnë bazat e fesë, bukurshkrimin dhe t'u mësojnë katër veprimet kryesore aritmetike (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin).³ Në disa mektebe është mësuar më shumë dhe kjo vërehet sidomos në mektebet ibtidâije, ku përmbajtja e mësimave kishte ndryshuar, sepse, - krahas lëndëve fetare, - në këto shkolla të reformuara mësoheshin edhe gjeografia, historia e Perandorisë Osmane, leximi, shkrimi, matematika, etika, njohuri natyre e, të shumtën, edhe vizatimi e gjimnastika.⁴

Edhe pse kishte këndvështrime të ndryshme në lidhje me gjuhën e mësimdhënies në këto shkolla fillore, në përgjithësi pranohej të përdorej gjuha amtare e nxënësit,⁵ sepse fëmijët jo turq dhe jo arabë kishin vështirësi në kuptimin e teksteve në gjuhën arabe ose turke dhe as që kanë ditur të gjendeshin në tekstet e vështira në këto gjuhë.⁶ Shumë gjatë është mësuar me tekste të shkruara me dorë. Më vonë paraqiten tekstet e para të botuara të njohura si “supare” ose “sufare”, nga të cilat një kohë të gjatë kanë mësuar fëmijët.

Kah fundi i qeverisjes osmane është punuar që tekstet për lëndët botore, por edhe për ato fetare, për shqiptarët të shty-

³ Më gjerësisht për mektebet dhe nivelet e shkollave të tjera gjatë periudhës osmane, shih: Sadik Mehmeti, *Shkollat dhe arsimi në Kosovë (1830-1912)*, botoi: Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019.

⁴ Hajrudin Ćurić, *Muslimansko školstvo u Bosni i Hercegovini do 1918*. Godine, Sarajevë, 1983, f. 40.

⁵ Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet studimore-shkencore dhe arsimore osmane*, në: Historia e Shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman, vëll. II, AHTC, Tiranë, 2009, f. 376.

⁶ Hajrudin Ćurić, *Muslimansko školstvo...*, po aty, f. 40.

peshin në gjuhën shqipe me shkronja arabe dhe sidomos numri i tyre u shtua pas revolucionit të xhonturqve, të cilët ishin pro gjuhës shqipe me shkronja arabe dhe kundër shkrimin të gjuhës shqipe me shkronja latine.

Për sa i takon strukturës së nxënësve në mektebe, këto shkolla kanë qenë: *të djemve*, *të vajzave* dhe *të përziera*. Mektebet klasike të ne në Kosovë, por edhe në trojet e tjera shqiptare, në të shumtën, kanë vepruar falë angazhimit dhe iniciativave private. Disa prej tyre i kanë themeluar vakëflënës dhe bamirës të ndryshëm dhe jo vetëm që i kanë themeluar ato, por kanë lënë edhe vakëfe të bollshme për mbajtjen dhe mbarëvajtjen e tyre. Kurse disa mektebe të tjera i kanë mbajtur vetë qytetarët me kontributet e tyre. Falë këtyre bamirësve të mëdhenj dhe kontributeve të qytetarëve, ky lloj i shkollave në vendin tonë ka njohur një shtrirje të madhe dhe ka zgjatur deri me largimin e Perandorisë Osmane, e madje edhe më vonë dhe, në një formë, vazhdojnë edhe sot.

Duhet thënë se pikërisht ishin mektebet pranë xhamive, vendet të cilët sidomos në vitet pas Lidhjes së Prizrenit, u bënë vatra të kultivimit të shkrimit shqip me shkronja arabe dhe të kultivimit të ndjenjës kombëtare,⁷ siç ishin mektebi i Tahir efendi Gjakovës, mektebi i Sheh Jonuz efendiut nga Mitrovica, mektebi i Tahir efendi Popovës së Vushtrrisë, mektebi i Hilmi Abdylmaliq efendiut të Rahovecit, mektebi i Tahir efendi Llukës së Deçanit (për të cilin këtu bëhet fjalë), e shumë të tjerë.

⁷ Muhamet Pirraku, *Gjurmë të veprimtarisë letrare shqipe me alfabet arab në Kosovë*, "Gjurmime albanologjike", SSHF, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1980, f. 204.

Mektebi i Tahir efendi Llukës në Llukën e Epërme të Deçanit

Një ndër mektebet që ka luajtur një rol me rëndësi në kultivimin e dashurisë ndaj gjuhës shqipe dhe për ruajtjen e saj ishte *mektebi i Tahir Efendi Llukës, në Llukën e Epërme të Deçanit*, që ishte hapur në vitin 1889, e që konsiderohet si një ndër shkollat e para shqipe në Kosovë.

Mësuesi i këtij mektebi ishte patrioti, atdhetari dhe intelektual i shquar, Tahir efendi Lluka, i lindur, sikurse e dëshmon dhe mbiemri i tij, në fshatin Llukë e Epërme të Deçanit, midis viteve 1830-1845. Për Tahir efendiu dihet se pasi i kreu studimet në Stamboll u emërua profesor në shkollën e lartë “Fatih” të Stambollit. Kontaktet e tij me rilindësit e shquar shqiptarë që vepronin në Stamboll, si me Hasan Tahsinin, Jani Vreton etj., bënë që pas vitit 1874, kur Hoxhë Tahsini u largua nga Universiteti i Stambollit, edhe Tahir Lluka të humbte punën në “Fatih”. Sipas disa të dhënave, pas vitit 1881, Tahir efendiu, kthehet në vendlindje dhe vazhdoi aktivitetin në jetën kulturore e arsimore. Kjo ishte periudha kur ai shkroi disa vepra shqip me alfabet arab dhe kur hapi mektebin, ndër të parët, ku jo vetëm ligjërimi, por edhe mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe. Është autori i tri veprave në gjuhën shqipe me shkrimin arab: “Akâidu ‘l-Islâm” (Shkenca e besimit islam), “Risâle-i ahlâk” (Broshurë mbi moralin) dhe “Risâle-i hifziye” (Urata e besimtarit).⁸ Veprimtaria arsimore në gjuhën shqipe e Tahir efendi Llukës, u bë halë në sy të

⁸ Këto vepra ruhen në Arkivin e Kosovës, Fondi: Jusuf Lata, nr. 191/2.

organeve të pushtetit osman. Shkoi në Stamboll dhe nuk u kthye më në vendlindje, nuk dihet për fatin e tij. Mendohet se ka vdekur më 1908, pa u ditur rrethanat e vdekjes.⁹

Mësuesi Tahir efendi Lluka, në mektebin e tij, krahas vetes, si mësimdhënës kishte angazhuar edhe një mësues/një hoxhë nga Carrabregu, i cili merrte pagë mujore. Në këtë shkollë fillore mësohej shqip, sikurse u tha, me shkrimin arab. Për mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e punës së shkollës, Tahir Lluka, kishte hapur një dyqan në një dhomë të mektebit. Të dhëna të shkruara për mektebin në Llukën e Epërme, kemi pikërisht nga vetë Tahir efendiu, i cili për nevojat e këtij mektebi kishte hartuar tekstet e sipërpërmendura në gjuhën shqipe me shkrimin arab, por duke bërë disa kombinime të grafemave dhe duke u shtuar shenja diakritike që të mund të shënonte të gjitha veçoritë tingullore të gjuhës shqipe.¹⁰ Ky alfabet i njohur si alfabeti i “Tahir ef. Llukës”, i hartuar më 1878, u përdor në mektebin e tij dhe edhe më gjerë.¹¹

Kështu në libërthin e tij “*Risâle-i Ahlâk*” (“Broshurë mbi moralin”), Tahir efendiu na njofton për angazhimin e tij që fëmijët të mund të mësonin shqip:

⁹ Më gjerësisht: Abdullah Hamiti, *Angazhimi i Tahir Llukës për arsimin kombëtar shqiptar*, në: “Feja, tradita dhe kultura islame ndër shqiptarët” (simpozium ndërkombëtar), botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës, Prishtinë, 1995, f. 388; I njëjti, *Mektepi i Tahir Llukës-shkolla e parë shqipe në Kosovë*, në revistën: “Dituria Islame”, nr. 222, Prishtinë, 2009, f. 30-31; Muhamet Pirraku, *Kultura Kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, IAP, Prishtinë 1989, f. 393-395.

¹⁰ Abdullah Hamiti, *Angazhimi i Tahir Llukës...*, po aty, f. 388.

¹¹ Muhamet Pirraku, *Kultura Kombëtare Shqiptare...*, po aty, f. 395.

*“Kur dot knojn kta voxhli nëpër Shqipni
merrni vesh ju gjith Shqipni jav marova temel t’ri
ky mas pari permu knue n’katund tem me shum oda,
krejt çaxhir me çereç djem e çika
per me knue ket temel t’ri
me guha t’veta per turçni¹²”.*

Kur flet për shkollën e tij, Tahir efendi Lluka thotë:

*“Ket temel t’ri e marova
Per me knue djem e çika”.*¹³

Që dëshmon se mektebi i Tahir efendiut, ka qenë i tipit të përzier, pra aty mësonin edhe djemtë edhe vajzat. Hapja e kësaj shkolle dhe përpjekjet e mësuesit të saj për punë të suksesshme, dëshmojnë për ndërgjegjen e këtij intelektual shqiptar, për nevojën dhe domosdoshmërinë e shkollës në gjuhën amtare. Këtë, Tahir efendiu, e shpreh me fjalët:

*“Gjithsa kavm (komb-SM) me guh t’vet
jon tuj knue, hem tuj shkruie
për dynja dit per dit kta tuj fitue, tuj madhnue,
veç kavmi ynë pa fitue tuj voglue...!”*¹⁴

Tahir ef. Lluka, me mjaft mjeshtëri, përshkruan gjendjen arsimore të shtresave të gjera në hapësirat shqiptare të kohës,

¹² Autori përdori termin “tyrçni” si sinonim i futur detyrueshëm për termin “Islam-fe islame-mysliman”. Këtë e hasim edhe te shumë autorë të tjerë shqiptarë të krijimtarisë letrare në gjuhën shqipe me alfabet arab. Në këtë kohë, termat “mysliman” dhe “turk” ishin bërë sinonime të njëri-tjetrit. Përdorimi i termit shqiptar asokohe nuk shihej me sy të mirë.

¹³ Tahir ef. Lluka, *Risâle-i ahlâk*, dorëshkrim, 1902, f. 30.

¹⁴ Tahir ef. Lluka, *Risâle-i ahlâk*, dorëshkrim, 1902, f. 30.

të cilën e paraqet mjaft të mjerueshme, një gjë që e brengoste shumë edhe atë:

*“Kjo Shqipni ka met krejt në pa dit xho n’xhahili
 Erdhi vakti me dal n’mejdan kjo Shqipni
 N’selamet për me dal kjo Shqipni fukara keka çillue
 Un po due me shka kam marue ket te’lif (vepër) ç
 osht i ri
 Din devletit hizmet mej bo m’ket turli me hurufi arabi
 Hem ni temel me lidh per Shqipni
 Mos me kon fukaraja n’ket Shqipni pa
 dit xho krejt n’xhahili
 Pse t’gjith katundet n’per Shqipni fukaraja
 kurfar gjuhe hiç nuk din
 Dy tre vet ç i jon n’medrese ja mektepli
 N’koft me dit kta per devlet per turçni
 Tjert jesin mashkull femer pa dit xho krejt n’xhahili”.*¹⁵

Tahir efendiu u mundua dhe u angazhua për arsim kombëtar shqiptar, për ngritjen e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve, për mbjelljen e dashurisë ndaj gjuhës amtare, si dhe për emancipimin e popullit në përgjithësi, prandaj dhe për nevojat e mektebit të tij dhe të nxënësve të tij përpiloi vepra didaktike shkollore, por që të ishin të mbështetura në fushën e dijës fetare islame.

Qëllimin e shkrimit të veprave të veta, Tahir efendiu e shpjegon vetë:

¹⁵ Tahir ef. Lluca, *Risâle-i ahlâk*, dorëshkrim, 1902, f. 35-36.

*“Edhe çera shum kitabe gjith per fe ç i jon
Per thmi i marova, me husus kto per Shqipni
Gjith mu knu per Shqipni”¹⁶.*

Sado që veprimtaria e Tahir efendiut zhvillohej në mekteb dhe me shkrim arabe, nga vetë fakti që zhvillohej në gjuhën shqipe, nuk u shkonte për shtati politikave qeveritare të kohës dhe nuk shihej me sy të mirë nga organet e pushtetit, ndaj dhe mund të ketë ndikuar në edhe në përfundimin e jetës së Tahir efendiut dhe të veprimtarisë së shkollës së tij.

Ndonëse mungojnë informatat më të hollësishme rreth punës së mektebit, - prej nga vinin nxënësit, si organizohej procesi mësimor etj., në sajë të përmbajtjes së veprave të tij që ruhen edhe sot dhe që u përmendën më sipër dhe të cilat kanë shërbyer si tekste mësimore në këtë shkollë, – studiuesit e këtyre veprave mund të flasin në kontekst me kohën për përmbajtjen e mësimave, për metodën e mësimin, për mënyrën e organizimit të mësimin, për rrjedhat e procesit mësimor të mektebit në fjalë.

Si përfundim

Nga sa u tha, mund të përfundojmë se mektebet në trojet shqiptare kanë një traditë të gjatë dhe të hershme, madje që nga shek. XV, kurse në që nga viti 1513 e këndej edhe në Kosovë dhe se këto shkolla ishin në numër të madh dhe ato i ndoqën një numër i konsiderueshëm i fëmijëve shqiptarë, vajza dhe djem.

¹⁶ Po aty, f. 30.

Këto shkolla janë hapur duke iu falënderuar iniciativa private të bamirësve të ndryshëm, të cilët kanë lënë vakëfe me se kanë ndikuar dhe kanë ndihmuar në hapjen, ndërtimin, themelimin dhe mirëmbajtjen e këtyre shkollave. E kaluara e shqiptarëve në përgjithësi është e mbushur dhe njëh shumë shembuj të tillë.

Fakti se disa nga këto shkolla kanë vepruar për disa shekuj, na shtyn të përfundojmë se ato i janë përgjigjur qëllimit të tyre. Ato luajtën një rol të rëndësishëm në jetën e shoqërisë shqiptare islame në këto vise.

Mektebet i përgatitnin dhe i pajisnin fëmijët me një bagazh sado të vogël njohurish fillestare, që do t'i bënte të aftë ata për t'i kuptuar dijetarët e mëdhenj nëse do të vazhdonin më tej rrugën e diturisë, ose për të përfutur në profesionet e ndryshme që ushtronin. Nga ana tjetër, mektebet i përgatitnin nxënësit për të plotësuar kulturën e tyre fetare dhe dhanë një ndihmesë të pakontestueshme për arsimimin e një mase të konsiderueshme të fëmijëve dhe të rinjve, për pajisjen e tyre me një formim të kënaqshëm kulturor e shpirtëror, me norma morale dhe etike.

Në këto shkolla mësuesit shqiptarë fëmijëve ua mësonin tekstet në gjuhën amtare dhe shpjegimi i mësimi dhe bisedat në klasë i zhvillonin në gjuhën shqipe.¹⁷ Kështu, në kushte të tilla, mësimi i shqipes u përhap, herë fshehurazi e herë publikisht, nga mësues patriotë dhe u lëvrua gjuha shqipe, si mjet i zgjimit dhe i zhvillimit të vetëdijes kombëtare, siç ishte mësuesi Tahir efendi Lluka dhe mektebi i tij.

¹⁷ Masar Rizvanolli, *Zhvillimi i arsimit shqip në Gjakovë deri më 1918*, në: "Kosova", nr. 31/32, Instituti i Historisë Prishtinë, 2009, f. 16.

Dr. Mirsad ASLANI

VETËDIJA DHE PËRGJEGJËSIA KOLEKTIVE PËR EDUKIM DHE ARSIMIM

Hyrje

اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ

“Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi!” (El Alek, 1).

“Jam dërguar t’i plotësoj virtytet e moralit.”¹

“Allahu më dërgoi si mësues.”²

Vetëdija, përgjegjësia dhe përpjekja kolektive

Në mënyrë që procesi edukativo-arsimor të realizohet si diçka që ka një “*qëllim*” fisnik, të gjithë pjesëmarrësit e tij duhet të kenë vetëdije të zhvilluar për përgjegjësinë e tyre. Në mënyrë që njohuritë të përcillen siç duhet përmes procesit të edukimit dhe arsimimit, në këtë rast duhen pasur parasysh

¹ Bejhekiu, hadithi nr. 21301.

² Muslimi, hadithi nr. 1478.

të gjitha dallimet individuale, më pastaj, aftësitë, interesat dhe afinitetet e njerëzve.³ Çdo individ, i cili në procesin edukativo-arsimor ka përgjegjësinë dhe detyrën për të përcjellë dije dhe për të edukuar shoqërinë, së pari duhet të ketë ndërgjegje të edukuar dhe vetëdije intelektuale për rëndësinë e rolit të tij, më pastaj ta përmbushë atë nga një motivim i brendshëm, që nënkupton një synim altruist ndaj edukimit dhe arsimimit. Çdo person që vepron në mënyrë joadekuate në sistemin edukativo-arsimor duhet të jetë i vetëdijshëm për pasojat afatgjata dhe ndoshta fatale që mund të prekin shoqërinë në një të ardhme të afërt apo të largët.

E gjithë shoqëria duhet të punojë për të krijuar humanitet shoqëror, ku përfshinë edukimin e vlerave, si: ndershmëria, sinqeriteti dhe dashuria për njëri-tjetrin. Edukimi i çdo individi fillon në rrethin e ngushtë familjar. Në atë rreth, në radhë të parë përfshihet nëna dhe babai, më pas ai rreth zgjerohet te të afërmit. Më pastaj, jashtë familjes përfshijmë kopshet, shkollat dhe institucionet e tjera edukativo-arsimore.⁴

Sistemi i zhvilluar arsimor dhe niveli i lartë i edukimit kolektiv është çelësi i suksesit shoqërorë, prosperitetit, ngritjes së nivelit të demokracisë dhe lulëzimit të lirisë njerëzore. Edukimi, morali dhe arsimimi janë themele të marrëdhënieve njerëzore. Brenda një shoqërie, njerëzit mund të gjejnë një mënyrë jetese vetëm nëse funksionojnë brenda vlerave edu-

³ Natalija Petković, *“Edukim dhe arsimim si një ndryshim i vetëdijes”*, Universiteti i Zagrebit - Fakulteti i Mësimdhënësve, Zagreb, 2019, f. 12.

⁴ Reneta Jukić, *“Vlerat morale si bazë e edukimit”*, Nova Prisutnost, nr.11. (2013), 3. f.401- 402.

kativo-morale. Sa më të thella të jenë rrënjët e edukimit në një shoqëri, ajo shoqëri më shumë zhvillohet dhe bëhet më e shëndetshme, sepse njerëzit me karakter të edukuar ndikojnë te njëri-tjetri, andaj ky proces i ndikimit në bashkëjetesën dhe ndarjen e vlerave morale është i pashmangshëm, si për individin, po ashtu edhe për gjithë shoqërinë. Një nga vlerat kryesore edukative dhe morale në shoqëri është ndjenja e nderimit për njëri-tjetrin, më pas, kujdesi ndaj shoqërisë në situata të caktuara dhe ekuilibri në ndërtimin e marrëdhënieve ndër shoqërore.⁵

Edukimi dhe arsimi është faktor i domosdoshëm në procesin e njohjes së njëri-tjetrit, të kuptuarit e kulturave të ndryshme, si dhe, në vendosjen e ndërveprimeve pozitive, por edhe si rezultat i nevojës për organizimin e shoqërive multikulturore sipas parimeve të pluralizmit kulturor, siç janë: mirëkuptimi reciprok, toleranca, dialogu, interesat, besimet dhe zakonet e përbashkëta, dialogu social etj..⁶

Gjëja e parë që Zoti krijoi ishte penda, dhe sipas interpretimit të Pejgamberit a.s., ajo është krijuar për të transmetuar diturinë brez pas brezi. Qysh në fillim, Pejgamberi a.s., edhe kur ishte në Meke urdhëroi të shkruheshin ajetet kuranore, por më pastaj edhe hadithet e tij. Pra, nga nxitjet dhe urdhrat parimore-islame për njerëzit është zhvillimi dhe përhapja e virtyeteve morale dhe ngritja e një sistemi të avancuar arsimor. Andaj, nëse një shoqëri dëshiron të reformohet dhe të

⁵ Mirsad Aslani, *"Koncept i edukimit dhe arsimimit fetar në shoqërinë moderne"*, Novi Pazar, Fakulteti i Studimeve Islame, 2022, f. 58.

⁶ Ibid, f. 60.

përparojë, imperativi parësor i saj është ngritja e edukimit moral dhe zhvillimi i fortë i sistemit arsimor. Krahas bindjes së njerëzve për besim në një Zot, gjithashtu nga shkaqet parimore dhe elementare e dërgimit të Pejgamberit a.s., ishte, ngritja e intelektit njerëzor dhe ngritja morale e shoqërisë: *“Jam dërguar t’i plotësoj virtytet e moralit ... Allahu më dërgoi si mësues ... ”*⁷

Përkushtimi i veçantë i Pejgamberit a.s., ishte në dije dhe edukim moral të shoqërisë, dhe ky përkushtim i Pejgamberit a.s., duhet të jetë mesazh dhe mësim për të gjithë udhëheqësit dhe mësuesit, që t’i kushtojnë vëmendje të veçantë brezave të rinj në edukimin moral, korrekt dhe arsimim cilësor. Këtë e bënte Pejgamberi a.s., me kujdes të veçantë ndaj rinisë. Shpesh fliste drejtpërdrejt dhe i motivonte shokët e tij, veçanërisht të rinjtë, që të merren shumë me dije. Një nga arsytet pse sahabët e rinj ishin transmetues të hadithit dhe shoqëroheshin më së shumti me Pejgamberin a.s., ishte pikërisht afërsia dhe reagimi i tij pozitiv dhe nxitja për arsimim. Mënjëherë pasi Pejgamberi a.s., mbërriti në Medinë, gjëja e parë që bëri ishte ndërtimi i xhamisë, dhe një pjesë të saj ndau për edukim dhe arsimim, kjo pjesë është e njohur si *Suffa*. Edukatori dhe mësuesi i parë i tyre ishte Pejgamberi Muhamed a.s., ndërsa, grupi vazhdimisht ishte nga 70 deri në 400 nxënës.⁸

⁷ Shih: Fusnota 1 dhe 2.

⁸ Mirsad Aslani, *“Koncept i edukimit dhe arsimimit fetar në shoqërinë moderne”*, f. 63.

Gradualiteti, solidariteti dhe durimi në edukim, arsimim dhe zhvillim të shoqërisë

“Ndihmoni njëri-tjetrit në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat...” (El Maide, 2)

“Besimtari për besimtarin është sikur godina, pjesët e së cilës mbajnë njëra-tjetrën.”⁹

Në parim, Islami thërret për gradualitet në të gjitha sferat, veçanërisht në sferën e edukimit dhe arsimimit. Ai është një nga urdhrat themelor të legjislacionit islam. Në këtë mënyrë, Pejgamberi a.s., i edukoi shokët e tij, që të përdorin ligjin e gradualitetit që është pikërisht Ligji i Zotit. Gradualiteti në arsimim ndahet në dy ndarje: ndarja e parë bazohet në sasi, ndërsa ndarja e dytë bazohet në metodën e qasjes-aksesit. Me qasjen e parë, dija jepet gradualisht dhe në një masë të caktuar, në mënyrë që njeriu të mos mbingarkohet dhe të mos jetë në gjendje të përballojë sasinë e njohurive, në mënyrë që të mos humbasë gjithçka që ka mësuar. Ndërsa metoda e dytë e gradualizmit, ka të bëjë me metodën dhe llojin e dijes, në atë mënyrë që edukatori, me njohuritë dhe metodën e tij, fillimisht i qaset asaj që është e qartë, pastaj asaj që është më e fshehtë dhe më e ndërlikuar për të mësuar; dhe e mëson fillimisht atë që është parësore dhe më pas çështjet sekondare.¹⁰

Shkolla ofron një mjedis ku ne mund të mësojmë shumë aftësi themelore. Në kopshtet parashkollore, fëmijët mësojnë

⁹ Buhariu, hadithi nr. 481.

¹⁰ Dr. Jusuf el-Kardavi, “*Pejgamberi dhe dituria*”, Furkan, Shkup, f.223-224.

të lexojnë dhe të shkruajnë në moshën tri vjeçare. Ata fillojnë të mësojnë alfabetin, numrat dhe madje bëjnë disa probleme të thjeshta aritmetike. Ata gjithashtu kanë një shans për të praktikuar vizatimin, ndërtimin, zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë e tyre njohëse. Në shkollë, një individ mëson një sërë lëndësh që mbulojnë historinë, biologjinë, artin, letërsinë, matematikën, fizikën, edukimin fizik, gjeografinë dhe shumë më tepër, si dhe ballafaqohen me vështirësi të ndryshme. Edukimi dhe arsimimi kolektiv-shkollor zhvillon pozitivisht ndjenjën e përgjegjësisë dhe qëndrueshmërisë tek individ. Andaj, detyrohet të ndjekë vazhdimisht ritmin e sistemit shkollor, gjë që e shtyn atë të mendojë vazhdimisht, të bashkëpunojë, të përmirësojë veten dhe njohuritë e tij dhe të zhvillojë interesa për koncepte dhe gjëra të ndryshme që e rrethojnë.¹¹

Edukimi dhe arsimimi është proces gradual në shoqëri dhe arrihet me punë dhe përkushtim të posaçëm, ndër procedurat dhe proceset kryesore arsimore, para së të gjithash, është gradualizmi në sistemin arsimor, pastaj solidariteti përballë vështirësive dhe pengesave, duke i tejkaluar ato me durim, punë dhe luftim të dukurive negative. Edukimi dhe arsimimi është një formë e vetëdijes shoqërore, një nevojë parësore e jetës shoqërore, një formë e praktikës njerëzore, një kategori shoqërore thelbësore dhe e përhershme. Edukimi dhe arsimimi është procesi i formimit të cilësive të larta të individit për vetëdije morale, për edukim të vullnetit dhe ka-

¹¹ Ela Dobrijević, “*Edukimi, arsimimi dhe zhvillimi i individit*”, Universiteti i Pullës, Pullë, 2020, f. 4-5.

rakterit, për zhvillim të aftësive dhe shprehive të sjelljes dhe veprimit moral në përputhje me konceptet morale dhe etike.¹²

Luftimi i amoralitetit dhe analfabetizmit

Allahu xh.sh. në Kuranin fisnik thotë: *“Dhe mos iu afroni imoralitetit, sepse vërtet është vepër e shëmtuar dhe rrugë shumë e keqe.”* (El Isra, 32); *“Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë? Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.”* (Ez Zumer, 9).

Vizioni dhe përgjegjësia e Islamit është luftimi i imoralitetit dhe ngritja e moralit, por gjithashtu edhe luftimi i analfabetizmit dhe ngritja e nivelit të lartë intelektual-arsimor. Nëse marrim parasysh dhe analizojmë rolin e të gjithë pejgamberëve të Zotit, do të shohim se një nga detyrat kryesore dhe parësore të tyre ishte ftesa në besim, më pastaj lufta kundër mëkatit, jetës imorale dhe injorancës, duke e edukuar popullin për një jetë të pastër morale dhe të ndershme. Kështu është mësuar edhe Pejgamberi i fundit i Zotit, Muhamedi a.s., nga vetë Zoti, dhe kështu ai i ka mësuar edhe shokët e tij dhe pasuesit e besimit islam. Pejgamberi i fundit, Muhamedi a.s., mësoi nga mësimet e pejgamberëve dhe ndodhive historike, ishte i vetëdijshëm për dënimet, pasojat dhe vështirësitë që mund t'i ndodhin shoqërisë për shkak të imoralitetit, andaj tha: *“Kur imoraliteti përhapet në një komb dhe fillon*

¹² Esed Karić & Ibrahim Osmić & Ruža Tomić, *“Pedagogjia”*, Denfas, Tuzla, 2006, f. 75.

të bëhet publikisht, ata do të preken nga murtaja dhe sëmundje që paraardhësit e tyre nuk i dinin.”¹³ Pejgamberi a.s., e konsideronte edukimin moral si pikën më të rëndësishme të karakterit të njeriut, sepse të edukosh veten moralisht, është suksesi më i madh në këtë botë, por dhe në botën tjetër: *“Besimtarët më të mirë janë ata që e kanë moralin më të mirë”*¹⁴; *“Nuk ka asgjë që do të vihet në Mizan, dhe do të peshojë më shumë se morali i mirë. Një person me moral të mirë, do të ketë statusin e agjëruesit dhe namaz-falësit të vazhdueshëm.”*¹⁵ Prandaj, besimtarët e vërtetë janë të vetëdijshëm për prioritetet e tyre në jetë dhe nuk dorëzohen kurrë, por punojnë gjithë jetën për të përmirësuar situatën dhe për t’iu afruar parimeve të larta islame, pra, parimeve universale njerëzore.

Në luftën kundër analfabetizmit dhe injorancës, Pejgamberi a.s., kishte një ide që është karakterizuar si një nga idetë më të mira botërore gjatë gjithë historisë. Pas fitores së betejës së Bedrit, u bëri një propozim të burgosurve. Propozimin më së miri e përshkruan Ibën Sadi, i cili transmeton nga Amër esh-Sh’abiu r.a., i cili thotë: *“Pas betejës së Bedrit (në duart e myslimanëve) ranë shtatëdhjetë robër. Secili prej tyre mori lirinë e tij në bazë të pasurisë. Njerëzit në Meke dinin shkrim-lexim, ndërsa në Medine nuk dinin. Ai që nuk kishte pasuri për ta blerë lirinë, iu dha mundësia t’i mësonin nga dhjetë fëmijë myslimanë shkrim-lexim nga Medina dhe kur*

¹³ Ibën Maxhe, hadithi nr. 4019.

¹⁴ Tirmidhiu, hadithi nr. 1262.

¹⁵ Ibid, hadithi, nr. 2003.

ta bënin këtë, liroheshin nga robëria (burgosja)."¹⁶ Ky propozim i Pejgamberit Muhamed a.s., ishte shkaku i vetëdijes dhe përgjegjësisë kolektive që kishte në luftimin e analfabetizmit. Ngase një shoqëri që është në kërkim të përparimit dhe zhvillimit duhet punuar për ndryshimin e vlerave reale, duhet të reflektojë nga brenda e të mos presë ndryshime nga jashtë, por të veprojë vetëm për të mirën e gjithë shoqërisë, në mënyrë që gjendja e saj të ndryshojë, ndërsa ajo ndryshohet me reforma dhe gradualitet, me përpjekje të përbashkët dhe angazhim, më pastaj vjen edhe ndihma e Zotit: ***"... Allahu nuk e ndërron një popull derisa ata vetveten nuk e ndërrojnë."*** (Er-R'ad, 11).

¹⁶ Tabekatu ibën Ibni S'ad, I:22.

PhD(c) Besir NEZIRI

FILLIMI ME BISMILAH

Ceremonia e fillimit të shkollës për fëmijët në traditën osmane

Hyrje

Feja islame i ka dhënë rëndësi të madhe edukimit dhe arsimimit, duke e bërë obligim për të gjithë myslimanët, pa dallim gjinie, që të mësojnë e studiojnë. Urdhri i parë hyjnor është “*Lexo*”. Në Kuranin famëlartë janë rreth 750 ajete, e po ashtu edhe shumë hadithe të Muhamedit a.s., flasin për rëndësinë e edukimit dhe arsimit, si dhe urdhërojnë për mësim e edukim.¹ Mbështetur në këtë urdhër të Zotit, si në çdo shoqëri myslimane, ashtu edhe në shoqërinë osmane, edukimit, posaçërisht edukimit të fëmijëve i është dhënë një rëndësi e madhe. Ndër institucionet arsimore tradicionale në Perandorinë Osmane kanë qenë edhe mejtepet *sibjan* apo shkollat për fëmijë. Këto mejtepe njihen edhe me emrat, si: *mejtepi i gu-rit*, *mejtepi i lagjes* dhe *daruttalim* (shtëpia e mësimi). *Mej-*

¹ F. Kayadibi , “*İslam Dini'nin Eğitim ve Öğretim Verdigi Önemi*”, Journal of Istanbul University Faculty of Theology, c. 0, sayı. 4, Nis. 2012

tepi i lagjes është quajtur për arsye se pothuajse në çdo lagje ka pasur nga një mejtepe, ndërsa është quajtur *mjetepi i guri* për arsye se kanë qenë të ndërtuar nga guri. Gjatë kohës së Perandorisë Osmane, në të gjitha qytetet e Kosovës, por edhe në shumë fshatra ka pasur mejtepe *sibjan*.

Në mejtepet *sibjan*, të cilat në të shumtën e rasteve ishin ngjitur me xhaminë ose pranë saj, mësoheshin njohuritë fetare, si mësimi i leximit të Kuranit, nxënia përmendsh e disa kaptinave të shkurtra të Kuranit, mësimi i faljes së namazit, mësimi i rregullave elementare të fesë, si dhe edukimi sipas etikës islame.²

Ceremonia e fillimit me *Bismilah*

Në Perandorinë Osmane, fëmijët fillonin shkollën fillore kur i mbushnin katër ose pesë vjeç, dhe për ta organizohej një ceremoni që quhej “*Ceremonia e fillimit me Bismilah* (Bed’-i Besmele Cemiyeti)” ose “*Shpura e amini*” (Âmîn Alayı). Siç dihet, në fenë islame rekomandohet që çdo punë e rëndësishme dhe e ligjshme që ka të bëjë si me dynjanë, ashtu edhe me Ahiretin, të fillohet me Bismilah. Në mejtepet *sibjan*, hapi i parë për të mësuar njohuritë fetare ishte mësimi i Bismilahit. Për këtë arsye, kjo ceremoni e ka marrë emrin “*Fillimi me Bismilah*”. Kurse emërtimi “*Shpura e amini*” rrjedh nga grupi i nxënësve të shkollës, të cilët merrnin pjesë

² Sadik Mehmeti, “*Shkollat fillore klasike islame (Mejtepet Sibjan) në Kosovë*”, Buletini 3, 2014, fq. 183-185.

në ceremoni dhe njëzëri thoshin “*amin*” për lutjet që bëheshin.³

Ceremonia “*Fillimi me Bismilah*” nuk dihet saktësisht se kur dhe si filloi të organizohet për herë të parë. Kjo praktikë ka qenë më e përhapur në Stamboll, por shihet se është praktikuar edhe në qytetet e tjera të Perandorisë Osmane, si në Bursa, Çankërë, Niğde, etj., dhe në qytetet e Ballkanit, si në Shkup etj..⁴



Ceremonia e fillimit të shkollës

³ Neslihan Koç Keskin, “*I. Abdülhamit’in Şehzadelerinin Bed’-i Besmele Törenini Anlatan Enderûnlu Fâzıl’ın Süsnâme-i Şehriyâr’ı Üzerine*”, *Türkiyat Araştırmaları Dergisi*, sayı 27, fq. 150.

⁴ Hanım Göktaş, “*Mahalle Mektebine Başlama Merasimi: Âmin Alayı ve Bed-i Besmele*”, Osman Köse (Ed.), *Geçmişten Günümüze Şehir ve Çocuk II*, Canik Belediyesi Kültür Yayınları, Samsun, 2016, fq. 1318.

Fillimi i shkollës për një fëmijë është një nga fazat më të rëndësishme në jetën e tij. Kjo ngjarje, e cila është e rëndësishme jo vetëm për familjen, por edhe për banorët e lagjes, në Perandorinë Osmane, organizohej në një atmosferë festive dhe emocionuese. Ceremonia e fillimit të shkollës organizohej në bazë të gjendjes financiare të familjeve. Nëse gjendja financiare e familjes nuk ishte e mirë për të kryer këtë ceremoni, fëmija çohej në shkollën më të afërt nga babai ose nëna, fëmija puthte dorën e mësuesit dhe fillonte mësimin. Ndërsa familjet me gjendje të mirë financiare e organizonin dhe i jepnin rëndësi të madhe kësaj ceremonie.

Kjo ceremoni zakonisht mbahej në netët e mëdha, të hëna ose të enjteve. Në bazë të zakonin, familja e fëmijës që do të fillonte shkollën, e lajmëronte mësuesin e shkollës një ditë më parë për mbajtjen e ceremonisë. Mësuesi i shkollës i njoftonte paraprakisht nxënësit që do të merrnin pjesë në kortezhin e ainit, duke u thënë që të vishnin rrobat e tyre më të mira për ceremoninë. Për ditën e ceremonisë njoftoheshin edhe familjarët dhe të afërmit e fëmijës. Nxënësit, të veshur me rroba të bukura, vendoseshin në reshta, fillimisht në rend të parë kënduesit e ilahive, kurse në rend të dytë, shpura e ainit, dhe ashtu të renditur, shkonin nga shkolla për te shtëpia e fëmijës që fillonte shkollën. Fëmija e priste shpurën e ainit, i veshur me rroba të reja, i stolisur me xhevahire të çmuara, me një shall të çmuar dhe një çantë prej argjendi të varur në qafë për xhizat e Kuranit. Kur shpura e ainit arrihte në shtëpi, mësuesi (hoxha) bënte duanë dhe të gjithë thoshin “*Amin*” pas tij. Më pas, fëmija me të afërmit e tij hipte në karrocë, e cila ishte e dekoruar paraprakisht, ose në një

kalë të quajtur “midilli” dhe duke kënduar ilahi lëviznin. Kë-tij karvani i prinin dy persona, njëri mbante një “*Elif-ba*” dhe një çantë për xhuzat e Kuranit në një jastëk të bukur, ndërsa tjetri pas tij mbante rahlen, në të cilën do të vendoste xhuzin e tij për lexim të Kuranit. Pas këtyre, ishte karroca apo kali ku ishte ulur fëmija, dhe pas karrocës ecnin në rresh-ta për dy, mësuesi i shkollës, kënduesit e ilahive dhe shpura e aminit. Pas karvanit, vinte familja e fëmijës, të ftuarit dhe ba-norët. Gjatë shëtitjes nëpër qytet këndoheshin ilahi dhe pas ilahive, të gjithë, jo vetëm shpura e aminit, por edhe njerëzit përreth thoshin njëzëri “*amin*”. Pas shëtitjes nëpër rrugët e qytetit për një kohë, karvani ndalej para derës së shtëpisë së fëmijës dhe duke kënduar ilahi dhe dua, të gjithë së bashku hynin në shtëpi. Mesi i sallonit të shtëpisë përgatitej me mi-nder, sexhade dhe aroma të bukura, e në minder ulej mësuesi dhe përballë tij ulej fëmija që fillonte shkollën. Nëse në shtë-pi kishte ndonjë dijetar, ai zinte vendin e mësuesit. Të gjithë të ftuarit përcillnin me kënaqësi mësimin e parë që mbahej në mënyrë festive. Fëmija, i ulur në minderin e tij, hapte fa-qen e parë të xhuzit të “*Elif-bas*” të vendosur në rahle, dhe në dorë, me shkopin në formë gjysmëhënë (mjete që përdoret për të nënvizuar shkronjat) prej druri (kocke, bronzi, argjendi ose ari) priste mësuesin që të fillonte mësimin. Fillimisht, mësuesi së bashku me fëmijën thoshin “*Eudhu-bismilah*” dhe lexonin një lutje të shkurtër, e cila zakonisht ishte lutja “*Rabbijesir*”: “*Rabbi jesir ve-lâ tuassir, Rabbi temmim bil-hajr*”. Pastaj mësuesi fillonte me Bismilah dhe i mësonte fë-mijës shkronjat në fillim të xhuzit, duke ia lexuar me zë dhe duke i përsëritur nxënësi pas tij. Në përgjithësi mësohej dhe

përsëritej shkronja “elif”, dhe në këtë formë përfundonte mësimi. Pasi kryhej mësimi i parë, nxënësi puthte dorën e mësuesit dhe të të ftuarve të tjerë. Njëri nga nxënësit lexonte një ashër nga Kurani dhe ceremonia përfundonte me lutjen e mësuesit. Në fund të ceremonisë, shërbeheshin ushqimet e përgatitura nga familja e fëmijës dhe shpërndareshin dhuratat për hoxhën, mësuesin dhe ndihmësin e tij, si dhe para xhepi për të gjithë fëmijët që këndonin ilahi dhe që merrnin pjesë në shpurën e aminit.⁵

Kjo ceremoni zhvillohej edhe në shkollë në rast se shtëpia e fëmijës ishte e vogël ose për ndonjë arsye tjetër. Pas shëtitjes së shpurës në lagje, ajo vinte në shkollë, dhe pas këndimit të ilahive dhe duasë, hynin në shkollë dhe zhvillohej mësimi i parë. Në ceremoni merrnin pjesë të ftuarit dhe të afërmit e fëmijës, dhe krejt në fund, të ftuarve u shpërndahej ushqimi dhe dhuratat.⁶

⁵ Mustafa Öcal, “*Amin Alayı*”, TDV İslâm Ansiklopedisi, c. 3, 1991, fq. 63; Göktaş, “Mahalle Mektebine Başlama Merasimi: Âmin Alayı ve Bed-i Besmele”, fq. 1321-1322; Özlem Güneş, “Erken Çocukluk Dönemine Dair Unutulmuş Bir Gelenek: Bed’-İ Besmele- Âmin Alayı”, *Erken Çocukluk Dönemine Disiplinler Arası Bir Bakış*, 2016, fq. 226-233; Sevede Göleç, *Osmanlı Döneminde Okula Yeni Başlayan Çocuklar İçin Düzenlenen Törenlerin Pedagojik Açıdan Değerlendirilmesi*, Bursa Uludağ Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü Felsefe ve Din Bilimleri Anabilim Dalı, Basılmamış Yüksek Lisans Tezi, fq. 19-25.

⁶ Elif Aydın, *Tarihimizde Âmin Alayları Ve Eğitim Açısından Değerlendirilmesi*, (Yüksek Lisans Tezi), Marmara Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, 2008, fq. 45.



Çanta dhe elifbaja e nxënësve

Ilahitë që këndoheshin në këtë ceremoni

Në ceremoninë e fillimi me Bismilah, rëndësi të madhe i kushtonin këndimit të ilahive. Në ceremoni sillej një grup i mirë i nxënësve që këndonin ilahi, saqë kishte familje që sillte nga shkollat e tjera këndues të njohur të ilahive. Në ceremoni këndoheshin ilahi të mejtepit, por edhe të poetëve të njohur, si Junus Emre ve Nijazi Mısri. Më poshtë është dhënë një ilahi e mejtepit që është më e përhapura:

I

*O Zot! Të fillojmë me Bismilah,
 Për këtë lutje t'i ngremë duart me Bismilah,
 Ti pranoje lutjen tonë për nder të Bismilahit,
 Lehtësona marrjen e diturisë, o Zot i botëve!
 Për nder të Muhamedit, ndihmona o Ndihmëtar,
 Të erdhëm te dora jote për lutje, o Zot i botëve!
 Bëji fitimtarë robërit e Tu, o Ndihmëtar!⁷*

II

*Elhmadulilah, në një ditë të begatë e filluam,
 Duke thënë "Rabbi yessir lâ tüassir",
 "Rabbi temimi" për nder të të dashurit tanë, o Zot!
 Diama, kjo është lutja e mejtepit, burim i bujarisë,
 Mos na le në injorancë, o Zot, dhurona dituri të dobishme!
 Ashika të Kurani Kerimit jemi të gjithë,
 Na e lehtëso diturinë, kërkojmë mirësinë tane!
 Mos na le në injorancë, o Zot, dhurona dituri të dobishme!⁸*

